ZBULUESIT

Viti 3 - Tremujori 4

Të zbulojmë thesaret e përjetshme **në librat: 2 i Mbretërve, Jeremia, Jona, 2 i Kronikave, Danieli dhe Esteri, si dhe fuqinë dhe mëshirën e Perëndisë të shfaqur përmes Namaanit, Jonës, Josias, Danielit, Shadrakut, Meshakut, Abednegos dhe Esterit.**

Programi Bazë

Zbuluesit është një shërbesë e Discovery Land Global.
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Një mesazh nga drejtoresha ekzekutive

Faleminderit për shërbesën tuaj!

Ka raste kur tundohemi të kënaqemi me aq nxënës sa kemi në shërbese dhe harrojmë se sa e rëndësishme është që t'ua shpallim Ungjillin edhe fëmijëve të tjerë. Këtë tremujor, mendoni përtej! Mendoni për delet e humbura që keni në komunitet dhe se si mund t'i ftoni dhe t'i mirëprisni në shërbesën tuaj (Luka 15:3-7). Mos harroni, kjo mund të jetë hera e parë që ata do të dëgjojnë për Jezusin apo të hapin një Bibël. Kujdesuni për ta, duajini, inkurajojini dhe lutuni që Perëndia t'ua shfaqë të vërtetën e Tij. Unë lutem që Perëndia të sjellë fëmijë të rinj që po kërkojnë ta njohin e të rriten në fjalën e Tij!

Këtë tremujor do të punojmë si skuadër për t'i mësuar nxënësit që të kuptojnë Perëndinë tonë të plotfuqishëm dhe do t'u mësojmë se si të jenë dishepuj të vërtetë të Jezu Krishtit. Do të studiojmë rreth Naamanit, mbretit Ezekia, Jonës, mbretit Josia, Danielit, Shadrakut, Meshakut, Abednegos dhe Esterit. Këta njerëz kërkuan të vërtetën dhe u përgatitën për sfidat e jetës.

Lutem që të përjetoni gëzim të madh çdo javë, ndërsa studioni Fjalën e Perëndisë dhe ua tregoni atë nxënësve tuaj. Pavarësisht rolit apo moshës së nxënësve, ju jeni të rëndësishëm. Efesianëve 2:10 thotë: "Sepse jemi vepra e tij, e krijuar në Krishtin Jezus për vepra të mira që Perëndia përgatiti që më parë, që ne të ecim në to." Ky varg na kujton se shërbesa është shumë më tepër sesa disa orë punë. Shërbesë do të thotë të përdoresh nga Perëndia për të përmbushur planin e Tij të madh – vepra e Mbretërisë! Faleminderit që jeni treguar të bindur ndaj thirrjes së Tij në jetën tuaj.

Mezi pres të shoh se si Perëndia ju përdor për veprën e Mbretërisë!

Kris Smoll
Drejtoreshë ekzekutive e *Discovery Land Global*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Tabela e Përmbajtjes
Viti 3 – Tremujori 4

Të kuptojmë kurikulën..... 4
Përmbledhja e tremujorit..... 9
Mësimi 1: Naamani shërohet nga lebra pasi një vajzë e re i tregon për besimin e saj. 12
Mësimi 2: Mbreti Ezekia lutet me siguri. 21
Mësimi 3: Jona zgjedh të bindet ose jo..... 28
Mësimi 4: Mbreti Josia gjen Fjalën e Perëndisë. 39
Mësimi 5: Nebukadnetsari pushton Judën..... 48
Mësimi 6: Danieli refuzon ushqimin e mbretit. 56
Mësimi 7: Danieli i kërkon Perëndisë urtësi për të interpretuar ëndrrën e Nebukadnetsarit..... 66
Mësimi 8: Shadraku, Meshaku dhe Abednego hidhen në furrën e ndezur. 74
Mësimi 9: Danieli hidhet në gropën e luanëve. 82
Mësimi 10: Me guxim, Esteri rrezikon jetën e saj dhe Perëndia e përdor për të shpëtuar popullin e Tij..... 89
Mësimi 11: Urtësia e vërtetë vjen nga Fjala e Perëndisë. 98

Shtojca

Mësim tematik: Të njohim librin e Psalmeve 101
Mësim tematik: Kur ndodh tragjedia 113
Mësim tematik: Kisha..... 122
Lojërat e fundit të përsëritjes 129
Libri pa fjalë – T'u prezantojmë fëmijëve ungjillin 132
Mirënjohje dhe falënderime 134

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

TË KUPTOJMË KURIKULËN

Pasqyrë e përgjithshme

Kurikula është hartuar për të qenë ARGËTUESE, PËRFSHIRËSE dhe EFEKTIVE, në mënyrë që t'i motivojë fëmijët ta njohin dhe ta duan Perëndinë. Ajo është strategjike dhe e qëllimshme, dhe merr parasysh zhvillimin frymëror të fëmijëve të moshës nga gjashtëmuajsh deri në 9 vjeç.

Kurikula u hartua për t'i mësuar nxënësit në lidhje me:

1. **Biblën:** pamjen e përgjithshme të Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re si një të vetme, zbulesën e unifikuar të së vërtetës së Perëndisë për ne.
2. **Ungjillin e Jezusit:** shpëtimin me anë të hirit përmes besimit siç paraqitet në të gjithë Biblën.
3. **Bazat e krishterimit:** transformimin e jetës përmes lutjes, adhurimit, ungjillëzimit, mësimit përmendsh të Shkrimit, pagëzimit, Darkës së Zotit, të dhjetës, bashkësisë, shërbesës, misionit etj. (Listën e plotë sipas grup-moshave, mund ta gjeni në Hartën e gjurmuesit).

Mësimet bazë mbështeten në strukturën:

KUPTO SI DUHET → MENDO SI DUHET → VEPRO SI DUHET → NDIHU SI DUHET

Kupto si duhet:	Një pasazh kyç nga Shkrimi – 2 e Timoteut 2:15
Mendo si duhet:	Një varg kyç nga Shkrimi për të medituar gjatë javës – Psalmi 1:2
Vepro si duhet:	Sfida për të vënë në praktikë Fjalën e Perëndisë – Jakobi 1:22
Ndihu si duhet:	Rezultati i zbatimit të mësimit dhe të të pasurit e një botëkuptimi biblik në vend të një pikëpamjeje laike – Psalmi 23

Drejtuesit

Çdo klasë ka zakonisht tre drejtues: Mësuesin kryesor, Drejtuesin e kohës së zbulimit dhe Bariun.

Mësuesi kryesor: Është përgjegjës për mësim të qëndrueshëm biblik, që tërheq vëmendjen e nxënësve dhe krijon një rritje frymërore për ta duke ndjekur kurikulën, si dhe siguron udhëheqje për nxënësit dhe vullnetarët gjatë takimit.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Drejtuesi i kohës së zbulimit: Është përgjegjës për udhëheqjen e Kohës së zbulimit, një aktivitet prej 15 minutash, i cili është edukativ, energjik, ndërveprues dhe ka në bazë ekipin, siç citohet në kurikul.

Bariu: Është përgjegjës për nxitjen dhe trajnimin e nxënësve gjatë gjithë takimit, duke përfshirë lidhjen e tyre me një mik dhe ndihmon ata që vijnë për herë të parë, të ndihen të mirëpritur.

Këshilla për drejtuesin

Të gjithë drejtuesit duhet të qëndrojnë gjatë gjithë mësimit në klasë duke u angazhuar me nxënësit dhe duke i ndihmuar ata sipas nevojës.

Për grupe më të vogla, Drejtuesi i kohës së zbulimit dhe Bariu mund të jenë i njëjti person.

Pasqyra bazë e programit

Programi përbëhet nga pesë elemente:

1. Loja e përsëritjes
2. Adhurimi
3. Koha e zbulimit
4. Mësimi nga Bibla
5. Loja e fundit e përsëritjes

Këto pjesë janë të lidhura fort me njëra-tjetrën, të cilat krijojnë një ambient mësimi me kohë të plotë, ku çdo minutë është e rëndësishme dhe çdo nxënës përfshihet për të mësuar pikat kryesore të mësimit apo një objektiv të Hartës së gjurmuesit.

Program i sugjeruar

-: 20 Vullnetarë të gatshëm dhe të përgatitur për të mirëpritur nxënësit teksa mbërrijnë
-: 15 Loja e përsëritjes
: 00 Adhurimi
: 15 Koha e zbulimit
: 30 Mësimi nga Bibla
: 60 Loja e fundit e përsëritjes
: 65 Marrja e nxënësve nga prindërit

Loja e përsëritjes

Këshilla për drejtuesin

Drejtuesit të cilët nuk janë duke i mirëpritur nxënësit ndërsa hyjnë në klasë, duhet t'i ndihmojnë dhe t'i nxisin ata gjatë Lojës së përsëritjes. P.sh, Duke brohoritur!

Sigurohu që vizitorët të ndihen të mirëpritur dhe përpiqu t'i bashkosh me një mik të ri nga klasa jote.

Loja e përsëritjes është krijuar që të jetë argëtuese dhe energjike, për të rishikuar mësimet dhe temat e mëparshme nga Harta e gjurmuesit. Koha shfrytëzohet më së miri teksa fëmijët vijnë dhe për prindërit është gjëja e parë që shohin!

Udhëzimet për lojën e përsëritjes gjenden te shtojca.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Adhurimi

Këshilla për drejtuesin
Inkurajo nxënësit të jenë të respektueshëm dhe të marrin pjesë duke bërë lëvizjet e caktuara të këngëve, dhe/ose duke qëndruar thjesht në këmbë në shenjë respekti. Drejtuesit duhet të parandalojnë dhe të korrigjojnë çdo lloj sjellje shqetësuese.

Adhurimi është hartuar për të:

- paraqitur mësimin e ditës
- mësuar se çfarë është adhurimi
- modeluar adhurimin autentik
- nxitur pjesëmarrjen në adhurim

Në një javë të zakonshme, adhurimi përmban dy ose tre këngë. Kurikula e adhurimit gjendet te shtojca.

Koha e zbulimit

Aktivitetet e Kohës së zbulimit (KZ) janë krijuar për t'i angazhuar dhe sfiduar nxënësit përmes mësimit praktik. Përmes KZ-së, ata do të përjetojnë një emocion ose një reagim që do t'i ndihmojë të lidhen personalisht me mësimin e Biblës. Ndonjëherë aktiviteti i KZ-së do të përdoret për të krijuar një "pamje të paharrueshme" të mësimit biblik, siç mund të jetë një ndjenjë, një aromë apo një shije e diçkaje te rrëfimi i Biblës.

Këshilla për drejtuesin
Sigurohu që të kuptosh paraprakisht se si KZ-ja lidhet me mësimin dhe se si do të funksionojë aktiviteti. Nëse nuk je i sigurt, kontakto drejtuesin e shërbesës. Dhe mbaj mend, drejto me entuziazëm; KZ-të janë pjesë emocionuese e takimit të fëmijëve!

Mësimi nga Bibla

Mësimi i Biblës është një përvojë e udhëhequr nga mësuesi, i cili e bën Biblën të gjallë për nxënësit. Ungjilli është i ndërthurur në çdo mësim. Atje ka një skicë të Shkrimit për të ndihmuar në udhëheqjen e mësimit:

Kreu i seksionit: Ky informacion është vetëm për mësuesin (jo për dialog).
Lexo: Shkrime nga Bibla për t'ia lexuar nxënësve me zë të lartë.
Përmbledhje: Pasi të keni lexuar pjesën nga Shkrimi, merr kohë për t'iu shpjeguar se çfarë do të thotë ajo pjesë. "Përmbledhja" shpesh bën një pyetje, përcakton fjalët kyç, ose rishpreh tablonë e asaj që lexuat, në nivelin e një fëmije.
Parafrazim: Kjo do të thotë se nuk keni nevojë ta lexoni pjesën drejtpërdrejt nga Bibla (për shkak të kohës, gjatësisë së vargjeve, ose për shkak se mbulon një temë të vështirë që duhet të bëhet më e përshtatshme për fëmijët). Ju lutemi, mos e lexoni tekstin e parafrazuar drejtpërdrejt nga kurikula.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Hapat e sugjeruar për përgatitjen e mësimit nga Bibla:

1. Lutu për drejtimin dhe udhëheqjen e Perëndisë! Gjithashtu kalo kohë duke u lutur për nxënësit e tu emër për emër.
2. Lexo Shkrimin nga Bibla jote – nënvizo pikat kryesore! Kjo kurikul është hartuar mbi themelin e Fjalës së Perëndisë dhe mësimit rreth të vërtetës së Tij nga Fryma e Shenjtë. Është e rëndësishme që të gjithë drejtuesit të lexojnë fragmente nga Shkrimi, përpara se të lexojnë skicën e mësimit nga Bibla. Kurikula mund të përmbajë gabime, por Bibla është e pagabueshme.
3. Lexo pyetjet shqyrtuese të mësimit!
4. Lexo kurikulën!
5. Planifiko mësimin! Sigurohu që të përdorësh kalimin e aktivitetit të KZ-së për të prezantuar dhe/ose theksuar pikën "Vepro si duhet" te mësimi.
6. Bëje mësimin më të gjallë duke përdorur mjete, figura apo veprime, si dhe duke përdorur ide krijuese nga kurikula.
7. Praktiko mësimin në mënyrë që "t'i jepni jetë Biblës", duke pasur emocion në zë dhe kontakt të mirë me sy.
8. Mësuesit duhet t'i kenë Biblat e hapura gjatë gjithë mësimit, në mënyrë që nxënësit të dinë se ngjarja vjen nga Bibla. Të gjithë nxënësit duhet t'i hapin Biblat te pasazhi nga Shkrimi siç i drejton mësuesi (shih seksionin "Gjejeni" në prezantimin e mësimit). (Nxënësit më të vegjël mund të kenë nevojë për ndihmë.) Për shkak të kohës së limituar dhe vlerës që i japim përdorimit të Biblave nga nxënësit, ju lutemi mos e lexoni mësimin nga një libër me histori biblike.

Loja e fundit e përsëritjes

Lojërat e thjeshta të përsëritjes i gjeni te shtojca e kurikulës. Drejtuesit e kohës së zbulimit ose Barinjtë drejtojnë lojën e përsëritjes ndërsa prindërit janë duke marrë fëmijët. Mësuesi kryesor shpërndan etiketat shpërblyese dhe lidhet me prindërit.

Këshilla për drejtuesin

Shpërbleji pyetjet përsëritëse! Mund t'i kthesh në pyetje E vërtetë/E gabuar ose në pyetje me alternativa, si të përshtaten më mirë për moshën dhe nivelin e klasës.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Materialet për klasën

Për mësimin iu jepen materialet e mëposhtme:

- Kronologjia e Biblës
- Libri pa fjalë
- 12 vargjet kyç
- Fletushka *T'i udhëzosh fëmijët drejt shpëtimit*
- Broshura *E beson apo jo?*
- Libër shënuesi *Unë besoj*
- Broshura *Çfarë ndodh më pas?*
- Postera me librat e Dhiatës së Vjetër dhe të Re
- Etiketat shpërblyese
- Posteri *Ndihu si duhet*
- Harta e kohëve të Biblës

Etiketat shpërblyese

Etiketat shpërblyese mund të fitohen nga nxënësit gjatë mësimit dhe të shpenzohen më pas në Tregun e zbulimit.

Kursi i këmbimit:

3 Marrja e Biblave me vete (për fëmijët më të vegjël)/ Përdorimi i Biblave (për më të rriturit)
2 Pjesëmarrja aktive në klasë
1 Shfaqja e frytit të Frymës
1-5 Aktivitetet e Kohës së zbulimit (specifikuar në kurikul)
5 Plotësimi i Thesareve të gjurmuesit dhe kthimi i kuponit
10 Vizitori dhe miku që sjell vizitorin

Thesaret e gjurmuesit

Thesaret e gjurmuesit janë letra shumëngjyrëshe, të përshtatshme për fëmijët dhe familjet që t'i marrin në shtëpi. Është një mënyrë shumë e mirë për të krijuar bashkëpunim me prindërit. Thesaret i gjurmuesit i edukon për atë që po mësojnë fëmijët dhe i sfidon ta aplikojnë mësimin në shtëpi gjatë javës. Pasi të plotësohet aktiviteti sfidues si familje, nxënësit mund të kthejnë kuponin te mësuesi dhe të marrin pesë Etiketa shpërblyese.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përmbledhje e Tremujorit

Viti 3 – Tremujori 4

Do të kalojmë sërish nga studimi i Dhiatës së Re me jetën, vdekjen, ringjalljen e Jezusit dhe historinë e kishës së hershme, duke u kthyer te udhëtimi nëpër mësimet e jashtëzakonshme të Dhiatës së Vjetër. Studimi do të na kthejë pas në kohën e mbretërisë së ndarë, Juda dhe Izraeli, dhe në robërimin e Judës në Babiloni. Do të njihemi me disa nga personalitetet më të njohura të Biblës dhe, përmes sfidave, besnikërisë, madje edhe mosbindjes së tyre, do të mësojmë se përse duhet ta ndërtojmë jetën tonë në Fjalën e Perëndisë.

Mësimi i parë na nxjerr jashtë Izraelit, në tokën pagane të Aramit. Atje ishte një vajzë e re izraelite, marrë skllave nga ushtria e Aramit, e cila punonte për familjen e një burri të quajtur Naaman. Naamani ishte komandanti i ushtrisë së Aramit dhe ishte prekur nga lebra. Kjo vajzë e re shpalli besimin e saj, pavarësisht rrethanave, kur tregoi me guxim se profeti i Perëndisë në Izrael, Eliseu, mund ta shëronte Naamanin. Prej saj mësojmë se si t'u tregojmë me guxim të tjerëve për Perëndinë tonë madhështor.

Që prej lindjes (ngjizjes) së tyre si komb, populli i Izraelit kishte rebeluar kundër Perëndisë. Kur kërkuan me ngulm një mbret, Perëndia i paralajmëroi për pasojat, megjithatë ua plotësoi dëshirën. Një nga pasojat e rebelimit të Izraelit ishte ndarja e mbretërisë në dy pjesë – Juda dhe Izraeli. Pas kësaj ndarjeje, të gjithë mbretërit e Izraelit dhe shumë prej mbretërve të Judës, bënë atë që ishte e keqe në sytë e Zotit dhe e çuan popullin larg Tij. Megjithatë, kishte disa mbretër në Judë që i besonin Perëndisë dhe bënin atë që ishte e drejtë në sytë e Tij. Një nga këta mbretër ishte Ezekia. Ezekia u lut dhe qau, pasi profeti i Perëndisë i tha se do të vdiste. Perëndia iu përgjigj lutjes së Ezekias me 'po' dhe i dha edhe pesëmbëdhjetë vite të tjera jete. Ezekia na inkurajon të lutemi për gjithçka.

Për shkak të rebelimit dhe adhurimit të perëndive të rreme, Perëndia lejoi që izraelitët të ishin të cenueshëm nga armiqtë. Një prej armiqve ishte Asiria. Për shkak të veprave të liga të Asirisë, Perëndia planifikoi t'i shkatërronte. Për shkak të hirit dhe të mëshirës së Tij, Perëndia dërgoi profetin e Tij, Jonën, që t'i paralajmëronte asirianët. Kur Jona i mllefosur nuk u bind, Perëndia i dha një mësim përmes fuqisë së Tij mbi detet dhe krijesat në to. Në fund Jona u bind, asirianët u penduan dhe u kursyen nga shkatërrimi. Nga mosbindja e Jonës dhe pasojat që e ndoqën, kuptojmë se duhet t'i bindemi gjithmonë Perëndisë.

Mbretërit e pabindur dhe jobesnikë të Izraelit e lanë pas dore tempullin e Perëndisë, adhurimin e Tij dhe Fjalën e Tij. Mbretëria veriore e Izraelit ishte dëbuar tashmë në Asiri dhe radha po vinte për ndëshkimin e Judës. Edhe pse Josia u bë mbret i Judës kur ishte vetëm tetë vjeç, ai bëri atë që ishte e drejtë në sytë e Perëndisë. Çdo e mirë që ai bëri çoi drejt një të mire tjetër. Kur Josia urdhëroi riparimin e tempullit, u gjet edhe

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Libri i Ligjit. Kur Josia dëgjoi të vërtetën e Perëndisë në atë libër, e besoi dhe e ndoqi. Ai ia lexoi popullit dhe ata u kthyen në bindje. Për shkak se Josia kërkoi/dëshiroi të vërtetën, Perëndia e kurseu Judën nga ndëshkimi që i takonte deri pas vdekjes së Josias. Edhe ne, si popull i Perëndisë, ecshim në gjurmët e Josias, duke kërkuar të vërtetën në Fjalën e Perëndisë!

Pas vdekjes së mbretit Josia, Juda dhe mbretërit e saj iu kthyen ligësisë dhe erdhi koha për ndëshkimin që i ishte premtuar Judës. Perëndia lejoi që ushtria e mbretit Nebukadnetsar të pushtonte Judën, të shkatërronte Jerusalemin dhe t'i merrte shumë nga qytetarët e Judës si robër në Babiloni. Kjo ishte një periudhë e tmerrshme për popullin e zgjedhur të Perëndisë, mirëpo ishte e gjitha pjesë e planit të Tij. Perëndia i inkurajoi izraelitët të vendoseshin në Babiloni dhe ta bënin atë shtëpinë e tyre të re. Premtimi i Tij ishte që ata do të përparonin e nuk do të shkatërroheshin. Pas shtatëdhjetë vitesh ata do të ktheheshin në shtëpinë e tyre, në Tokën e Premtuar. Nga ky episod në historinë e Judës, kuptojmë se mund t'i besojmë planit të Perëndisë për jetën tonë.

Gjatë robërimit të Judës në Babiloni, ishte një djalë i quajtur Daniel dhe tre shokët e tij. Ata kishin lindur në familje mbretërore dhe fisnike në Judë, por tanimë nuk ishin gjë tjetër veçse shërbëtorët e mbretit Nebukadnetsar. Kur iu tha të hanin ushqimin e mbretit – ushqim që do t'i ndotte – ata kërkuan leje për të ngrënë vetëm perime dhe për të pirë vetëm ujë, që të vazhdonin të jetonin sipas pëlqimit të Perëndisë. Perëndia i bekoi djemtë e rinj me shëndet, urtësi dhe njohuri. Madje Perëndia i dha Danielit aftësinë për të kuptuar vizione dhe ëndrra. Pas tre vitesh në shërbesë, në vend që t'i gjente të dobësuar, siç kishin frikë disa, mbreti Nebukadnetsar i gjeti dhjetë herë më të mençur se bashkëmoshatarët e tyre në Babiloni. Jetët e Danielit, Shadrakut, Meshakut dhe Abednegos duhet të na inkurajojnë të jetojmë gjithmonë siç i pëlqen Perëndisë.

Kur mbreti Nebukadnetsar pa një ëndërr shqetësuese, ai thirri "burrat e urtë" dhe i sfidoi t'i shpjegonin kuptimin e ëndrrës. Ai u premtoi dhurata, shpërblime dhe nderime të mëdha kujtdo që do t'ia tregonte. Kur i thanë se askush nuk mund të bënte atë që kishte kërkuar, Nebukadnetsari urdhëroi ekzekutimin e të gjithë burrave të urtë në Babiloni. Kur e dëgjuan këtë, Danieli dhe tre shokët e tij kërkuan urtësinë e Perëndisë, që Danieli të mund të interpretonte ëndrrën dhe që burrat e urtë të mos vriteshin. Kur Perëndia ia plotësoi kërkesën, Danieli interpetoi ëndrrën dhe me përulësi ia dha të gjitha meritat Perëndisë. Mbreti Nebukadnetsar pranoi Perëndinë e Danielit dhe e shpalli Perëndinë e perëndive, Zotin e mbretërve dhe zbuluesin e sekreteve. Danieli dhe miqtë e tij morën të gjitha gjërat që mbreti kishte premtuar. Ngjarja e Danielit dhe mbretit Nebukadnetsar na mëson rëndësinë e të kërkuarit të urtësisë nga Perëndia.

Edhe pse mbreti Nebukadnetsar e pranoi Pe rëndinë e Danielit si Ai që zbulon ëndrrat, gjithsesi nuk ndaloi së adhuruari perënditë e rreme, të bëra nga njeriu. Në fakt, ai ngriti

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

një figurë prej ari që ishte gati 30m e lartë dhe gati 3m e gjerë, dhe urdhëroi që çdokush në mbretëri ta adhuronte. Kur Shadraku, Meshaku dhe Abednego nuk pranuan t'i bindeshin këtij urdhri, mbreti Nebukadnetsar i kërcënoi se do t'i hidhte në furrën e ndezur. Të armatosur me besim në fuqinë e Perëndisë për t'i çliruar, tre shokët besnikë e kundërshtuan dhe u hodhën mes flakëve. Mbreti Nebukadnetsar pa ndërsa Shadraku, Meshaku dhe Abednego, si dhe një i katërt që iu bashkua mrekullisht, ecën përmes zjarrit të padëmtuar. Mbreti urdhëroi që tre shokët të nxirreshin nga zjarri, lavdëroi Perëndinë e tyre dhe i shpërbleu me ngritje në detyrë. Shadraku, Meshaku dhe Abednego janë shembuj të vërtetë të kurajës dhe besimit në fuqinë e Perëndisë.

Ashtu siç kishte parathënë Perëndia përmes ëndrrës së mbretit Nebukadnetsar, Babilonia u pushtua nga fuqia tjetër që erdhi në botë. Mbreti i ri, Dar, e admironte Danielin dhe donte ta ngrite në detyrë që ai të mbikëqyrte mbretërinë e tij. Zyrtarët e tjetër të Babilonisë e manipuluan mbretin Dar që të nxirrte një ligj të ri që ndalonte rreptësisht lutjen ndaj çdo mbreti tjetër. Ata që nuk i bindeshin këtij dekreti do të hidheshin në gropën e luanëve. Kur Danieli vazhdoi t'i lutej me besnikëri të vetmit Perëndie të vërtetë, mbreti Dar nuk kishte zgjidhje tjetër veçse ta hidhte këshilltarin e tij të besuar në gropën e luanëve. Perëndia dërgoi engjëllin e Tij që të mbronte Danielin dhe luanët u ushqyen me zyrtarët e tjerë të Babilonisë. Pavarësisht kërcënimit për vdekje, Danieli tregoi se si të gjithë ne duhet të qëndrojmë të përkushtuar ndaj Perëndisë.

Pas vdekjes së mbretit Dar, pasardhësi i fronit ishte djali i tij i dytë, i njohur si mbreti Asuero I-rë. Libri i Esterit filloi me shkarkimin e mbretëreshës Vashti për shkak se nuk pranoi t'i bindej një kërkese vulgare nga mbreti Asuero si dhe me zëvendësimin e saj nga një vajzë e bukur judease e quajtur Ester, e cila ishte rritur nga i afërmi i saj, Mardokeu. Mbreti Asuero, nxitur nga i besuari i tij hakmarrës, Hamani, në padije të prejardhjes judaike të gruas së tij të re, firmosi ligjin për të ekzekutuar të gjithë judenjtë. Esteri e dinte se Perëndia mund ta përdorte për të shpëtuar popullin e saj, mirëpo do t'i duhej të rrezikonte jetën e saj për t'u paraqitur para pranisë së mbretit, të zbulonte prejardhjen e saj dhe të nxirrte në dritë planin e ligë të Hamanit për të shfarosur popullin jude. Mbreti i zemëruar e anuloi gjenocidin e pamend dhe ekzekutoi Hamanin. Frymëzuar nga ngjarja e Esterit dhe duke u mbështetur nga Perëndia ynë i plotfuqishëm, edhe ne mund të përdoremi prej Tij po të jemi të gatshëm të ndërmarrim rreziqe për të vepruar drejt.

Më në fund do të marrim një ditë për të reflektuar e për të kujtuar gjithçka që Perëndia na ka mësuar gjatë këtij tremujori. Ju ftojmë të na bashkoheni tremujorin e ardhshëm, ndërsa do të rikthehemi te libri i Zanafillës dhe do të studiojmë krijimin e botës dhe shpalosjen e planit të Perëndisë për të na shpëtuar nga mëkati. Zoti të bekoftë që ke shërbyer me përulësi!

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 1
2 i Mbretërve 5:1-15a

Kupto si duhet:	Naamani shërohet nga lebra pasi një vajzë e re i tregon për besimin e saj.
Mendo si duhet:	"Prandaj, o vëllezërit e mi të dashur, qëndroni të fortë e të patundur, duke tepruar përherë në veprën e Zotit, duke e ditur se mundi juaj nuk është i kotë në Zotin." 1 e Korintasve 15:58 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do t'u tregoj me guxim të tjerëve për Perëndinë tonë madhështor.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndiej gëzim kur u tregoj të tjerëve për Perëndinë tonë madhështor.

PËRGATITU!

Këtë javë do të mësojmë se si Perëndia përdori një vajzë të re për t'i sjellë shërim një komandanti ushtrie me emrin Naaman. Ajo ishte e guximshme për besimin e saj dhe me hir i tregoi Naamanit se Perëndia mund ta shëronte. Ndërsa përgatitemi për të udhëhequr fëmijët, le të lutemi që ata të bëhen dëshmitarë të guximshëm të Perëndisë madhështor, pavarësisht çmimit.

Lutu: Ndërsa nisim këtë tremujor, lutu që Perëndia t'ia shfaqë veten nxënësve të tu. Kërkoji Perëndisë të të japë aftësinë për të udhëhequr me dashuri, mjeshtëri dhe saktësi biblike, si një formë adhurimi për Perëndinë e vërtetë.

Lexo: 2 i Mbretërve 5:1-15a

Kupto si duhet: Naamani shërohet nga lebra pasi një vajzë e re i tregoi për besimin e saj
Mësimi i parë na nxjerr jashtë Izraelit, në tokën pagane të Aramit. Atje ishte një vajzë e re izraelite, marrë skllave nga ushtria e Aramit, e cila punonte për familjen e një burri të quajtur Naaman. Naamani ishte komandanti i ushtrisë së Aramit dhe ishte prekur nga lebra. Kjo vajzë e re shpalli besimin e saj, pavarësisht rrethanave, kur tregoi me guxim se profeti i Perëndisë në Izrael, Eliseu, mund ta shëronte Naamanin. Prej saj mësojmë se si t'u tregojmë me guxim të tjerëve për Perëndinë tonë madhështor.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënime për mësuesin kryesor:

- Duhet kurajë për t'u folur me guxim njerëzve për Jezusin! Sa herë që ti shpall Ungjillin me nxënësit e tu, po modelon për ta mënyrën se si ta shpallin ata Ungjillin me miqtë e tyre. Përgatiti nxënësit duke u treguar se disa nga shokët e tyre do të zgjedhin të mos besojnë kur ta dëgjojnë Ungjillin. Sfidoji të luten për ta kur të ndodhë kjo.
- Për t'i lidhur mësimet e këtij tremujori me njëri-tjetrin, mblidh objekte nga çdo mësim dhe pastaj përdori për të rishikuar mësimet e mëparshme gjatë kohës së rishikimit apo për të prezantuar mësimin.
- Ka shumë mite dhe keqkuptime për lebrën. Në fakt, fjala "lebër" në Dhiatën e Vjetër është përdorur për disa lloje të ndryshme sëmundjesh që prekin lëkurën. Në rastin e Naamanit, dimë se në atë kohë nuk kishte kurë dhe ai kishte vërtet nevojë për shërim, për shkak se sëmundja kishte prekur mishin e tij.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Zgjidh një ose dy nxënës që të dalin para klasës. Ndërsa përshkruan Naamanin apo vajzën e re, shto objekte (ide për Naamanin: parzmore, medalje rreth qafës, pluhur të bardhë në krahët e tij për të nënkuptuar lebrën, etj.; ide për vajzën e re: vendosi një shall në kokë, jepi një fshesë, një leckë, një pastruese pluhurash apo ndonjë tjetër objekt që tregon se ajo ishte shërbëtore).
2. Vizato siluetën e një burri dhe një vajze në një letër tabak ose në tabelë, pastaj shto foto të objekteve që ndihmojnë në përshkrimin e tyre.
3. Silli objektet dhe vendosi në një tavolinë të gjatë ndërsa shpjegon. Përdori këto objekte për të përsëritur mësimin në fund të takimit.
4. Prit një sfungjer në formë njeriu dhe mbuloje me pluhur të bardhë. Merr një kovë/legen me ujë dhe në momentin e duhur gjatë mësimit "laje lebrën" duke zhytur sfungjerin në ujë.
5. Përdor pudër për bebe dhe ujë (sepse mielli ngjit) për të krijuar një sëmundje lëkure në krah, pastaj laje ndërsa zhyt krahun në ujë.

NISU!

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Koha e zbulimit: Kush është Perëndia?

Qëllimi: Të bëjmë një deklaratë të guximshme, që e shohin të gjithë, duke bërë një punim grafik në trotuar me fjalë që përshkruajnë Perëndinë tonë madhështor.

Aktiviteti: Trotuar

Mjetet:

- Shkumësa me ngjyra për të vizatuar në trotuar

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Mblidhi nxënësit dhe shpjegoju se do të bëjnë një punim grafik gjigant duke përdorur fjalë që përshkruajnë **Perëndinë tonë madhështor**, që çdokush të mund ta shohë.
2. Kërkoju nxënësve të shkruajnë fjalë apo të vizatojnë pamje që përshkruajnë madhështinë e Perëndisë. Sugjerim: Nëse vizatoni, bëni një përshkrim të shkurtër përkrah figurës, që të jepet kuptimi i qartë. Inkurajoji nxënësit të përdorin 12 vargjet kyç, vargje të tjera, ose mësimet e mëparshme.
3. Për shembull:
    - Perëndia është i plotfuqishëm! Jozueu 1:9
    - Unë mund t'i besoj Perëndisë! Fjalët e Urta 3:5-6
    - Jezusi është Shpëtimtari im! Gjoni 14:6
    - Perëndia është dashuri! Gjoni 3:16
    - Perëndia dërgoi Jezusin si dhuratë për mua! Efesianëve 2:8-9
    - Perëndia shëron! (tremujori i kaluar: Jezusi shëroi një të paralizuar dhe gruan e sëmurë)
    - Perëndia bën mrekulli! (tremujori i kaluar: Jezusi ringjalli një vajzë të re dhe Llazarin)
4. Kujtoju nxënësve se këto deklarata do t'i shohin shumë njerëz që do të kalojnë pranë kishës sot, por edhe gjatë javës. Inkurajoji të shkruajnë me guxim për **Perëndinë e tyre madhështor**!

Këshilla për drejtuesin:

- Të gjithë drejtuesit duhet të përfshihen duke i pyetur nxënësit: "Si do ta përshkruaje Perëndinë?" ose "Po të të pyesnin: 'Kush është Perëndia?', çfarë do të thoje?"
- Për nxënësit më të vegjël, shkruaj fjalë me shkronja të mëdha dhe kërkoju t'i ngjyrosin.
- Nëse ka fëmijë të rinj apo për herë të parë, të cilët nuk e kanë të qartë se çfarë të shkruajnë, shëno disa fjalë dhe vargje në kartona të vegjël që t'i shohin aty dhe pastaj t'i shkruajnë në trotuar.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

- Të gjithë nxënësit duhet të marrin pjesë në një mënyrë a një tjetër (ose duke diskutuar me drejtuesin, ose duke vizatuar).
- Cakto një çmim për vizatimet më krijuese!
- Përdor një dron për t'u bërë video veprave të artit, pastaj postojeni në media sociale duke shkruar: "Fëmijët tanë duan që ju të dini se sa i madh është Perëndia!"
- Nëse nuk është moti i mirë dhe nuk dilni dot jashtë, bëjeni punimin me shkumës në një karton të madh të zi. Kur të përfundoni, vendoseni kartonin në një vend ku mund ta shohin shumë njerëz.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – Lidhja e KZ-së me mësimin: Kush është Perëndia? *Ndihmoji nxënësit të përgjigjen me siguri dhe bindje*. A ishte e lehtë apo e vështirë puna me shkumës në trotuar/karton? Po sikur të njëjtën gjë t'ua kërkoja ta bënit te shkolla juaj? Nuk duhet të keni kurrë turp të flisni me guxim për Perëndinë. Perëndia është i plotfuqishëm, i dashur, i mirë, i gjithëdijshëm, e shumë më tepër se kaq! Kur e di se sa i fuqishëm është Perëndia, mund t'u flasësh të tjerëve me guxim dhe me siguri për Të. Kjo është rëndësishme sidomos në periudha të vështira. Do të mësojmë më shumë rreth kësaj në mësimin e sotëm. A jeni gati të mësojmë se si t'u flasim me guxim njerëzve për Perëndinë?

Lutu: *Sfido njërin nga nxënësit t'i lutet me guxim Perëndisë së vetëm të vërtetë para se të filloni mësimin. Kujtojua të ulin kokën në respekt ndaj Perëndisë ndërsa luteni. Çfarë duhet të bësh nëse askush nuk del vullnetar për t'u lutur? Zgjidh një nga fëmijët me më shumë pjekuri frymërore dhe nxite të lutet. Thuaji se e ke zgjedhur për shkak të pjekurisë frymërore dhe aftësive të udhëheqësisë. Kujtoni se është nder të udhëheqësh në lutje.*

Gjeje: *Kërkoju nxënësve të përmendin librat e Dhiatës së Vjetër deri te 2 i Mbretërve, duke u drejtuar te posteri i librave të Biblës, i varur në mur. Shqiptoi qartësisht librat, që nxënësit të mësojnë se si thuhet secili emër. Kujtojua atyre t'i marrin çdo javë me vete Biblat, që të mësojnë se si t'i përdorin. Shpjegoju se kur hapim Biblën, kërkojmë librin, kapitullin (numri i madh) dhe vargun (numri i vogël). Sfidoji të gjejnë 2 i Mbretërve 5:1-15a. Për nxënësit që dinë të gjejnë referencat, përdor metodën "Stërvitja me shpata".*

Çfarë është "Stërvitja me shpata"? Ndërsa shpjegon, thuaj: "Biblat lart!". Nxënësit duhet t'i mbajnë krahët lart me Biblat drejtuar nga tavani. Pastaj ti thua librin, kapitullin dhe vargun. Nxënësit duhet t'i përsërisin pas teje. Pasi të gjithë të kenë përsëritur librin, kapitullin dhe vargun, ti thua: "Nisuni!". Nxënësi i parë që e gjen vargun dhe vendos gishtin te vargu, fiton një etiketë shpërblyese.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Kronologjia: Këtë tremujor do e nisim në Dhiatën e Vjetër. Gjatë tremujorit të kaluar kemi parë Dhiatën e Re, që do të thotë se këtë tremujor do të "kthehemi pas në kohë".

Ide alternative: Vendos një shigjetë prej letre në figurën që përkon me mësimin. Shigjeta prej letre mund të jetë një mjet i mirë për përsëritje në fund të tremujorit. (burim i printueshëm)



Prezantimi me mësimin nga Bibla: Tremujorin e kaluar kemi studiuar për jetën e Jezusit dhe për kishën e hershme në Dhiatën e Re. Tani është koha të kthehemi në kohërat e Dhiatës së Vjetër, para se Jezusi të kishte lindur. Edhe pse Jezusi nuk ecte në tokë me trup njerëzor në ato kohëra, ne shohim se Perëndia e kishte bërë tashmë planin për ta sjellë Jezusin në tokë, që të na shpëtonte nga mëkati. *Drejtohu te kronologjia e Biblës.*

A ju kujtohet se çfarë është një profet? (*Shënim: Nxënësit e kanë mësuar këtë në tremujorin e parë të vitit të tretë*) Profeti është ai që u jep njerëzve një mesazh nga Perëndia. Mesazhet quhet profeci dhe profecitë janë fjalët e Perëndisë për atë që do të ndodhë në të ardhmen. Profecitë nga Perëndia janë të vetmet të vërteta dhe profetët ishin ndihmësit e Tij të veçantë.

Mësimi i sotëm zhvillohet në kohën e Eliseut. A ju kujtohet Eliseu? Ai ishte njëri nga profetët e Perëndisë në kohën kur Izraeli kishte mbretër. *Drejtohu te emri i Eliseut në kronologjinë e Biblës.* Fillimisht, Eliseu ishte shërbëtori i Elias. Ai mësoi nga Elia derisa diçka e jashtëzakonshme ndodhi. Kush e kujton se çfarë i ndodhi Elias? (Elia u mor në qiell, në një stuhi ere mbi një karrocë me kuaj, e cila ishte në flakë)

Mësimi i sotëm ka shumë personazhe, mirëpo ne do të përqendrohemi vetëm te dy prej tyre. I pari është një burrë i quajtur Naaman, nga vendi i Aramit. E dyta është një vajzë e re izraelite.

Përvijimi i Shkrimit: 2 i Mbretërve 5:1-15a

<u>Kush është Naamani?</u>

Mbyllini sytë dhe imagjinoni personin që do të përshkruaj. Pasi të kem përfunduar, do t'ju bëj disa pyetje për këtë njeri. A jeni gati?

Lexo 2 i Mbretërve 5:1

Përmbledhje: Ua! Çfarë ishte Naamani? Prej nga vinte? (Nga një vend i quajtur Aram) *Nxënësve më të rritur tregoju Izraelin dhe Aramin në hartën e kohëve të Biblës. Thuaju se tani Arami quhet Siri.* Arami ishte armiku i Izraelit.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Njerëzit në Aram nuk besonin dhe nuk adhuronin Perëndinë e vërtetë; ata adhuronin perëndi të rreme.

Çfarë pune bënte Naamani? (Ai ishte komandanti i ushtrisë së Aramit) Përse ishte kaq i rëndësishëm Naamani? (Ai udhëhoqi ushtrinë e Aramit dhe fitoi betejat) Përse arriti të fitonte Naamani me ushtrinë me tij? (Perëndia lejoi që ushtria e tij të fitonte) Ua! Perëndia ynë është shumë i fuqishëm!

Çfarë problemi kishte Naamani? (Ai kishte lebër) A e dini se çfarë është lebra? Është një sëmundje lëkure që askush nuk dinte se si ta kuronte në atë kohë. Nuk e dimë ekzaktësisht se si e kishte prekur Naamanin, mirëpo dimë se kishte prekur mishin e tij (efektet e sëmundjes ishin të dukshme për të tjerët) dhe se ai kishte nevojë për shërim. Le të zbulojmë për personazhin tjetër të mësimit. Dëgjoni me vëmendje detajet për këtë person.

Kush është vajza e re?

Lexo 2 i Mbretërve 5:2

Përmbledhje: A e dimë emrin e vajzës së re? (Jo) Nga vinte vajza e re? (Nga Izraeli) Ku gjendej tani? (Në Aram) Si shkoi vajza e re nga Izraeli në Aram? (Ajo ishte marrë skllave) Kjo do të thotë se ishte rrëmbyer nga populli i Aramit. Çfarë ndodhi me vajzën e re pasi u rrëmbye nga Izraeli? (Ajo u bë shërbëtorja e gruas së Naamanit)

A mendoni se ishte periudhë e lehtë apo e vështirë për të? *Lejoji nxënësit të përgjigjen.* Duke qenë se ishte rrëmbyer nga familja dhe duhet të jetonte pa ta në një vend të huaj, ka shumë gjasa të ketë qenë një periudhë e vështirë për të. Nëse ti do të gjendeshe në një situatë të vështirë, cilat vargje do të mund të vinin në mendje? (Jozueu 1:9 ose 1 e Korintasve 15:58) Le të zbulojmë se çfarë bëri vajza e re.

Vajza e re izraelite tregon kurajë dhe guxim duke i treguar Naamanit se si të kurohet

Lexo 2 i Mbretërve 5:3

Përmbledhje: Çfarë bëri vajza e re? (Për shkak të besimit të saj në Perëndinë, ajo kishte kurajë për t'i treguar gruas së Naamanit për dikë që mund ta shëronte) Kush ishte personi që mund ta shëronte Naamanin? (Ishte profeti i Perëndisë) Vajza e dinte se Perëndia i kishte dhënë njërit prej profetëve të Tij në Izrael fuqinë për të shëruar dhe tani, edhe pse ajo ishte shërbëtorja e tyre, po u tregonte me guxim për profetin e Perëndisë madhështor. Kujtoni që Naamani dhe kombi i tij ishin armiq të Izraelit. A mendoni se kjo vajzë po vepronte drejt? *Jepu kohë nxënësve të mendojnë për këtë pyetje.* Le të zbulojmë se çfarë ndodhi!

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Naamani shkon në Izrael

Parafrazim i 2 i Mbretërve 5:4-6:

Naamani mori leje dhe një letër nga mbreti i Aramit që të shkonte në Izrael për t'u shëruar. Naamani mori një letër nga mbreti i Aramit që t'ia çonte mbretit të Izraelit. A mendoni se mbreti i Izraelit u entuziazmua nga letra? Le të lexojmë dhe ta zbulojmë.

Mbreti i Izraelit nuk varet në fuqinë e madhe të Perëndisë

Lexo 2 i Mbretërve 5:7 me intonacion

Përmbledhje: Mbreti i Izraelit nuk mendonte se ndokush mund të shëronte lebrën e Naamanit. Ai nuk besonte në Perëndinë tonë madhështor, sic besonte vajza e re izraelite. Përkundrazi, ai mendoi se mbreti i Aramit po përpiqej të debatonte.

Eliseu i tregon Naamanit se si të shërohet

Lexo 2 i Mbretërve 5:8-10

Përmbledhje: Çfarë i tha profeti Elise Naamanit për të bërë, që të shërohej? (Të lahej shtatë herë në lumin Jordan) A duket si mënyrë e lehtë për t'u shëruar nga lebra? (Po) Çfarë mendoni se bëri Naamani? Le ta zbulojmë.

Naamani zemërohet

Lexo 2 i Mbretërve 5:11-12 me intonacion

Përmbledhje: Naamani u zemërua! Përse mendoni se u zemërua? Naamani mendonte se Eliseu do të tundte dorën dhe do t'i kërkonte Perëndisë ta shëronte. Gjithashtu mendonte se lumenjtë në Aram ishin shumë më të mirë se lumenjtë në Izrael. Po pyeste veten se përse nuk mund të lahej në njërin nga lumenjtë në Aram. Naamani nuk donte t'i bënte gjërat siç i pëlqente Perëndisë, Ai dëshironte t'i bënte gjërat siç donte vetë! Çfarë quhet kjo? Krenari, që është mëkat. Mirëpo...

Naamani shërohet sipas mënyrës së Perëndisë

Lexo 2 i Mbretërve 5:13-14

Përmbledhje: Shërbëtorët e bindën Naamanin që t'i bënte gjërat siç donte Perëndia dhe ai u shërua nga lebra! Ua! Gjithçka që duhej të bënte ishte të përulej e të lahej shtatë herë në lumin Jordan. Perëndia është aq i fuqishëm saqë e bëri të thjeshtë! Si mendoni se u ndie Naamani?

Naamani beson në Perëndinë

Lexo 2 i Mbretërve 5:15a (*Shënim: Lexo vetëm dy fjalitë e para. Mos lexo: "Të lutem pranoje këtë dhuratë nga shërbëtorja jote." Refuzimi i dhuratës dhe nënkuptimet nuk do të mbulohen në këtë mësim.)*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përmbledhje: A besonte tani Naamani në Perëndinë tonë madhështor? (Po)
Për nxënësit më të rritur: Si mund të ndikonte kjo ngjarje te kombi kur të kthehej?

Përfundimi

Vajza e re izraelite kishte besim në Perëndinë dhe tregoi me guxim se profeti i Perëndisë mund ta shëronte Naamanin. Edhe ju mund të jeni të guximshëm si kjo vajzë e re. Mund t'i tregoni me guxim njerëzve se si Perëndia mund të falë mëkatin, që ata të shërohen frymërisht. Në fund Naamani veproi sipas pëlqimit të Perëndisë dhe u shërua plotësisht. Jo vetëm që u shërua, por edhe besoi në Perëndinë tonë të madh.

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

Nëse Perëndia mund të përdorë një vajzë të re izraelite, a mund të të përdorë edhe ty? (Po!) A do ta ndjekësh shembullin e saj duke u treguar me guxim të tjerëve për Perëndinë? Mendoni për "Kohën e zbulimit" sot; keni shkruar me guxim të vërteta për Perëndinë. A jeni të gatshëm të jeni po aq të guximshëm këtë javë në lagjen tuaj apo në skuadrën e sportit?

Bibla nuk e tregon, mirëpo mund të imagjinojnë se si u ndie vajza e re kur Naamani u kthye plotësisht i shëruar nga lebra dhe me besim te Perëndia i saj madhështor. A mendoni se ajo ndjeu gëzim të madh duke ditur se Perëndia e përdori atë në jetën e Naamanit?

A e dini se si dëshiron t'ju përdorë Perëndia? Ai dëshiron që ju t'u tregoni me guxim njerëzve se si mund të marrin falje për mëkatin duke besuar në Jezusin. Perëndia siguroi rrugën që Naamani të shërohej nga lebra. Ai duhej të lahej shtatë herë në lumin Jordan. Perëndia siguroi rrugën që njerëzit të merrnin faljen nga mëkati dhe të shërohen frymërisht.

Që të marrësh falje dhe të shërohesh frymërisht, duhet të pranosh me përulje se ke nevojë për një Shpëtimtar. Si e dimë këtë? Secili prej jush, individualisht, duhet të besojë në Jezusin (faqja e kuqe e "Librit pa fjalë") që të shpëtoni nga ndëshkimi i mëkatit (faqja e errët e "Librit pa fjalë") dhe duhet ta bëni Atë udhëheqësin e jetës suaj. A keni marrë falje për mëkatin? Nëse jo, a do të donit të mësoni se si të merrni falje? *Mundësi për të shpallur Ungjillin përmes "Librit pa fjalë".* Nëse keni shpëtuar nga mëkati, falënderoni Perëndinë për atë që ka bërë për ju. A jeni gati t'u flisni me guxim njerëzve? *Mundësi për të nxitur dikë të shpallë Ungjillin përmes "Librit pa fjalë". Kujtoju gëzimin që do të ndiejnë ndërsa Perëndia i përdor për të ndihmuar dikë të shpëtojë nga mëkati, të shërohet frymërisht dhe të marrë jetë të përjetshme.*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Për nxënësit më të rritur: Çfarë ndodh kur u tregon me guxim miqve për Jezusin dhe ata e refuzojnë të vërtetën? Ata madje mund të të tallin ose të mos jenë më shokë me ty. Fillimisht nuk do të ndihesh mirë, mirëpo thellë në zemër mund të jesh i sigurt se ke bërë gjënë e duhur. Vini re se posteri "Ndihu si duhet" nuk titullohet "Ndihu mirë", por "Ndihu si duhet". Të dëshmosh për besimin nuk është gjithmonë e thjeshtë. Mirëpo, edhe nëse shokët e tu e refuzojnë Jezusin, a do të qëndrosh i fortë, a do të lutesh për ta dhe a do të vazhdosh t'i duash? Të jesh i krishterë i guximshëm nuk është gjithmonë e thjeshtë, por Perëndia është gjithmonë me ty.

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Kush ishte Naamani dhe çfarë problemi kishte? (Naamani ishte komandanti i ushtrisë së Aramit dhe ai kishte lebër)
2. Çfarë bënte vajza e re izraelite në vendin e Aramit? (Ajo ishte marrë skllave nga Izraeli dhe ishte detyruar të bëhej shërbëtorja e gruas së Naamanit)
3. Çfarë i tregoi me guxim vajza e re izraelite gruas së Naamanit? (Ajo i tha se profeti në Izrael mund ta shëronte Naamanin nga lebra)
4. Çfarë i tha Eliseu Naamanit të bënte që të shërohej? (Të lahej shtatë herë në lumin Jordan)
5. A ishte i lumtur Naamani për mënyrën se si Perëndia do e shëronte? (Jo) Përse jo? (Sepse ai donte të shërohej sipas mënyrës së tij)
6. A iu bind Naamani udhëzimeve të Eliseut? (Po) Çfarë ndodhi? (Ai u shërua plotësisht nga lebra dhe besoi në Perëndinë tonë madhështor)
7. A mund të përdorë Perëndia një person të ri në moshë si ju, ashtu siç përdori vajzën e re izraelite? (Po) Si? (Që t'u tregoni me guxim njerëzve se Jezusi mund t'i shpëtojë nga mëkati)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 2
2 i Mbretërve 20:1-7

Kupto si duhet:	Mbreti Ezekia lutet me siguri.
Mendo si duhet:	"Lutuni pa pushim." 1 e Thesalonikasve 5:17
Vepro si duhet:	Unë do të lutem për gjithçka.
Ndihu si duhet:	Unë mund të kem durim, sepse e di që Perëndia i dëgjon lutjet e mia.

PËRGATITU!

Kur u përball me lajme të tmerrshme, mbreti Ezekia ia dorëzoi shqetësimet e tij Perëndisë në lutje. Kur e studiojmë këtë mësim, shohim se sa besnik është Perëndia ynë, sepse na dëgjon dhe i përgjigjet thirrjes sonë për ndihmë. Le të lutemi këtë javë që Perëndia të na e shtojë dëshirën për t'u lutur dhe për ta kërkuar Atë në gjithçka.

Lutu: Para se të përgatitesh për të shërbyer, shko përpara Perëndisë dhe lutu që Ai të bëjë diçka të mrekullueshme gjatë takimit këtë javë. Falënderoje që ke mundësinë të shpallësh lajmin e mirë me fëmijët.

Lexo: 2 i Mbretërve 20:1-7

Kupto si duhet: Mbreti Ezekia lutet me siguri
Që prej lindjes (ngjizjes) së tyre si komb, populli i Izraelit kishte rebeluar kundër Perëndisë. Kur kërkuan me ngulm një mbret, Perëndia i paralajmëroi për pasojat, megjithatë ua plotësoi dëshirën. Një nga pasojat e rebelimit të Izraelit ishte ndarja e mbretërisë në dy pjesë – Juda dhe Izraeli. Pas kësaj ndarjeje, të gjithë mbretërit e Izraelit dhe shumë prej mbretërve të Judës, bënë atë që ishte e keqe në sytë e Zotit dhe e çuan popullin larg Tij. Megjithatë, kishte disa mbretër në Judë që i besonin Perëndisë dhe bënin atë që ishte e drejtë në sytë e Tij. Një nga këta mbretër ishte Ezekia. Ezekia u lut dhe qau, pasi profeti i Perëndisë i tha se do të vdiste. Perëndia iu përgjigj lutjes së Ezekias me 'po' dhe i dha edhe pesëmbëdhjetë vite të tjera jete. Ezekia na inkurajon <u>të lutemi për gjithçka</u>.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënime për mësuesin kryesor:

- Lutja lidhet me një pyetje të zakonshme të fëmijëve: “Si ta dimë se Perëndia është i vërtetë?”. Të paraqitesh para Perëndisë me siguri ndërsa e adhuron dhe kërkon ndihmën e Tij, na ndihmon të vërtetojmë se Perëndia është i vërtetë për shkak se Ai u përgjigjet lutjeve tona! Si i është përgjigjur Perëndia lutjeve të tua? Mënyra se si i përgjigjesh kësaj pyetjeje do të të ndihmojë ta shpjegosh mësimin me pasion.
- Është e rëndësishme të rishikojmë mesazhin e Ungjillit siç citohet në fillim të mësimit. Lutja ndërtohet në një marrëdhënie me Perëndinë.
- Ky mësim mbulon një pasazh të shkurtër nga Shkrimi, i cili do të lexohet i plotë, shoqëruar me komente shtesë nga mësuesi, si dhe me pyetje e përgjigje midis pasazheve. Mësuesit duhet t’i mbajnë Biblat hapur gjatë gjithë mësimit, ndërkohë që nxënësit ndjekin nga Bibla e tyre. Ndihmoni të vegjëlit ose ata që janë për herë të parë.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Ndërkohë që nxënësit hyjnë në klasë, inskeno mbretin Ezekia të shtrirë në shtrat me fytyrë nga muri. Filloje mësimin duke nxitur kureshtjen për këtë burrë të shtrirë dhe se çfarë mund t’i ketë ndodhur. Trajtoje çështjen si mister që duhet zgjidhur hap pas hapi.
2. Ndërkohë që shpjegon, nxirr objekte nga një kuti: fiq, kurorën e mbretit, etj.
3. Kërkoji dikujt të luajë rolin e Ezekias.
4. Krijoji personazhet me kartonin e letrës higjenike.

NISU!

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t’i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Fusha e shkronjave të lutjes!

Qëllimi: Të prezantojmë vlerën, urgjencën dhe nevojën e **lutjes**.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Aktiviteti: Hapësirë e madhe brenda ose jashtë

Mjetet:

- Konë ose shkumës (për të shënuar vijën e nisjes)
- Shkumës, konë ose flamuj të vegjël trekëndësh (për të përkufizuar "fushën e shkronjave)
- 120 sete me shkronjat **L, U, T, U** si dhe shkronja të tjera për ngatërresë (burim i printueshëm)
- Një tabelë e madhe për çdo skuadër (tabela mund të jetë prej kartoni, mund të jetë edhe një copë e madhe, ose mund të krijoni një katror me ngjitës të fortë)
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për ambientin: Cakto një hapësirë të madhe si "Fusha e shkronjave". Shpërndaji shkronjat gjithandej. Disa prej tyre duhet të gjenden lehtësisht, të tjerat duhet të jenë pak më të vështira për t'u gjetur (pas një shkurreje apo një peme, të vendosura mbrapsht, etj). Krijo një vijë të gjatë nisjeje. Cakto një hapësirë për secilën skuadër.

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Të gjithë nxënësit do të nisin nga vija e nisjes dhe do të vrapojnë njëkohësisht, megjithëse secila nga skuadrat do të ketë tabelën e vet.
2. Synimi është që të gjithë të garojnë për të gjetur një nga shkronjat që formon fjalën **"LUTU"** dhe të kthehen te tabela e skuadrës bashkë me shkronjën. Pra, atyre nuk u lejohet të marrin më shumë sesa një shkronjë në dorë.
3. Nxënësit duhet të përpiqen të qëndrojnë larg shkronjave shpërqendruese që nuk bëjnë pjesë në fjalën **"LUTU"**.
4. Kur marrin një shkronjë, shkojnë te tabela e skuadrës dhe e ngjisin shkronjën, për të formuar fjalën **"LUTU"**.
5. Cakto disa nxënës, me aftësi udhëheqësie, që të shënojnë pikët. Ata duhet të caktojnë një person që pret ngjitësin, dikë që vendos shkronjat në vendin e duhur dhe personat që do të vrapojnë për të marrë shkronja të tjera. Kjo është një mundësi e mirë për t'i sfiduar nxënësit të mendojnë për punën në skuadër dhe për unitetin.
6. Pasi të jetë vendosur shkronja në vendin e duhur në tabelë, nxënësit mund të nisen për të gjetur shkronjën tjetër.
7. Pas dhjetë minutash, skuadra që e ka formuar më shumë herë fjalën **"LUTU"**, do fitojë nga tre etiketa shpërblyese për çdo anëtar.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Shënim: Mbaj ritëm të shpejtë për gjetjen e shkronjave. Fëmijët duhet të vrapojnë!

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – Lidhja e KZ-së me mësimin: Cilën fjalë keni formuar shumë herë sot gjatë "Kohës së zbulimit"? (LUTU) Sa herë arritët ta formonit fjalën "LUTU"? Ishte e mrekullueshme se sa shpejt e formonit fjalën e sa të përqendruar ishit. Ndonjëherë e pyes veten se çfarë do të ndodhte nëse do të përqendroheshim kaq shumë në jetën tonë të lutjes. Kjo më kujton një mbret në Bibël. A e gjeni dot se për cilin mbret po mendoj specifikisht? Le ta zbulojmë te mësimi nga Bibla.

Lutu: *Inkurajo njërin nga nxënësit ta udhëheqë klasën në lutje. Sfidoje të ngrihet dhe të lutet me zë që ta dëgjojnë të gjithë. Kjo do t'i ndihmojë nxënësit që të mësojnë të luten në publik dhe që të zhvillojnë aftësinë e udhëheqësisë frymërore.*

Zbuloje: Le t'i hapim Biblat te 2 i Mbretërve. A gjendet 2 i Mbretërve në Dh. V. apo në Dh. R.? (Dh. V.) Kur të gjeni librin e 2-të të Mbretërve, shkoni te kapitulli 20, vargu 1. Kapitulli është numri i madh, ndërsa vargu, numri i vogël. *Nëse ke nxënës të rritur, mund të përdorni metodën "Stërvitja me shpata".*

Kronologjia: Siç mund ta shihni, ka shumë udhëheqës të guximshëm në Bibël. Sot do të përqendrohemi te një mbret; kur ta zbuloni se për cilin mbret po flasim, më thoni. Ndihmesë: Ai gjendet te figurat e kronologjisë.

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Javën e kaluar mësuam për një burrë të quajtur Naaman, i cili kishte një sëmundje lëkure. A ju kujtohet se si quhej sëmundja? (Lebër) Çfarë u bë me lebrën e Naamanit? (Perëndia e shëroi kur Naamani iu bind dhe u la shtatë herë në lumin Jordan) A kishte besuar Naamani në Perëndinë e vërtetë para se të shërohej? (Jo) A besoi Naamani në Perëndinë e vërtetë pasi u shërua? (Po) Secili prej nesh mund të zgjedhë që të besojë ose jo në Perëndinë e vërtetë. Kujtojua Ungjillin duke përdorur "Librin pa fjalë".

Sot do të mësojmë për një burrë tjetër. Ai i besonte Perëndisë, mirëpo u sëmur për vdekje. Do të mësojmë diçka fantastike për të. A jeni gati?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përvijimi i Shkrimit: 2 i Mbretërve 20:1-7

Kush është Ezekia?

A ju kujtohet mbreti Solomon? Ai ishte biri i Davidit – ai që ndërtoi tempullin për Perëndinë në Jerusalem. Fatkeqësisht, mbreti Salomon nuk i qëndroi besnik Perëndisë, siç kishte bërë i ati, mbreti David. Përkundrazi, ai adhuroi perëndi të rreme. Solomoni i bëri gjërat siç donte vetë e jo siç i pëlqente Perëndisë; kjo gjë ishte mëkat. Për shkak se mbreti Solomon nuk i qëndroi besnik Perëndisë, kombi i Izraelit u nda në dy pjesë – Juda dhe Izraeli. Kur ndodhi ndarja, Juda caktoi mbretin e vet dhe njësoj bëri edhe Izraeli.

Sot do të mësojmë për një nga mbretërit e Judës. Ai quhej Ezekia. *Kërkoju nxënësve ta përsërisin disa herë emrin "Ezekia".* Ezekia besonte te Perëndia i vërtetë dhe tregoi guxim, duke mos i lejuar njerëzit në Jude të adhuronin perënditë e rreme të kombeve të tjera. Megjithatë, mbreti Ezekia nuk iu bind gjithmonë Perëndisë. Ndonjëherë bëri zgjedhje të gabuara. Mirëpo, megjithëse Ezekia nuk ishte i përsosur, prej tij mësojmë diçka shumë të rëndësishme.

Ezekia sëmuret dhe Isaia i thotë se do të vdesë

Lexo 2 i Mbretërve 20:1

Përmbledhje: Oh, jo! Isaia i tha mbretit Ezekia se ai nuk do të përmirësohej, por do të vdiste! Isaia ishte një nga profetët e Perëndisë, dhe Perëndia e kishte dërguar që t'i thoshte Ezekias se do të vdiste. Po sikur kjo të të ndodhte ty? Çfarë bën ti kur përballesh me situata të vështira? Cili nga 12 vargjet kyç të vjen në mendje? Le të zbulojmë se çfarë bëri mbreti Ezekia.

Ezekia lutet

Lexo 2 i Mbretërve 20:2-3

Përmbledhje: Çfarë bëri mbreti Ezekia kur Isaia i tha se do të vdiste? (Ai u lut dhe i klithi Perëndisë) A ishte veprim i mençur që Ezekia të fliste me Perëndinë në lutje për problemin e tij? (Po) Nga e dimë se duhet t'i lutemi gjithmonë Perëndisë? Le të lexojmë e të mendojmë për vargun nga "Mendo si duhet" për këtë javë, 1 e Thesalonikasve 5:17. Lexoje vargun nga Bibla. Çfarë thotë: "Lutuni pa pushim." Kjo do të thotë të vazhdosh të lutesh. Çfarë mendoni se ndodhi kur Ezekia iu lut Perëndisë? A mendoni se Perëndia e dëgjoi lutjen e tij? A mendoni se Perëndia iu përgjigj lutjes së tij? Kur i kërkojmë diçka Perëndisë, cilat janë tre përgjigjet e mundshme që Ai jep? (Po, jo ose prit) Cila mendoni se ishte përgjigjja e Perëndisë? Le ta zbulojmë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Shënim për mësuesin kryesor: Thekso që Perëndia u përgjigjet kërkesave tona në tre mënyra: po, jo ose prit. Perëndia është i gjithëdijshëm. Ai njeh të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen. Ai e di se çfarë është më e mira për ne, edhe pse ne mund të mos e kuptojmë arsyen. Thekso gjithashtu se Perëndia nuk do t'i përgjigjet kurrë një kërkese me "ndoshta". Ai nuk është asnjëherë i paqartë apo i pasigurt për vendimet e tij.

Për nxënësit më të rritur: *Përpiqu të tejçosh idenë se Perëndia thotë "Jo" për një arsye. Mund të jetë e vështirë ta pranosh "Jo"-në, mirëpo të jesh i krishterë do të thotë të biesh dakord me Perëndinë, të besosh se Ai vepron dhe të bësh atë që është më e mira për jetën tënde, edhe pse mund të jetë e vështirë.*

<u>Perëndia i përgjigjet lutjes së Ezekias</u>

Lexo 2 i Mbretërve 20:4-7

Përmbledhje: A e dëgjoi Perëndia lutjen e Ezekias? (Po) A iu përgjigj Perëndia lutjes së Ezekias? (Po) Cila ishte përgjigjja e Perëndisë për lutjen e Ezekias? (Po; Ai e ktheu Isaian mbrapsht që t'i thoshte Ezekias se do të shërohej dhe do t'i shtoheshin edhe pesëmbëdhjetë vite jetës së tij) Çfarë nuk shkonte me mbretin Ezekia? (Ai kishte ulcerë) Ulcera është një plagë e infektuar dhe shumë e dhimbshme në lëkurë. Ajo mund të infektojë gjakun, gjë që shkakton vdekjen. Ulcera e mbretit Ezekia duhet të ketë qenë shumë e keqe. Çfarë udhëzimesh i dha Perëndia Ezekias që të shërohej? (Të merrte një jaki fiqsh – një lloj mjekimi – dhe ta vendoste te ulcera)

A e shëroi Perëndia mbretin Ezekia? (Po, jakia me fiq funksionoi!)

Përfundimi

Mbreti Ezekia është një shembull i mirë që na tregon se ç'ndodh kur ia parashtrojmë të gjitha gjërat Perëndisë në lutje. Ai ishte i bindur se kur të lutej, Perëndia mund ta dëgjonte dhe mund t'i përgjigjej. Perëndia donte që mbreti Ezekia t'i besonte vetëm Atij.

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

Po ti? A ia parashtron gjithçka Perëndisë në lutje? A i je lutur ndonjëherë Perëndisë si mbreti Ezekia?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Për nxënësit më të rritur: Më lejoni ta bëj ndryshe pyetjen. Përse nuk do t'ia parashtronit Perëndisë gjërat në lutje? Le të mendohemi për pak çaste dhe të flasim për disa gjëra në jetën tonë për të cilat duhet të lutemi. Mund të jetë edhe diçka e mirë për të cilën duhet të lavdërosh Perëndinë. Ose mund të jetë diçka e vështirë, si sëmundja e mbretit Ezekia, për të cilën duhet të flasësh me Perëndinë dhe të kërkosh ndihmën e Tij. Ai dëshiron që t'ia parashtrosh gjithçka Atij, qoftë e mirë apo e keqe, e madhe apo e vogël.

Kohë zbatimi në klasë:

- Jepu pak kohë nxënësve që të mendojnë, pastaj kaloni disa minuta duke folur për mënyrën se si ndihen, duke ditur se mund të luten e të flasin me Perëndinë kudo dhe në çdo kohë (përdor posterin "Ndihu si duhet").
- Shënoji kërkesat e lutjes në tabelë, pastaj lutuni bashkë me nxënësit në klasë. Nxiti të luten për njëri-tjetrin. Kujtojua vargun nga 1 e Thesalonikasve 5:17.
- Jepu nxënësve blloqe shënimesh për lutje. Nxiti të nisin një ditar me kërkesa lutjesh dhe që të mbajnë shënim mënyrën se si Perëndia u përgjigjet lutjeve të tyre.
- Jepu nxënësve kartonë të vegjël dhe kërkoju të shkruajnë kërkesa specifike lutjesh për të cilat duan të luten në mënyrë private.
- Ndahuni në grupe të vogla dhe lutuni për njëri-tjetrin.

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Kush ishte Ezekia? (Ai ishte njëri nga mbretërit e Judës)
2. Çfarë ndodhi me mbretin Ezekia? (Kishte një ulcerë dhe u sëmur për vdekje)
3. Kush i tha mbretit Ezekia se do të vdiste? (Profeti i Perëndisë, Isaia)
4. Çfarë bëri mbreti Ezekia kur mori vesh se do të vdiste? (Ai iu lut Perëndisë dhe qau)
5. Çfarë i tha Perëndia mbretit Ezekia të bënte që të shërohej? (Të vendoste një jaki fiqsh në plagë)
6. A iu bind mbreti Ezekia udhëzimeve të Perëndisë? (Po)
7. A u shërua mbreti Ezekia? (Po)
8. Çfarë mësuam nga mbreti Ezekia? (T'ia parashtrojmë çdo gjë Perëndisë në lutje)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 3
Jona 1 – 3

Kupto si duhet:	Jona zgjedh të bindet ose jo.
Mendo si duhet:	"Si mundet një i ri ta bëjë rrugën e tij të pastër? Duke e ruajtur me fjalën tënde." Psalmi 119:9
Vepro si duhet:	Unë do t'i bindem Perëndisë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i fortë kur i bindem Perëndisë.

PËRGATITU!

A sheh ndonjë ngjashmëri mes Jonës dhe qëndrimeve të botës sot (dhe tonat)? Mund të jetë e parehatshme, madje kundërkulturore, t'i nënshtrohesh autoritetit të Perëndisë, mirëpo Fjala e Perëndisë është e qartë. Nëse duam të ndjekim Krishtin, dhe të jemi çdo ditë më të ngjashëm me Të, Perëndia është Zoti dhe autoriteti ynë më i lartë. Bindja ndaj Tij është mënyrë shumë e rëndësishme për të treguar dashurinë dhe përnderimin tonë për Të, dhe kjo do të na çojë drejt më të mirës që Perëndia ka për jetën tonë. Ndërsa përgatitemi për këtë mësim, le të mendojmë se si mund t'i bindemi Perëndisë sot.

Shënim: Ju lutem lexoni aktivitetin e "Kohës së zbulimit" për mësimin 4. Kartonët me 12 sfidat kyç duhet t'u jepen nxënësve këtë javë. (Material burimor i printueshëm)

Lutu: Kërkoji Perëndisë t'ua shfaqë nxënësve të vërtetën e Tij. Lutu që ata të kuptojnë vlerën e bindjes dhe të dëshirojnë një jetë që nderon Perëndinë, pavarësisht çmimit. Lutu specifikisht edhe për nxënësit që nuk e kanë marrë vendimin për t'i besuar Perëndisë si Shpëtimtari i tyre. Lutu që këtë javë ta marrin këtë vendim!

Lexo: Jona 1 - 3

Kupto si duhet: Jona zgjedh të bindet ose jo
Për shkak të rebelimit dhe adhurimit të perëndive të rreme, Perëndia lejoi që izraelitët të ishin të cenueshëm nga armiqtë. Një prej armiqve ishte Asiria. Për shkak të veprave të liga të Asirisë, Perëndia planifikoi t'i shkatërronte. Për shkak të hirit dhe të mëshirës së Tij, Perëndia dërgoi profetin e Tij, Jonën, që t'i paralajmëronte asirianët. Kur Jona i mllefosur nuk u bind, Perëndia i dha një mësim përmes fuqisë së Tij mbi detet dhe krijesat në to. Në fund Jona u bind, asirianët u penduan dhe u kursyen nga shkatërrimi. Nga mosbindja e Jonës dhe pasojat që e ndoqën, kuptojmë se duhet t'i bindemi gjithmonë Perëndisë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënime për mësuesin kryesor:

- Ndërsa prezanton këtë mësim, do kuptosh që një pjesë e mirë e di historinë e Jonës, megjithatë, sot do të thellohemi më shumë për të zbuluar "përse" Perëndia e vendosi këtë mësim në Bibël dhe "çfarë" dëshiron t'i mësojë secilit prej nxënësve personalisht përmes jetës së Jonës. Sfidoji nxënësit të zbulojnë tre gjëra të reja që nuk i kanë ditur më parë për Jonën (secila vlen një etiketë shpërblyese).
- Një tjetër burim thellues për ngjarjen e Jonës gjendet "online" në faqen e internetit të "Answers in Genesis": http://www.answersingenesis.org/articles/am/v1/n1/great-fish
- Për shkak të kufizimit të kohës me nxënësit dhe vlerës që i japim përdorimit të Biblës personale, ju lutem mos e lexoni këtë mësim (apo edhe mësimet e tjera) nga një libër me tregime biblike.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Kërkoju nxënësve të mbajnë para vetes çantat e KZ-së. Përdorni objekte për shpjegimin e mësimit nga Bibla. Mbuloji objektet me letër blu (ose copë, peshqirë apo mbulesa blu) dhe zbuloji me radhë ndërsa shpjegon mësimin. Në fund të mësimit, sfidoji nxënësit t'u tregojnë prindërve se çfarë kanë mësuar duke përdorur objektet që kanë te çantat e tyre.
2. Fto disa nga prindërit që të lexojnë rreshtat e personazheve të ndryshëm në mësim.
3. Krijo një kronologji për mësimin. Mbi vijën kronologjike shëno ngjarjet kyç, ndërsa poshtë vijës shëno fjalët "I bindur" ose "I pabindur", sipas ngjarjeve.
4. Nise mësimin me një "peshk" të madh dhe diskutoni se si dhe përse Jona kishte ngecur brenda tij. Mund ta krijosh peshkun me tendë (çadër kampingu), ose kërko në internet për ide të tjera.
5. Kërko harta në internet për një pamje satelitore të Ninivesë (që gjendet në Irakun e sotëm) dhe tregojua nxënësve gjatë mësimit.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

NISU!

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Shënim: Njëri nga drejtuesit duhet t'ua japë nxënësve udhëzimet e qarta para se të fillojë KZ-ja. Shih udhëzimet më poshtë.

Koha e zbulimit:
Të bindesh apo të mos bindesh... është zgjedhja jote!

Qëllimi: T'i sfidojmë nxënësit t'u **binden** rregullave.

<u>**Aktiviteti 1:** Hapësirë e madhe</u>



Mjetet:

- Një listë me objekte për "Gjuetinë e thesarit" (nga një për çdo nxënës) (burim i printueshëm)
- Qese plastike që mbyllen (nga një për çdo nxënës)
- Kosha të vegjël (të shpërndarë nëpër hapësirën e caktuar, te njëri kosh vendos një listë të gjuetisë së thesarit, te një tjetër vendos një qese plastike bosh dhe te një tjetër një shembull të qeses së mbushur me të gjitha objektet që duhen gjetur; te njëri nga koshat duhet të vendosësh mjaftueshëm kopje të listës së objekteve që duhen gjetur dhe gjithashtu mjaftueshëm qese për të gjithë)
- Çanta, tasa apo kova në një ngjyrë të caktuar (këto duhet të jenë "karremat" me karamele, për shpërqendrim)
- Çanta, tasa apo kova në një ngjyrë tjetër për nxënësit
- Objektet e "Gjuetisë së thesarit":
    - Karamele në formë peshku (apo një objekt tjetër që mund të përfaqësojë peshkun e madh)
    - Ujë (shumë pak për çdo nxënës; një lugë ujë përfaqëson Detin Mesdhe; nuk duhet të ketë aq sa nxënësit të lagen, por gjërat brenda qeses duhet të lagen)
    - Një gotë e vogël (për të marrë ujin)
    - Makarona në formë guaske (nga një për çdo nxënës; për të përfaqësuar anijen)
    - Pipëza (priji në copa të vogla; nga një për çdo nxënës; pipëzat do të përfaqësojnë hedhjen e shortit)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

- Një copë e vogël kartoni ku shkruhet “Ninive” (nga një për çdo nxënës) (burim i printueshëm)
- Shenjat e çdo stacioni tregojnë se sa duhet të vendosin nga secili objekt në qese (burim i printueshëm)
- Bojë me spërkatëse
- Flamuj të gjatë ose konë
- Kronometër
- Bilbil
- Diçka për të ngrënë për nxënësit fitues



Udhëzime për ambientin:

- Krijo kufij duke spërkatur bojën dhe shto flamuj apo konë për të shënuar qartësisht zonën e “Gjuetisë së thesarit”. Sigurohu që nxënësit të kenë mjaft hapësirë dhe t’i kenë kufijtë e qartë.
- Vendos setet e objekteve bashkë me shenjën që tregon se sa prej tyre duhet të marrë çdo nxënësve brenda një çante, tasi apo kove.
- Fshihi tasat brenda kufijve.
- Vendos disa tasa ngatërrues “karrem” me karamele në vende të dukshme brenda kufijve. Nxënësit nuk duhet të marrin prej tyre sepse, edhe pse gjenden brenda kufijve, nuk janë në ngjyrën e caktuar.
- Vendos disa tasa karrem, në ngjyrën e caktuar, por jashtë kufijve (mund të vendosni karamele brenda bër t’i bërë tërheqëse). Nxënësit nuk duhet të marrin prej tyre sepse, edhe pse janë në ngjyrën e caktuar, ato gjenden jashtë kufijve.
- Në zonën e caktuar për “Gjuetinë e thesarit”, vendos një kosh të vogël me listën e objekteve, me një qese plastike boshe dhe një qese shembull me të gjithë objektet që duhen gjetur. Gjithashtu, vendos një kosh me mjaftueshëm kopje të listës së objekteve dhe mjaftueshëm qese plastike për të gjithë nxënësit.
- Këshillë për ta bërë më të vështirë për nxënësit e rritur: Përdor qese të zeza ose në ngjyra që përziehen më mirë me ambientin si: jeshile e errët, kafe ose e zezë.

Udhëzime për drejtuesin pas përfundimit të adhurimit:

1. Kur të përfundojë adhurimi, informoji nxënësit se do të zhvillojnë gjuetinë e thesarit jashtë.
2. Tregoju një shembull të listës së objekteve dhe thuaju se duhet t’i gjejnë ato objekte.
3. Tregoju qesen plastike dhe thuaju se objektet duhet t’i vendosin brenda qeses.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

4. Ndërsa shpjegon udhëzimet, mos ua shpërndaj akoma listat dhe qeset personale, sepse mund të shpërqendrohen.
5. Tregoju rregullat e mëposhtme, të cilave duhet t'u **binden** për gjuetinë e thesarit:
   - Të gjithë nxënësit duhet të **binden** dhe të qëndrojnë brenda kufijve të përcaktuar.
   - Nxënësit duhet të kërkojnë objektet te çantat, tasat apo kovat në ngjyrën _____ (tregoju ngjyrën që ke caktuar). Kërkoju të përsërisin pas teje ngjyrën. Ju lutem **binduni** dhe merrni vetëm nga këto tasa.
   - Pesë nxënësit e parë që i kanë mbledhur të gjithë objektet në çantën e tyre dhe shkojnë te vendi i caktuar, fitojnë.
6. Informoji për kufirin kohor dhe thuaju të fillojnë mbledhjen e objekteve në çantat e tyre. Tregoju se qesja do të laget, por nuk ka problem.
7. Para se të dilni jashtë për të nisur gjuetinë e thesarit, thuaju të shkojnë te drejtuesi i KZ-së kur ti të thuash: "Nisu!" për të marrë listën e objekteve dhe një qese plastike.

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Jepi secilit prej nxënësve një listë me objektet për gjuetinë e thesarit dhe një qese. Nëse janë shumë të vegjël në moshë, mund t'i shoqërojë një drejtues te secili stacion që t'i ndihmojë të marrin sasinë e duhur nga çdo objekt.
2. Dilni jashtë në zonën e caktuar dhe filloni gjuetinë e thesarit.
3. Sigurohu të jetë një aktivitet me ritëm të shpejtë dhe argëtues.
4. Vëzhgo nëse nxënësit tregohen **të bindur**. Nëse jo, duhet të ulen për disa minuta pa të drejtën për të mbledhur objektet, derisa t'i lejosh të ribashkohen sërish në gjueti.
5. Pesë nxënësit e parë që i mbledhin të gjitha objektet dhe shkojnë te vendi i caktuar, fitojnë. Kontrollo çantat/qeset që të sigurohesh se i kanë marrë të gjitha objektet.
6. Kur të përfundojë koha, bjeri bilbilit dhe të gjithë nxënësit duhet të kthehen te drejtuesi i KZ-së. Sigurohu që të gjitha qeset të jenë të mbyllura mirë dhe pastaj shkoni në klasë. Objektet brenda qeses do të përdoren për shpjegimin e mësimit.

Shënim: Drejtuesi i KZ-së dhe mësuesi duhet të mendojnë për këto pyetje:

- A do t'u binden nxënësit rregullave apo do të marrin nga tasat në ngjyrën e gabuar?
- A do t'u binden nxënësit rregullave apo do të shkojnë përtej kufijve?
- A do t'u binden nxënësit rregullave apo do të marrin objektet e gabuara?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesi kryesor – Lidhja e KZ-së me mësimin: Çfarë do të thotë të bindesh? Kur bëtë gjuetinë e thesarit, a kishit të lehtë apo të vështirë t'u bindeshit rregullave? A ishin opsionale rregullat? Përse po ose jo? Pavarësisht moshës, bindja është e vështirë. Edhe të rriturit duhet të zgjedhin çdo ditë t'i binden Perëndisë. Kjo nuk është gjithmonë e thjeshtë dhe ka raste kur dëshiron të veprosh sipas dëshirës sate. Mirëpo Perëndia, në Fjalën e Tij, na tregon se sa e rëndësishme është t'i bindemi.

Mendoni për të gjitha objektet që keni mbledhur në "Gjuetinë e thesarit". A e gjeni dot se për kë do të mësojmë sot? Këtij personi iu desh të përballej me një situatë të vështirë dhe pastaj të zgjidhte të bindej... ose të mos bindej.

Lutu: *Pyeti nxënësit nëse e kujtojnë se si u lut mbreti Ezekia. (Me siguri) Kërkoji njërit prej tyre të ngrihet në këmbë dhe me guxim ta nisë mësimin me lutje, duke i kërkuar Perëndisë t'i mësojë secilit diçka të re dhe që të mund ta zbatojmë në jetën tonë.*

Zbuloje: *Pyeti nxënësit nëse Jona gjendet në Dhiatën e Re apo te e Vjetra. (Dh. V.) Kërkoju dy nxënësve që i dinë mirë librat e Biblës, të garojnë për t'i recituar me radhë librat e Dhiatës së Vjetër deri te libri i Jonës. Pastaj shkruaj referencën e vargut në tabelë dhe kërkoju nxënësve t'i hapin Biblat aty. Merr kohë për t'u mësuar se referenca është "adresa" e vargut në Bibël. Numri i madh është kapitulli ndërsa numri i vogël vargu. Ndërkohë që nxënësit gjejnë vargun, radhiti librat e Dhiatës së Vjetër deri te ai libër specifik. Kjo do t'i ndihmojë nxënësit të mësojnë se si të shqiptojnë çdo libër.*

Kronologjia: *Shënim: Qëllimi i kronologjisë është t'i sfidojë nxënësit ta shohin Biblën si një pamje të plotë e jo si mësime individuale që nuk lidhen me njëra-tjetrën. (Gjatë prezantimit i referohemi kronologjisë.)*

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Deri në këtë pikë të tremujorit kemi mësuar se si Perëndia shëroi lebrën e Naamanit dhe se si iu përgjigj lutjes së Ezekias. Sot do të mësojmë se si Perëndia veproi përmes një burri të quajtur Jona. Jona ishte një nga profetët e Perëndisë në Izrael gjatë kohës së mbretërve. *Drejtohu te kronologjia e Biblës.* A ju kujtohet se çfarë është një profet? (Profeti është dikush që u jep njerëzve mesazhin e Perëndisë për çfarë do të ndodhë në të ardhmen) Jona ishte profet, mirëpo nuk ishte si profetët e tjerë për të cilët kemi mësuar. Kishte diçka ndryshe tek ai... diçka që do ta zbulojmë tani!

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përvijimi i Shkrimit: Jonas 1 – 3

Perëndia e urdhëron Jonën të shkojë në Ninive

Lexo Jona 1:1-2

Përmbledhje: Ninive ishte kryeqyteti i Asirisë. (*Për nxënësit më të rritur: Mosul, Iraku i sotëm*) Populli i Ninivesë ishte armik me Izraelin dhe bënte shumë të këqija. Perëndia donte që Jona t'i tregonte popullit të Ninivesë për Perëndinë e vërtetë dhe që t'i lajmëronte se, po të mos pendoheshin, Perëndia do t'i shkatërronte. Po të ishe ti në vendin e Jonës, çfarë do të bëje? Çfarë bëri Jona? Le ta zbulojmë.

Jona nuk i bindet Perëndisë dhe ia mbath

Lexo Jona 1:3

Përmbledhje: Çfarë po mendonte Jona? A mendonte vërtet se mund t'ia mbathte nga Perëndia? A mundet në të vërtetë dikush t'ia mbathë nga Perëndia? (Jo) Pse? (Sepse Perëndia është kudo!)

Jona mëkatoi dhe nuk iu bind Perëndisë. A ju kujtohet ndonjë rast kur nuk i jeni bindur Perëndisë? Ndoshta keni thënë një gënjeshtër, jeni tallur me dikë, keni parë diçka që nuk duhej ta shihnit në kompjuter apo telefon, nuk u jeni bindur prindërve ose keni bërë me hile gjatë KZ-së sot. A e dini se Perëndia sheh gjithçka që bëni? Ai është gjithmonë i pranishëm dhe e di kur ti mëkaton. Nuk ia mbath dot nga Perëndia e as nuk fshihesh dot prej Tij.

Çfarë mendoni se ndodhi kur Jona u përpoq t'ia mbathte nga Perëndia? Le ta shohim.

Perëndia dërgon një stuhi

Lexo Jona 1:4-5b

Përmbledhje: Për shkak se Jona nuk iu bind Perëndisë, Perëndia dërgoi një stuhi të tmerrshme! Detarët patën frikë, ndaj u thirrën perëndive të tyre të rreme, të cilët nuk i ndihmonin dot.

Ungjilli

Mëkati ka gjithmonë pasoja. Te Romakëve 6:23, mësojmë se çmimi i mëkatit është vdekja... vdekja e përjetshme. Për shkak të dashurisë së madhe të Perëndisë, Ai na ka dhënë dhuratën e Jezusit, që të marrim faljen e mëkateve. *Shpall Ungjillin duke përdorur "Librin pa Fjalë".*

Mosbindja e Jonës e shkaktoi stuhinë e rrezikshme. Ndërsa detarët po u klithnin perëndive të rreme dhe po hidhnin ngarkesa në det, çfarë po bënte Jona? Le të vazhdojmë leximin për ta zbuluar.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Jona po fle

Lexo Jona 1:5c-6

Përmbledhje: Kapiteni nuk e besonte dot që Jona po flinte! Kapiteni nuk e dinte se Perëndia i Jonës ishte Perëndia i vërtetë, por ai e urdhëroi Jonën të lutej që ata të mos vdisnin.

Detarët zbulojnë se ishte faji i Jonës

Lexo Jona 1:7-9

Përmbledhje: Tani detarët zbuluan se kjo stuhi e tmerrshme ishte tërësisht për faj të Jonës. Ai kishte treguar mosbindje ndaj Perëndisë me vetëdije. Ata gjithashtu mësuan se Perëndia i Jonës, Perëndia i vërtetë, kishte bërë detin dhe tokën. Si u ndienë detarët? (Ata patën frikë!)

Për nxënësit më të rritur: A e kupton vërtetë se sa i fuqishëm është Perëndia ynë? Perëndia është i përsosur dhe i fuqishëm. Ai kontrollon detin, qiellin dhe erën. Perëndia vendos të drejtën dhe të gabuarën dhe Ai do të bëjë më të mirën për ne. Edhe në kohën e pasojave të mëkateve tona, Ai na do.

Jona duhet të shkojë

Parafrazim i Jonës 1:1-16:

Detarët e dinin se gjendeshin në rrezik të madh dhe ishin të tmerruar. Ata nuk e besonin dot se Jona ishte përpjekur t'ia mbathte nga Perëndia i vërtetë. Më në fund ata kuptuan se, për të ndalur stuhinë, duhet ta hidhnin Jonën nga varka, edhe pse e dinin se me shumë mundësi ai do vdiste.

Pasi e hodhën Jonën në det Perëndia e ndali stuhinë dhe detarët jo vetëm që besuan te Perëndia, por edhe e adhuruan. Perëndia është kaq i fuqishëm, saqë edhe kur ne nuk i bindemi, Ai mund ta kthejë për mirë. Si e ktheu për mirë Perëndia mosbindjen e Jonës? (Tani edhe detarët besonin te Perëndia!) Çfarë i ndodhi Jonës?

Për nxënësit më të rritur: Vini re se si Perëndia e ktheu diçka që në këndvështrimin e njeriu ishte e "keqe" në diçka të "mirë". *Sfidoji nxënësit ta shohin jetën me lentet e Perëndisë, në pamjen e madhe.*

Një peshk i madh gëlltit Jonën

Lexo Jona 1:17

Përmbledhje: Çfarë e gëlltiti Jonën? (Një peshk i madh) Sa ditë dhe sa netë qëndroi Jona në barkun e peshkut? (Tre) Si mendoni se ishte brenda barkut të peshkut? Lagështi? Errësirë? Erë e keqe? Parehati? Ma merr mendja që ka qenë e tmerrshme! Çfarë mendoni se bëri Jona ndërkohë që ishte në barkun e peshkut të madh?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Jona lutet

Për nxënësit më të rritur: *Kërkoji dikujt të lexojë me intonacion lutjen e Jonës.*

Lexo Jona 2:1-9

Nxënësit më të vegjël:

Parafrazimi i Jonës 2:1-9:

Ndërkohë që Jona ishte në barkun e peshkut të madh, iu lut Perëndisë. Ai i tha Perëndisë se e dinte që Ai do ta shpëtonte. Edhe pse Jona kishte treguar shumë mosbindje, ai gjithsesi i besonte Perëndisë. Çfarë ndodhi pastaj?

Perëndia e urdhëron peshkun ta vjellë Jonën në tokë të thatë

Lexo Jona 2:10

Përmbledhje: Perëndia është kaq i fuqishëm, saqë po t'i thotë peshkut të vjellë, ai vjell! Ai tregoi mëshirë të madhe ndaj Jonës duke i dhënë një mundësi të dytë. A mendoni se Jona do t'i bindet tani Perëndisë?

Perëndia ia përsërit urdhërimin Jonës

Lexo Jona 3:1-3

Përmbledhje: A iu bind kësaj here Jona Perëndisë duke shkuar në Ninive? (Po)

Niniveasit besojnë dhe pendohen

Parafrazim i Jonës 3:4-9:

Jona u tha niniveasve se Perëndia do t'i shkatërronte brenda dyzet ditëve. Çfarë mendoni se bënë niniveasit? (Ata besuan te Perëndia dhe u penduan për mëkatin e tyre) Çfarë do të thotë "pendim"? Do të thotë se niniveasit ndaluan së vepruari sipas rrugëve të tyre të liga, besuan në Perëndinë dhe filluan të vepronin sipas pëlqimit të Tij. A mendoni se Perëndia u dha një mundësi të dytë niniveasve?

Perëndia nuk i shkatërroi niniveasit

Lexo Jona 3:10

Përmbledhje: Perëndia nuk i shkatërroi niniveasit, sepse ata i besuan Perëndisë, u penduan për ligësinë e tyre dhe filluan t'i bindeshin Atij.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përfundimi

Bibla na tregon se të gjithë ne kemi treguar mosbindje ndaj Perëndisë. Ndëshkimi për mëkatin është ndarja nga një marrëdhënie e mrekullueshme me Perëndinë, tani dhe në përjetësi. Megjithatë, Perëndia ynë është i dashur dhe nuk do që ne ta përjetojmë ndëshkimin e mëkatit. Prandaj Ai dërgoi Birin e Tij të vetëm dhe të përsosur që të merrte ndëshkimin për mëkatin tonë, në mënyrë që ne të kishim mundësinë për të qenë përgjithmonë me Të. Përse ishte e nevojshme kjo; përse nuk mund të ketë mëkat në qiell?

Nuk ka mëkat në qiell (*trego faqen e artë të "Librit pa fjalë"*). Perëndia e urren mëkatin, megjithëse e do mëkatarin. Për këtë arsye Ai dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të na shpëtonte nga mëkati. Si mund të na shpëtojë Jezusi nga mëkati? Së pari, duhet të kuptojmë e të pranojmë se kemi mëkatuar (*faqja e zezë; Romakëve 3:23*). Pastaj duhet të besojmë në Jezusin si i vetmi Shpëtimtar (*faqja e kuqe; Hebrenjve 9:22b*). Pas kësaj duhet të bëjmë zgjedhjen personale për t'i besuar Atij që të na shpëtojë nga ndëshkimi i mëkatit (*faqja e bardhë; Veprat 16:31*). Kjo është një zgjedhje personale që vetëm ti mund ta bësh. *Nëse disa nga fëmijët kanë pyetje, disa drejtues mund t'i marrin veçmas e të flasin me ta.*

Nëse tashmë i kemi besuar Jezusit si Shpëtimtari ynë, duhet të vazhdojmë t'i bindemi Atij. Jo sepse duhet, por sepse duam. Si ta dimë se për çfarë të bindemi? Duhet të lexojmë e të studiojmë Biblën. Le të lutemi që Perëndia të na ndihmojë të jemi si Jona pasi mësoi se si të bindej.

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

Çfarë do të bësh me mësimin që more këtë javë? Si mund të zgjedhësh t'i bindesh Perëndisë, edhe pse mund të jetë e vështirë? Ndoshta duhet t'i bindesh dhe të respektosh prindërit, ashtu siç i pëlqen Perëndisë. Ose ndoshta duhet të pranosh që po shikon gjëra jo të mira në internet dhe t'i kërkosh ndihmë Perëndisë dhe prindërve që të fillosh të veprosh siç duhet. Le të kalojmë disa çaste duke menduar se si mund ta zbatoni këtë mësim në jetën tuaj këtë javë. Ky mësim nuk flet vetëm për Jonën, flet edhe për ju. A do të jeni të bindur këtë javë? Jepu pak minuta nxënësve që të mendojnë se si mund ta zbatojnë mësimin.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Për çfarë e urdhëroi Perëndia Jonën? (Të shkonte në Ninive dhe t'i paralajmëronte njerëzit se Perëndia do t'i shkatërronte për dyzet ditë për shkak të ligësisë së tyre)
2. Çfarë ndodhi kur Jona nuk iu bind Perëndisë? (Perëndia dërgoi një stuhi të tmerrshme dhe detarëve iu desh ta hidhnin Jonën në det, ku një peshk i madh e gëlltiti)
3. Çfarë ndodhi me stuhinë kur detarët e hodhën Jonën në det? (Perëndia e ndali stuhinë dhe deti u qetësua)
4. Çfarë bënë detarët sapo u qetësua deti? (Ata patën frikë Perëndinë dhe e adhuruan)
5. Çfarë bëri Jona kur ishte brenda peshkut? (Ai iu lut Perëndisë)
6. Çfarë ndodhi kur Jona iu bind Perëndisë dhe u tha niniveasve se Perëndia do t'i shkatërronte? (Niniveasit i besuan Perëndisë dhe u penduan)
7. A i shkatërroi Perëndia niniveasit? (Jo) Përse jo? (Sepse ata i besuan Atij dhe u penduan)
8. A i je bindur ti Perëndisë duke u penduar e duke besuar në Jezusin për të të shpëtuar nga mëkati?

Shënim i rëndësishëm – Ju lutem lexojeni

Informacion thelbësor:



- Lexoni KZ-në e javës së ardhshme.
- Kartonë me 12 sfidat kyç duhen shpërndarë sot! (burim i printueshëm)
- Nxënësit që mund t'u recitojnë prindërve të dymbëdhjetë vargjet gjatë javës, duhet t'i sjellin kartonët e firmosur nga prindërit, që të marrin pjesë në një aktivitet argëtues në javën e ardhshme. (Kujtoju nxënësve se ka shumë gjasa që të paktën gjashtë prej tyre t'i dinë, ndaj nuk do të jetë shumë e vështirë.)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 4
2 i Kronikave 34

Kupto si duhet:	Mbreti Josia gjen Fjalën e Perëndisë.
Mendo si duhet:	"Por rrituni në hirin dhe në njohjen e Zotit dhe të Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht." 2 e Pjetrit 3:18a (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do ta kërkoj të vërtetën në Fjalën e Perëndisë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i urtë kur e kërkoj të vërtetën në Fjalën e Perëndisë.

PËRGATITU!

A e imagjinoni dot se si do të ishte po të humbisje Biblën apo po të ta merrte dikush? Do të ishte tragjike! Pikërisht kjo i ndodhi popullit të Izraelit. Ata e lanë pas dore Fjalën e Perëndisë dhe ajo humbi për breza të tërë. Ndërsa mësojmë këtë javë për mënyrën se si mbreti Josia gjeti Fjalën e Perëndisë, le ta falënderojmë Perëndinë që na e ka dhënë Fjalën e Tij.

Lutu: Ndërsa përgatitesh për të shërbyer këtë javë, kërkoji Perëndisë të të udhëheqë ndërsa përgatitesh dhe kërkoji të të udhëheqë ndërsa shpjegon. Lutu specifikisht për nxënësit që ndihen të paqartë, që kanë pikëpyetje për ekzistencën e Perëndisë dhe/ose kanë dyshime nëse Bibla është e vërtetë. Lutu që nxënësit të kërkojnë të vërtetën dhe që Perëndia t'u flasë në mënyrë të fuqishme.

Lexo: 2 i Kronikave 34

Kupto si duhet: Mbreti Josia gjen Fjalën e Perëndisë
Mbretërit e pabindur dhe jobesnikë të Izraelit e lanë pas dore tempullin e Perëndisë, adhurimin e Tij dhe Fjalën e Tij. Mbretëria veriore e Izraelit ishte dëbuar tashmë në Asiri dhe radha po vinte për ndëshkimin e Judës. Edhe pse Josia u bë mbret i Judës kur ishte vetëm tetë vjeç, ai bëri atë që ishte e drejtë në sytë e Perëndisë. Çdo e mirë që ai bëri çoi drejt një të mire tjetër. Kur Josia urdhëroi riparimin e tempullit, u gjet edhe Libri i Ligjit. Kur Josia dëgjoi të vërtetën e Perëndisë në atë libër, e besoi dhe e ndoqi. Ai ia lexoi popullit dhe ata u kthyen në bindje. Për shkak se Josia kërkoi/dëshiroi të vërtetën, Perëndia e kurseu Judën nga ndëshkimi që i takonte deri pas vdekjes së Josias. Edhe ne, si popull i Perëndisë, ecshim në gjurmët e Josias, duke kërkuar të vërtetën në Fjalën e Perëndisë!

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënime për mësuesin kryesor:

- Shënim historik: Kur Josia ishte mbret, mbretëria veriore e Izraelit (Samaria) ishte robëruar nga Asiria dhe kish mbetur vetëm një pjesë e vogël në atë zonë.
- Shumë njerëz pyesin: "Nga e dimë se Bibla është e vërtetë?" Ka shumë prova që konfirmojnë se është e vërtetë: profecitë në Bibël, numri i dorëshkrimeve që mund t'u referohemi për t'u siguruar se është e vërtetë, vendet ku janë bërë gërmimet dhe janë gjetur artefaktet. Këto gjëra na sigurojnë fakte se ngjarjet, njerëzit dhe vendet e përmendura në Bibël ekzistojnë vërtetë – siç ishte qyteti i Jerikos. Kjo do të thotë se, po t'i hipësh avionit dhe të shkosh në Izrael, do të gjesh prova se Fjala e Perëndisë është e vërtetë!

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Ndërsa shpjegon mësimin nga Bibla, fshih pergamenë me figura nëpër klasë, ngjarjet/idetë kryesore, ose vargjet (burim i printueshëm). Ndërkohë që flet shko te një nga pergamenat (kujto radhën dhe vendin ku i ke fshehur), dhe hapi për të zbuluar se çfarë ka brenda tyre. Në fund të mësimit, do të kesh disa pergamena të hapura, të cilat mund t'i përdorësh për përsëritje. Mund të gjesh letra pak të kafta për t'i bërë pergamenat më interesante dhe autentike.
2. Fto një person që të luajë rolin e mbretit Josia. Kur mbreti të dëgjojë se janë gjetur pergamenat, kërkoji të vrapojë drejt klasës duke shprehur entuziazmin për gjetjen e tyre. Nëse të duhet ndihmë për të gjetur një aktor, kërkoji drejtuesit të shërbesës të të ndihmojë.

NISU!

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Qëllo në shenjë!

Qëllimi: Të rishikojmë 12 vargjet kyç dhe t'u kujtojmë nxënësve vlerën e njohjes së Fjalës së Perëndisë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Aktiviteti 1: Hapësirë e madhe

Mjetet:

- Një legen/kovë e madhe me ujë, me një shënjestër ku shkruhet "**Një e vërtetë**" (kur goditet shënjestra, një person zhytet në ujë)
- Pesë shënjestra të tjera të rreme (vendosi pranë shënjestrës së vërtetë) (burim i printueshëm)
- Topa për t'i hedhur drejt shënjestrës
- Kova për të mbledhur kartonët me 12 sfidat kryesore
- Muzikë argëtuese adhurimi
- Alternativë: karrige, stola apo një vend ku nxënësit të ulen e të shohin

Planifikim paraprak:

- Gjatë javës gjej disa udhëheqës kyç që janë të gatshëm të zhyten në ujë (sigurohu që të marrin ndërresa me vete). Zgjidh persona argëtues dhe energjikë që edhe fëmijët i njohin.
- Cakto dikë që të mbledhë kartonët me 12 sfidat kyç ndërkohë që vijnë nxënësit.
- Do të gjeni më poshtë edhe një shembull të tekstit që mund të thotë personi që drejton lojën. Teksti nuk duhet lexuar gjatë KZ-së, por duhet studiuar gjatë javës.

Udhëzime për aktivitetin e KZ-së:

Shënim: *Dikush do të drejtojë aktivitetin, por të gjithë drejtuesit e tjerë duhet të jenë gati për të ndihmuar sipas nevojës. Ata mund t'i nxisin dhe t'i motivojnë nxënësit, të mbushin legenin/kovën e ujit, të rregullojnë shënjestrat, të mbledhin topat dhe të ndihmojnë nxënësit të përfshihen dhe të përqendrohen përgjatë aktivitetit.*

1. Vendos muzikë argëtuese adhurimi, që aktivitetit të jetë energjik.
2. Kur të vijnë nxënësit, thuaju t'i vendosin kartonët e sfidës në kovën e caktuar. Sigurohu ta kenë shkruar qartë emrin.
3. Uli të gjithë nxënësit përreth legenit/kovës me ujë.
4. Nxit entuziazëm ndërsa merr kartonët nga kova dhe thërret emrin e nxënësit.
5. Nxënësit që zgjidhen do të kenë tre mundësi për të goditur shënjestrën "**E vërtetë**". Nëse e godasin shënjestrën, u mbaron radha dhe nxënësi tjetër ka tre mundësi për ta hedhur topin. *Këshilla: Përshtate distancën në bazë të moshës së nxënësve. Mund të ngresh volumin e muzikës ndërkohë që nxënësit hedhin topin.*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

6. Mund të ndërrosh drejtuesin që qëndron te legeni/kova e ujit.
7. Nëse ke kohë të mbetur pasi të kesh nxjerrë të gjithë kartonët nga kova, përdor pyetje të thjeshta/të shpejta për t'u dhënë nxënësve mundësinë të godasin shënjestrën "**e vërtetë**".

Shembull për tekstin e drejtuesit të aktivitetit:
Mirë se vini në ditën e "Godit në shënjestër"! A jeni gati të zhysni në ujë disa drejtues? Sot drejtuesit janë _____. Thuaj emrat e atyre që do të zhyten te legeni/kova. Më lejoni të theksoj se përreth legenit/kovës ka disa shënjestra. *Thekso shënjestrat e rreme dhe përqendrohu te shënjestra "**e vërtetë**".*

Cilën shënjestër dëshironi të godisni? (Shënjestrën **e vërtetë**!!!!) *Nxit brohoritje dhe entuziazëm për shënjestrën e vërtetë.*

Sa prej jush do të donin të kishin mundësinë për hedhur në ujë njërin nga drejtuesit? E po, javën e kaluar morët kartonët e 12 sfidave kyç. U sfiduat të rikujtonit këto vargje biblike dhe pastaj t'u recitonit prindërve të paktën gjashtë prej tyre. Sa prej jush u KUJTUAT për ta bërë këtë? *Kërkoju nxënësve të ngrenë dorën dhe pastaj përgëzoji që e bënë prioritet dhe e vlerësuan Fjalën e Perëndisë.*

Do të fillojmë dhe nëse unë tërheq emrin tuaj nga kova me kartonët, do të keni tri mundësi për të goditur shënjestrën "**E vërtetë"**. Mos u mashtroni nga shënjestrat e tjera sepse ka vetëm një shënjestër **të Vërtetë**.

Le të mirëpresim drejtuesin e parë, _____ (thuaj emrin*)! Përfshiji të gjithë duke i nxitur të brohorasin, të përplasin duart dhe të thonë: "Një shënjestër **e vërtetë**!"*

*Nëse një nxënës godet shënjestrën **e Vërtetë**, përgëzoje dhe brohorisni të gjithë për të!*

*Kur një nxënës nuk e godet shënjestrën **e Vërtetë**, thuaj: "Mos harroni, ka vetëm një shënjestër **të Vërtetë**! Mos u mashtroni nga shënjestrat ngatërruese."*

*Kur të përfundojë koha për një drejtues, nëse nuk është zhytur në ujë, thuaj: "Mos harroni, ka vetëm një shënjestër **të Vërtetë**!" Në atë moment, godite shënjestrën **e Vërtetë**, duke e zhytur drejtuesin, e pastaj kërkoji drejtuesit të radhës të vijë.*

Kur të përfundojë koha, mblidhi nxënësit dhe futuni në klasë për të nisur mësimin.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Aktiviteti 2: Gjuetia e Shkrimit!

Mjetet:

- Njëmbëdhjetë pergamena të vogla për çdo skuadër – çdo fjalë nga 2 e Pjetrit 3:18a në secilën pergamenë; printoji setet në ngjyra të ndryshme; fshihi pergamenat nëpër vendet e caktuara (burim i printueshëm)
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në skuadra me nga pesë deri në gjashtë nxënës dhe caktoji secilës skuadre një ngjyrë.
2. Informoji skuadrat se do të garojnë në një "Gjueti Shkrimi." Ata duhet të gjejnë njëmbëdhjetë pergamenat në ngjyrën e skuadrës së tyre, t'i hapin dhe t'i vendosin sipas radhës për të formuar vargun.
3. Shpërble me dy etiketa anëtarët e skuadrës që e përfundon e para sfidën.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – **Lidhja e KZ-së me mësimin**:
Aktiviteti 1: Kur u sfiduat për të mësuar e për të recituar 12 vargjet kyç para prindërve gjatë javës, a u entuziazmuat? Apo e patë si barrë që do t'ju pengonte t'i bëni gjërat siç doni vetë? A e çmuat Fjalën e Perëndisë apo e harruat? Te aktiviteti sot mësuam se vetëm shënjestra **e vërtetë** do të funksiononte. Njëra ishte e vërteta; të tjerat ishin të rreme. A e dini se Fjala e Perëndisë është e vërtetë? Kjo më kujton një situatë në Bibël dhe një person që ishte i urtë dhe kërkonte të vërtetën.
Aktiviteti 2: Si e bëtë kërkimin e pergamenave dhe vendosjen e fjalëve nga 2 e Pjetrit 3:18a, sipas radhës? Është shumë e rëndësishme ta dimë Fjalën e Perëndisë, sepse na ndihmon të mësojmë të vërtetën dhe të rritemi! Sot do të mësojmë rreth një personi të urtë që kërkonte të vërtetën.

Lutu: *Sfido njërin nga nxënësit që ta nisë mësimin me lutje. Kjo do t'i ndihmojë të luten në ambiente publike. Udhëzoje se për çfarë të lutet dhe nxite të ngrihet në këmbë e të lutet që ta dëgjojnë të gjithë.*

Zbuloje: *Pyeti nëse 2 i Kronikave gjendet në Dhiatën e Re apo në Dhiatën e Vjetër. (Dh.V.) Sfidoji nxënësit t'i përmendin librat e Dhiatës së Vjetër deri te 2 i Kronikave. Shkruaj 2 i Kronikave 34 në tabelë dhe kërkoju nxënësve t'i hapin Biblat te ai pasazh. Për nxënësit më të rritur mund të përdorësh metodën e stërvitjes me shpata.*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Kronologjia: Mësimi i sotëm na tregon për një djalosh që ishte vetëm tetë vjeç kur u bë mbret. *Drejtohu te mbreti Josia në kronologji.*

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Kur mësojmë për mbretërit e Izraelit na duket sikur po bëjmë një xhiro në malet ruse: majtas-djathtas, lart-poshtë. Kishte mbretër të mirë që bënë më të mirën për t'i ndihmuar izraelitët të donin dhe t'i bindeshin Perëndisë. Mirëpo kishte edhe shumë mbretër të këqij që nuk i bindeshin Perëndisë dhe që e drejtuan edhe popullin në mosbindje.

Kush është mbreti i parë i Izraelit? (Mbreti Saul) *Drejtohu te kronologjia.* Kush ishte mbreti i dytë? (Mbreti David) *Drejtohu te kronologjia.* Perëndia tha se çdo mbret duhej të shkruante një kopje të Fjalës së Perëndisë për vete dhe ta lexonte çdo ditë të jetës (Ligji i Përtërirë 17:18-20). Nëse mbreti do të vepronte kështu, do të mund të mësonte t'i bindej Perëndisë e të ishte mbret i mirë. A mendoni se të gjithë mbretërit e lexuan Fjalën e Perëndisë çdo ditë të jetës ashtu siç kishte urdhëruar Perëndia? Do ta zbulojmë.

Përvijimi i Shkrimit: 2 i Kronikave 34

Josia bëhet mbret i Juda në moshën tetë vjeçare

Lexo 2 i Kronikave 34:1-3a

Përmbledhje: Kush ishte Josia? Kujtoni që Perëndia e kishte ndarë shtetin e Izraelit në dy mbretëri – mbretëria e jugut, Juda, dhe mbretëria e veriut, Izraeli. Josia u bë mbret i Judës kur ishte tetë vjeç! Nga ajo që lexojmë duket se ai ishte një mbret i mirë, apo jo? Vargu 2 thotë se Josia "bëri atë që është e drejtë në sytë e Zotit". Kur ishte gjashtëmbëdhjetë vjeç filloi të kërkonte Perëndinë. A ishte gjë e mirë që mbreti Josia po kërkonte Perëndinë? (Po!) Le të shohim se çfarë bëri tjetër mbreti Josia.

Mbreti Josia shkatërron altarët dhe idhujt e perëndive të rreme

Parafrazim i 2 i Kronikave 34:3b-7:

Populli i Judës dhe ai i Izraelit kishin adhuruar perënditë e rreme në vend të Perëndisë së vërtetë. Kur Josia ishte thuajse njëzet vjeç, vendosi të pastronte vendin nga gjithçka që populli kishte përdorur për të adhuruar perënditë e rreme. Ai shkatërroi altarët dhe idhujt, si dhe gjërat e tjera që njerëzit po përdornin. A mendoni se ishte gjë e mirë heqja e idhujve? (Po!) A mendoni se ishte e thjeshtë për Josian? Me shumë mundësi jo; ka shumë gjasa të ketë zemëruar shumë njerëz. Çfarë bëri pas kësaj mbreti Josia?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mbreti Josia restauron tempullin e Perëndisë

Parafrazim i 2 i Kronikave 34:8-13:

Kur mbreti Josia ishte njëzet e gjashtë vjeç, vendosi të restauronte tempullin e Perëndisë. A ju kujtohet mbreti që e ndërtoi tempullin? (Mbreti Solomon, biri i mbretit David) Tempulli ishte vendi ku judenjtë duhej të vinin për të adhuruar Perëndinë e për të bërë sakrifica për mëkatet e tyre. Është e trishtë që disa nga mbretërit nuk ishin kujdesur për tempullin e Perëndisë. Është si të mos kujdesesh për kishën. A mendoni se ishte gjë e mirë që mbreti Josia donte të restauronte tempullin? (Po!) Për shkak se do të kushtonte shumë para, ata i mblodhën paratë nga populli dhe i ruajtën në tempull. Dëgjoni se ç'ndodhi pas kësaj.

Gjendet Libri i Ligjit

Lexo 2 i Kronikave 34:14-19

Përmbledhje: Kur prifti shkoi në tempull për të marrë paratë, gjeti Librin e Ligjit të Perëndisë! Çfarë?? Mbreti Josia as që e dinte se Libri i Ligjit të Perëndisë ekzistonte.

Pa prit... ndalojeni mësimin. *Drejtohu te kronologjia.* Mos po më thoni se mbretërit nuk e tejçuan Fjalën e Zotit? Pra, disa nga mbretërit menduan se mund ta drejtonin mbretërinë pa kërkuar ndihmën dhe drejtimin e Perëndisë? Si mund të jetë e vërtetë kjo?

Fjala e Perëndisë iu dha izraelitëve që në kohën e Moisiut. Perëndia e kishte urdhëruar secilin prej mbretërve të shkruante ligjin për vete dhe ta lexonte çdo ditë. Atëherë, si mbeti Fjala e Perëndisë aty në tempull, e papërdorur? Disa prej mbretërve nuk iu bindën Perëndisë. Ata adhuruan idhuj dhe e harruan Fjalën e Perëndisë. Edhe priftërinjtë dhe populli e harruan Fjalën e Perëndisë. Si mund të ndodhte kjo? A mund të ndodhë kjo në botën tonë sot? A po ndodh? (Po)

A do të të mungonte Bibla po ta humbisje? A do të të interesonte në të vërtetë nëse nuk do ta mësoje përmendsh? A u përpoqe t'i mësoje apo t'i kujtoje 12 vargjet kyç gjatë javës? A e lexon Biblën gjatë javës? A mos je në rrugën për të qenë si ata mbretërit që "harruan Fjalën e Zotit" apo je si mbreti Josia?

Njerëzit e mbretit Josia gjetën Fjalën e Perëndisë dhe kur iu lexua mbretit Josia, ai mësoi të vërtetën. Ai kuptoi se njerëzit e mbretërisë së tij ishin larguar nga Perëndia, prandaj mbreti Josia grisi rrobat dhe qau.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mbreti Josia mëson për ndëshkimin e Judës

Parafrazim i 2 i Kronikave 34:20-28:

Pasi Shafani lexoi Fjalën e Perëndisë, mbreti Josia zbuloi se Perëndia do t'i ndëshkonte njerëzit e Judës, sepse ata kishin adhuruar perënditë e rreme në vend që të adhuronin Perëndinë e vërtetë. Mirëpo, për shkak se mbreti Josia ishte i përulur dhe i mërzitur për mëkatin e Izraelit, Perëndia nuk e dërgoi ndëshkimin deri pas vdekjes së mbretit Josia. Le të shohim se çfarë bëri mbreti Josia pasi dëgjoi mesazhin e Perëndisë.

Mbreti Josia u lexon popullit Fjalën e Perëndisë

Lexo 2 i Kronikave 34:29-33

Përmbledhje: A nuk është e mrekullueshme? Mbreti Josia ia lexon të gjithë popullit të vërtetën nga Fjala e Perëndisë. Pastaj u kërkoi t'i bindeshin asaj për sa kohë ai të ishte gjallë!

Përfundimi

Mendoni pak se sa besnik është Perëndia. Kur mbreti Josia kërkoi Perëndinë, Perëndia e drejtoi te Fjala e Tij në Librin e Ligjit. Mbreti Josia e lexoi për vete dhe ia lexoi edhe izraelitëve. Të gjithë mësuan të vërtetën dhe vendosën t'i bindeshin Perëndisë.

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

Sa e rëndësishme është për ty të lexosh e t'i bindesh Fjalës së Perëndisë çdo ditë? Përse mendoni se Perëndia e vendosi 2 e Pjetrit 3:18a në Bibël? Të rritesh dhe ta njohësh Fjalën e Perëndisë është e rëndësishme. Bibla është 100% e vërtetë. Është i vetmi libër që është Fjala e Perëndisë, ndaj mund të jemi të sigurt se përmban vetëm të vërtetën absolute (të plotë, të përsosur).

Nëse bëtë aktivitetin me zhytje në ujë, thuaj: Ngjason pak me aktivitetin që bëmë. Kishte shumë shënjestra, mirëpo vetëm njëra ishte **e vërteta**. Bibla është e vërteta.

Si do të gjeni kohë për të mësuar e për t'iu bindur Fjalës së Perëndisë këtë javë? *Inkurajoji nxënësit ta shënojnë këtë pasazh në Biblat e tyre dhe ta lexojnë gjatë javës.*

Ka një çelës shumë të rëndësishëm që na ndihmon ta kuptojmë Fjalën e Perëndisë. Duhet së pari të besojmë në Jezusin për të shpëtuar nga ndëshkimi për mëkatin dhe ta bëjmë Atë udhëheqësin e jetës sonë. Kur besojmë në Jezusin, Fryma e Shenjtë na ndihmon të kuptojmë atë që është shkruar në Bibël. Fryma e Shenjtë na ndihmon ta jetojmë. Kur e mësojmë të vërtetë nga Fjala e Perëndisë dhe e zbatojmë në jetën tonë, mund të ndihemi besnikë, njësoj si mbreti Josia. Le të sigurohemi që të gjithë e dinë se çfarë do të thotë të besosh në Jezusin për të shpëtuar nga mëkati dhe ta bësh

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

udhëheqësin e jetës sate. *Mundësi për të treguar Ungjillin përmes "Librit pa fjalë" dhe për të bërë ftesë për shpëtim.*

Për nxënësit më të rritur: Po njerëzit që nuk e kanë Biblën? Si duhet ta dinë të vërtetën? A e dini se Perëndia na e jep përgjigjen në Bibël? Perëndia na thotë te Romakëve 1:20 se njerëzit duhet të kuptojnë se ka një Perëndi vetëm duke parë gjithçka Ai ka krijuar. Ai gjithashtu na thotë se, kur të shohin krijimin dhe të fillojnë të kërkojnë Perëndinë, do ta gjejnë – njësoj si mbreti Josia. Ka shumë njerëz, edhe sot, nëpër të gjithë botën, që po e përkthejnë Fjalën e Perëndisë në gjithnjë e më shumë gjuhë, që të gjithë ta dinë të vërtetën.

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Për çfarë e urdhëroi Perëndia çdo mbret në Izrael? (Ta shkruante Fjalën e Perëndisë për vete dhe ta lexonte çdo ditë)
2. Kush ishte Josia? (Josia ishte mbreti i Judës; ai u bë mbret në moshën tetë vjeçare)
3. Çfarë bëri mbreti Josia me altarët dhe idhujt e perëndive të rreme? (Ai i shkatërroi)
4. Çfarë bëri mbreti Josia me tempullin e Perëndisë? (Ai e riparoi)
5. Përse tempulli kishte nevojë për riparim? (Sepse mbretërit e tjerë nuk ishin kujdesur për të)
6. Çfarë u gjet në tempull? (Fjala e Perëndisë – libri i Ligjit)
7. Çfarë bëri mbreti Josia për popullin e Judës pasi dëgjoi Fjalën e Perëndisë? (Ai ia lexoi Fjalën e Perëndisë të gjithë popullit)
8. Çfarë u kërkoi mbreti Josia njerëzve, pasi kishin dëgjuar Fjalën e Perëndisë? (U kërkoi t'i bindeshin)
9. A e lexon ti Fjalën e Perëndisë dhe a i bindesh?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 5

2 i Mbretërve 25:1-21; Jeremia 29:4-14

(Ngjarje paralele te 2 i Kronikave 36:15-21)

Kupto si duhet:	Nebukadnetsari pushton Judën.
Mendo si duhet:	"Ki besim te Zoti me gjithë zemër dhe mos u mbështet në mençurinë tënde; pranoje në të gjitha rrugët e tua dhe ai do të drejtojë shtigjet e tua." Fjalët e Urta 3:5-6 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do t'i besoj planit të Perëndisë për jetën time.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem në paqe kur i besoj planit të Perëndisë për jetën time.

PËRGATITU!

Këtë javë do të mësojmë se si mund t'i besojmë planit të Perëndisë për jetën tonë, edhe kur rrethanat nuk duken të mira. Ne mund të besojmë se Perëndia e ka menduar çdo sfidë dhe çdo gëzim për të mirën tonë dhe për lavdinë e Tij. Kjo mund të na ngushëllojë kur kalojmë periudha sfiduese. Ndërsa përgatitemi për mësimin, le të lutemi që nxënësit do t'i besojnë planit të Perëndisë dhe do të ndiejnë paqen dhe dashurinë e Tij.

Lutu: Kalo kohë duke u lutur për nxënësit e tu. Kërkoji Perëndisë që ata të ftojnë një mik në klasë.

Lexo: 2 i Mbretërve 25:1-21; Jeremia 29:4-14 (Ngjarje paralele te 2 i Kronikave 36:15-21)

Kupto si duhet: Nebukadnetsari pushton Judën
Pas vdekjes së mbretit Josia, Juda dhe mbretërit e saj iu kthyen ligësisë dhe erdhi koha për ndëshkimin që i ishte premtuar Judës. Perëndia lejoi që ushtria e mbretit Nebukadnetsar të pushtonte Judën, të shkatërronte Jerusalemin dhe t'i merrte shumë nga qytetarët e Judës si robër në Babiloni. Kjo ishte një periudhë e tmerrshme për popullin e zgjedhur të Perëndisë, mirëpo ishte e gjitha pjesë e planit të Tij. Perëndia i inkurajoi izraelitët të vendoseshin në Babiloni dhe ta bënin atë shtëpinë e tyre të re. Premtimi i Tij ishte që ata do të përparonin e nuk do të shkatërroheshin. Pas shtatëdhjetë vitesh ata do të ktheheshin në shtëpinë e tyre, në Tokën e Premtuar. Nga ky episod në historinë e Judës, kuptojmë se mund t'i besojmë planit të Perëndisë për jetën tonë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënime për mësuesin kryesor:

- Për ta thjeshtuar mësimin nuk do të merremi me ngjarjen e vjedhjes së thesarit të tempullit as me daljen e popullit të Jerusalemit që regjistrohet te 2 i Mbretërve 24.
- Nxënësit shpeshherë pyesin: "Përse i lejon Perëndia gjërat e këqija?" Ata duhet të kuptojnë se te Zanafilla mëkati hyri në botë. Mëkati ka pasoja që ndikojnë te njerëzit e mirë. Perëndia e urren mëkatin. Perëndia është i drejtë dhe i përsosur dhe mëkati duhet ndëshkuar. Ne duhet t'i lutemi Perëndisë (siç bëri mbreti Ezekia), të besojmë se Ai ka kontrollin e gjërave dhe të kemi bindjen se një ditë Ai do t'i zgjidhë të gjitha.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Bëj një hartë të madhe në tabelë ose në një poster. Shto emrat e shteteve, qyteteve, ushtrive, mureve, mbretërve dhe betejave, duke shtuar edhe figura, ndërkohë që shpjegon mësimin.
2. Shndërroje të gjithë klasën në një "hartë". Lëvizi nxënësit në vendndodhje të ndryshme ndërsa tregon mësimin.
3. Krijo një hartë të madhe në dysheme dhe përdor figura për të shpjeguar mësimin.

NISU!

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Dritë e kuqe, dritë jeshile

Qëllimi: T'i sfidojmë nxënësit të përqendrohen në planin e përsosur.

Shënim për drejtuesin e "Kohës së zbulimit": *Është shumë e rëndësishme që ky aktivitet të mos jetë thjesht një lojë e shpejtë, argëtuese. Lexoje të gjithë mësimin me kujdes dhe bëhu ekspert i planit, siç detajohet më poshtë, që kjo "Kohë zbulimi" të lidhet vërtet me mësimin.*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Aktiviteti 1: Hapësirë jashtë

Mjetet:

- Bojë me spërkatëse (krijo dy vija: vija A do të jetë vija e nisjes dhe vija B do të jetë vija e përfundimit; vijat duhen bërë në bar/tokë, nëntë metra larg njëra-tjetrës; gjatësinë mund ta përcaktosh në bazë të moshës – ki parasysh që kalimi i vijave duhet të jetë sfidues)
- Lëpirëse ose ndonjë ushqim që ata kanë qejf; do ta marrin të gjithë nxënësit që kalojnë vijën B
- Një vend i caktuar për pushim (pas kalimit të vijës B)
- Etiketa shpërblyese
- Tabela/kartonë të mëdhenj ku shkruhet "Ndal" dhe "Nisu", ngjitur ne kurriz të njëra--tjetrës mbi një shkop (material burimor i printueshëm),
- Arbitra që mbajnë veshur një formë identifikimi (shami të kuqe ose blu në kokë apo bluze me viza)



Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Mblidhi nxënësit që të dëgjojnë të gjithë.
2. Thuaj: Kam një plan! Plani im është që të gjithë të niseni nga vija A dhe të kaloni vijën B duke iu bindur të gjitha rregullave të qarkullimit. A duket e lehtë? Është plan i thjeshtë, thjesht ndaluni dhe ndiqni shenjat që ju jap unë. Plani im përfshin diçka të mirë në fund. Nëse e kaloni me sukses vijën B, mund të pushoni dhe të shijoni një lëpirëse (apo diçka tjetër që është blerë). Si ju duket plani? Edhe diçka tjetër – sa për kujtesë – pjesa sfiduese e këtij plani është që duhet t'i bindeni semaforit (e kuqe/jeshile). Kur shenja të thotë "ndal", duhet të ndaloni. (Ti nuk duhet ta bërtasësh me zë, thjesht të rrotullosh tabelën.) Pasoja e të mos ndjekurit planin është kthimi te vija A dhe rifillimi i sfidës. Mos harroni, nëse e kaloni vijën B, mund të pushoni dhe të shijoni lëpirësen. A e kuptoni planin?
3. Luani derisa të gjithë nxënësit ta kalojnë vijën. Përsëriteni nëse keni kohë. Për raundin e dytë, shpërblimi do të jetë një etiketë shpërblyese për këdo që kalon nga ana tjetër.
4. Prezanto arbitrat (që mund të jenë drejtues të tjerë ose të ftuar), të cilët do të kontrollojnë nëse nxënësit ndalojnë kur rrotullohet tabela te "Ndal". Tregoju kur nuk janë duke ndjekur planin. Sigurohu t'i kthesh te vija e nisjes nxënësit që nuk ndjekin tabelën.
5. Sigurohu gjithashtu ta kthesh shpejt tabelën dhe ta bësh aktivitetin pakëz ngatërrues! Duhet ta kthesh tabelën shumë herë derisa nxënësit të kalojnë vijën.
6. Kjo lojë duhet luajtur me ritëm të shpejtë dhe duhet të jetë argëtuese.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Këshillë për "Kohën e zbulimit": Kjo është një ditë e shkëlqyer për t'i prezantuar prindërit me "Kohën e zbulimit". Mund t'u kërkosh atyre të luajnë rolin e arbitrit. Sa më tepër të jenë, aq më saktë do të gjykohet KZ-ja.

Këshillë për nxënësit më të rritur: Shto disa detyra të vështira si: kalo poshtë litarit, kalo sipër litarit, zvarritu nën karrige, etj.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesi kryesor – Lidhja e KZ-së me mësimin: Drejtuesi i KZ-së kishte një plan shumë të mirë për ju. Gjithçka duhej të bënit ishte të kalonit te vija B për të shijuar shpërblimin. Çfarë e vështirësoi KZ-në? (Ndjekja e dritave të semaforit)

A ishte më e thjeshtë t'i ndiqnit shenjat kur sytë i kishit përqendruar te to? (Po)

Çfarë ndodhte nëse nuk përqendroheshit te tabela? (Kishte pasoja, duhej të ktheheshit nga fillimi)

Çfarë ndodhi kur e ndoqët planin? (Ia dolët deri në fund të sfidës dhe morët një shpërblim)

Kjo më kujton planin e Perëndisë për jetën tonë. Ai na dha Biblën, që ta njohim Atë dhe të dimë se si dëshiron Ai që ne të jetojmë. Përqendrimi te Perëndia dhe te plani i Tij për ne, edhe kur nuk e kuptojmë, sjell bekime! Sot do të zbulojmë se çfarë ndodhi me izraelitët kur nuk u përqendruan te Perëndia dhe te plani i Tij për ta. Në fakt, ata treguan mosbindje ndaj Perëndisë me vetëdije për 1000 vite!

Lutu: *Sfido një nga nxënësit ta nisë mësimin me lutje. Nëse lutjet bëhen përsëritëse javë pas javë, mund të modelosh një lutje më të përqendruar që përshtatet me mësimin, si për shembull: "I dashur Atë qiellor, lutem që ne t'i besojmë planit Tënd të përsosur për jetën tonë. Na ndihmo t'i bindemi Fjalës sate çdo ditë të javës."*

Zbuloje: *Pyeti nëse 2 i Mbretërve gjendet në Dhiatën e Vjetër apo në Dhiatën e Re. (Dh.V.) Kërkoju nxënësve të rendisin librat e Dhiatës së Vjetër deri te 2 i Mbretërve. Kërkoju të gjejnë 2 i Mbretërve 25 dhe të vendosin një libërshënues atje. I inkurajojmë fort të gjithë fëmijët të marrin Biblat e tyre. Duke marrë Biblën me vete do mësojnë ta përdorin më mirë. Nëse ndonjëri nga nxënësit nuk e merr Biblën, mund t'ua kujtosh prindërve kur të vijnë për t'i marrë pas takimit.*

Kronologjia: A arrini ta shihni veprën e Perëndisë në jetën e personave në kronologji? Perëndia veproi përmes izraelitëve, mbretërve dhe shumë të tjerëve për të përmbushur planin e Tij. Ai gjithashtu do të veprojë përmes teje! A ju kujtohet se ku gjendemi ne te kronologjia? (Epoka e kishës)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Perëndia kishte një plan shumë të veçantë për popullin e Izraelit. Ai donte që ata të ishin ndryshe. Ai donte që ata të ndaheshin veçmas (të shenjtë) dhe ta bënë Perëndinë përparësinë e tyre.

Nëse je i krishterë (*përkufizo se çfarë është një i krishterë duke përdorur "Librin pa fjalë"*) dhe e kupton se sa e rëndësishme është të jesh i krishterë (ke shpëtuar nga mëkati përjetësisht dhe ke një marrëdhënie të jashtëzakonshme me Perëndinë e vërtetë), kështu duhet të duash të jetosh. Duhet të jesh i zellshëm për ta bërë Perëndinë të parin në jetën tënde dhe njerëzit përreth teje duhet të vërejnë ndryshimin në jetën tënde. Jeta jote duhet të jetë si ajo e mbretit Josia.

Perëndia u dha izraelitëve Librin e Ligjit (një pjesë e Biblës). Ai u tregonte atyre se si të jetonin, që të mund të njihnin Perëndinë dhe planin e Tij për ta. Perëndia premtoi bekime për izraelitët nëse ata do t'i bindeshin dhe Ai premtoi ndëshkim nëse ata nuk do të bindeshin. Fatkeqësisht, për rreth 1000 vjet, izraelitët thujase gjithmonë treguan mosbindje ndaj Perëndisë. Jetuan siç deshën vetë dhe adhuruan idhujt e vendeve të tjera. Perëndia dërgoi profetë për t'i paralajmëruar që të pendoheshin – pra, të largoheshin nga mëkati dhe të vepronin me drejtësi. Profetët u thanë izraelitëve se Perëndia do t'i ndëshkonte, mirëpo ata nuk pranuan t'i besonin. Pastaj Perëndia lejoi që mbretëria e veriut, Izraeli, të pushtohej nga Asiria. Disa nga drejtuesit e Judës, si mbreti Josia (mësimi i javës së kaluar), i udhëhoqën njerëzit në Judë që të jetonin në bindje ndaj Perëndisë, mirëpo nuk zgjati shumë. Perëndia i kishte thënë mbretit Josia se Juda do të ndëshkohej, por do të ndodhte pas vdekjes së Josias. Mos harroni se Perëndia i mban gjithmonë premtimet. Më në fund erdhi koha që Perëndia t'i ndëshkonte izraelitët në Jude. Do të mësojmë tani për atë periudhë të tmerrshme.

Përvijimi i Shkrimit: 2 i Mbretërve 25:1-21; Jeremia 29:4-14 (Ngjarje paralele te 2 i Kronikave 36:15-21)

Perëndia përdor Babiloninë për të ndëshkuar popullin e Judës

Parafrazimi i 2 i Mbretërve 25:1-7:

Kujtoni që Perëndia i tha mbretit Josia se do ta ndëshkonte Judën. Pse (Populli i Judës po adhuronte idhuj) Idhulli është diçka e krijuar që adhurohet në vend të Perëndisë, Krijuesit. A adhurojnë njerëzit idhuj edhe sot? Çfarë idhujsh gjejmë në komunitetin tonë? Disa fe, në fakt, kanë idhuj apo statuja fizike që i adhurojnë. Një tjetër formë idhulli mund të jetë sporti, paraja, të qenët i famshëm, etj.

Mbreti Josia kishte vdekur dhe një nga bijtë e tij, Sedekia, ishte bërë mbreti i Judesë. Nebukadnetsari ishte mbreti i fuqishëm i Babilonisë. Mbreti Nebukadnetsar po e detyronte Judën të paguante që t'i linte njerëzit e Judës

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

të qetë. Një ditë, mbreti Sedekia vendosi të mos i jepte më para Babilonisë. Kështu, mbreti Nebukadnetsar dërgoi ushtrinë e tij për të rrethuar Jerusalemin, kryeqytetin e Judesë, që asnjë izraelit të mos dilte as të mos hynte. Ky quhet rrethim. Shumë shpejt, njerëzit e qytetit do të vdisnin urie, sepse do t'u mbaronte ushqimi. Mbreti Sedekia dhe ushtria e tij u përpoqën të arratiseshin, por ushtria e Babilonisë e kapi atë dhe bijtë e tij. Ata vranë bijtë e mbretit Sedekia, e verbuan mbretin dhe e morën rob në Babiloni.

Sa situatë e tmerrshme! Përse e lejoi këtë gjë Perëndia? Ka gjithmonë ndëshkim për mëkatin. Kjo quhet drejtësi. Robëria në Babiloni ishte pjesë e planit të Perëndisë për ta ndëshkuar Judën, që ata të ktheheshin te Perëndia dhe të pendoheshin. Të pendohesh do të thotë të largohesh nga mëkati dhe të vendosësh të veprosh me drejtësi.

Ushtria e Babilonisë shkatërron Jerusalemin

Parafrazim i 2 i Mbretërve 25:8-17:

Ushtria e Babilonisë dogji tempullin ku izraelitët adhuronin Perëndinë. Ata dogjën pallatin e mbretit dhe të gjitha ndërtesat e rëndësishme në Jerusalem. Ata hodhën muret përreth qytetit të Jerusalemit. Vodhën thesarin e tempullit. Ky ishte një ndëshkim shumë i ashpër.

A ishte pjesë e planit të Perëndisë ta ndëshkonte Judën për mosbindjen e treguar? (Po) Kujtoni që Perëndia e urren mëkatin. Mëkati është shumë serioz për Perëndinë.

Ungjilli

Ndaluni dhe mendoni për mëkatin tuaj... Perëndia duhet të na dojë vërtetë, përderisa dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të vdiste e të merrte ndëshkimin për mëkatin tonë.

Perëndia e dorëzon popullin e Jerusalemit në duart e mbretit Nebukadnetsar

Parafrazimi i 2 i Mbretërve 25:18-21:

Pasi mbreti Nebukadnetsar shkatërroi Jerusalemin, vrau shumë njerëz në Jude. Shumicën e të mbijetuarve i mori si robër në Babiloni. A mendoni se ishte pjesë e planit të Perëndisë për të ndëshkuar popullin e Judës? (Po) Le të lexojmë se çfarë i tha Perëndia popullit që ishte zënë rob në Babiloni.

Perëndia u thotë izraelitëve të vendosen në Babiloni e të jetojnë atje jetën e tyre

Lexo Jeremia 29:4-7

Përmbledhje: Izraelitët ishin marrë larg shtëpive të tyre dhe larg gjithçkaje që njihnin. Perëndia donte që ata të ndërtonin shtëpinë e tyre në Babiloni për pak

kohë. Ai donte që ata të jetonin një jetë të mirë në Babiloni. Jo vetëm kaq, por Ai ua bëri si premtim. Le të dëgjojmë se çfarë u premtoi Ai.

Për shkak të përmbajtjes dhe kohës, do ta anashkalojmë Jeremian 29:8-9.

Perëndia u premton izraelitëve se do t'i rikthejë në Judë pas shtatëdhjetë vitesh

Lexo Jeremia 29:10-14

Përmbledhje: Planet e Perëndisë nuk janë gjithmonë të thjeshta, njësoj si "Koha e zbulimit". Ka periudha kur duhet të lëvizim, kur duhet të ndalemi dhe kur duhet të rifillojmë. Nëpër të gjitha këto ne duhet t'i mbajmë sytë te Ai dhe t'i besojmë planit të Tij të përsosur.

Përfundimi

Perëndia i donte izraelitët dhe kishte një plan të madh për ta, mirëpo Perëndia është i shenjtë dhe e urren mëkatin. Perëndia i ndëshkoi izraelitët, që ata të pendoheshin dhe të ktheheshin tek Ai. Ata kaluan shtatëdhjetë vjet në Babiloni, pastaj Perëndia i ktheu në tokën e tyre. Ai donte të mirën për ta e jo t'u bënte keq. Ai donte që ata ta kërkonin me gjithë zemër. Ai donte që ata të zbatonin vargun që morëm sot te "Mendo si duhet", Fjalët e Urta 3:5-6. Le ta themi së bashku. *Recitoni Fjalët e Urta 3:5-6.*

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

Ndoshta po mendoni: "Oh, nuk më besohet me këta izraelitët! A nuk i binden dot Perëndisë dhe të ndjekin planin e Tij? A nuk duhet ta kishin ditur tashmë se plani i Perëndisë është më i miri?"

Mirëpo, po ne? A i bindemi gjithmonë Perëndisë dhe a e ndjekim planin e Tij? Perëndia e dinte se izraelitët, dhe të gjithë njerëzit që vinin pas tyre, nuk do të mundeshin kurrë t'i bindeshin dhe ta ndiqnin përsosmërisht. Ai e dinte se çdo njeri do të mëkatonte. Mëkati është problem i madh dhe ka pasoja shumë serioze për të (Romakëve 2:23, Romakëve 6:23). Lajmi i Mirë është që Perëndia të do aq shumë, saqë dërgoi Birin e Tij, Jezusin, që të bëhej Shpëtimtari yt. Ai erdhi të vdiste në kryq, që të merrte mbi vete ndëshkimin që ti meritoje. Perëndia do që çdo njeri të besojë në Jezusin dhe ta bëjë Atë Zotin dhe Shpëtimtarin e vet.

A zgjedh planin e Perëndisë apo planin tënd? A dëshiron gjërat e tua, apo më të mirën që Perëndia ka për jetën tënde? Nëse do më të mirën e Perëndisë për jetën tënde, fillo duke i besuar Jezusit që të të shpëtojë nga mëkati dhe bëje Udhëheqësin e jetës sate. A e ke bërë këtë? Kur i beson dhe ndjek planin e Perëndisë, mund të ndiesh paqen që vetëm Ai e jep. Po sikur të mos i kesh besuar Jezusit akoma? Mund t'i besosh Atij sot.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mundësi për të shpallur Ungjillin përmes "Librit pa fjalë" dhe për të bërë ftesë për të besuar tek Ai.

Po ju që tashmë keni besuar në Jezusin si Shpëtimtar? Nëse jeni të krishterë, Perëndia ka një plan për ju. Çfarë ju pengon zakonisht që të përqendroheni te plani i Tij dhe ta ndiqni Jezusin çdo ditë? Për shembull: E dini se duhet ta lexoni Biblën, por e zini kohën duke parë video në YouTube. Apo ju pëlqejnë aq shumë sportet dhe fitorja, saqë nuk ju intereson nëse thoni gjëra që i ulin të tjerët, për aq kohë sa ju bën juve të dukeni më mirë. Ky është mëkat kundër Perëndisë dhe të tjerëve. Kur mëkatojmë duhet të pranojmë, të rrëfejmë e të pendohemi, pastaj t'i kërkojmë ndihmë Frymës së Shenjtë për të qenë të përqendruar në ndjekjen e Jezusit. Perëndia premton se do të na falë dhe Ai i mban gjithmonë premtimet!

Le të qëndrojmë disa çaste në heshtje. Mendoni për çfarë mësuam sot dhe thuajini Perëndisë se do t'i besoni Atij dhe planit të Tij për jetën tuaj.

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Çfarë kishte mësuar mbreti Josia në lidhje me atë që do të bënte Perëndia? (Perëndia do t'i ndëshkonte njerëzit në Jude, sepse ata kishin mëkatuar)
2. Përse do t'i ndëshkonte Perëndia njerëzit në Jude? (Ata kishin adhuruar perënditë e rreme në vend të Tij, Perëndisë së vërtetë)
3. Cilin vend dhe cilin mbret përdori Perëndia për të ndëshkuar njerëzit në Jude? (Babiloninë, mbretin Nebukadnetsar)
4. Çfarë i bëri ushtria e mbretit Nebukadnetsar qytetit të Jerusalemit (Dogji tempullin, pallatin dhe ndërtesat e rëndësishme; shkatërroi muret përreth qytetit; vodhi thesarin e tempullit)
5. Çfarë ndodhi me popullin e Judës? (Disa u vranë, shumica u mor rob në Babiloni, më të varfërit u lanë në Judë)
6. Çfarë u tha Perëndia atyre që u morën robër në Babiloni? (U tha të ndërtonin jetën e tyre në Babiloni)
7. Çfarë premtimi i bëri Perëndia atyre që u robëruan në Babiloni? (Ata do të mbeteshin në Babiloni për shtatëdhjetë vjet, pastaj do t'i kthente në Jude)
8. A ishte e gjithë kjo pjesë e planit të Perëndisë? (Po)
9. A i beson planit të Perëndisë për jetën tënde?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 6
Danieli 1:1-20

Kupto si duhet:	Danieli refuzon ushqimin e mbretit.
Mendo si duhet:	Jezusi i tha: "Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje." Gjoni 14:6 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do ta jetoj jetën siç i pëlqen Perëndisë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem besnik kur e jetoj jetën siç i pëlqen Perëndisë.

PËRGATITU!

Çdo njeri mund të zgjedhë të përqendrohet te vetja ose te Perëndia. Kur besojmë në Krishtin, vetja e vjetër kryqëzohet në mënyrë që të jetojmë një jetë që nderon Perëndinë. Kjo sjell gëzim të madh, por ka edhe një çmim. Këtë javë do të fillojmë të studiojmë jetën e Danielit, një djalë i ri që zgjodhi të jetonte me besnikëri për Perëndinë, edhe kur çmimi që duhej të paguante ishte i lartë.

Lutu: Nëse do ta kishe patur Danielin pjesë të grupit të fëmijëve, si do të luteshe për të? A do t'i kërkoje Perëndisë mbrojtje, guxim, pjekuri frymërore apo aftësinë për të qëndruar i fortë? Të lutem, mbaj në mendje se ti vërtet KE "Danielë" në klasën tënde! Lutu për nxënësit emër për emër, duke ditur se do të kalojnë sfida të vështira që do të sfidojnë besimin e tyre.

Lexo: Danieli 1:1-20

Kupto si duhet: Danieli refuzon ushqimin e mbretit
Gjatë robërimit të Judës në Babiloni, ishte një djalë i quajtur Daniel dhe tre shokët e tij. Ata kishin lindur në familje mbretërore dhe fisnike në Judë, por tanimë nuk ishin gjë tjetër veçse shërbëtorët e mbretit Nebukadnetsar. Kur iu tha të hanin ushqimin e mbretit – ushqim që do t'i ndotte – ata kërkuan leje për të ngrënë vetëm perime dhe për të pirë vetëm ujë, që të vazhdonin të jetonin sipas pëlqimit të Perëndisë. Perëndia i bekoi djemtë e rinj me shëndet, urtësi dhe njohuri. Madje Perëndia i dha Danielit aftësinë për të kuptuar vizione dhe ëndrra. Pas tre vitesh në shërbesë, në vend që t'i gjente të dobësuar, siç kishin frikë disa, mbreti Nebukadnetsar i gjeti dhjetë herë më të mençur se bashkëmoshatarët e tyre në Babiloni. Jetët e Danielit, Shadrakut, Meshakut dhe Abednegos duhet të na inkurajojnë të jetojmë gjithmonë siç i pëlqen Perëndisë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënime për mësuesin kryesor:

- Shënim historik: Danieli, Shadraku, Meshaku dhe Abednego u morën robër në Babiloni në pjesën e parë të mërgimit me tri faza. Për ta thjeshtuar mësimin, nuk do t'i adresojmë tre fazat e ndryshme të mërgimit.
- Qëllimi ynë është t'u mësojmë nxënësve se dëshira për t'ju bindur Perëndisë rrjedh nga një marrëdhënie me Të. Ne "Veprojmë si duhet" sepse "Kuptojmë si duhet".
- Ki kujdes të mos barazosh bindjen për të ngrënë ushqimin e duhur me shpëtimin.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Var katër kostume në një litar, për rroba që të përfaqësojnë katër personazhet e mësimit. Ndërsa flet për miqtë, qëndro pas kostumeve, si të ishe duke hyrë në personazh; personalizoji me objekte specifike dhe shpjego si mund të jenë ndier. Inkurajoji nxënësit t'i shohin si njerëz të vërtetë, jo thjesht si personazhe të një historie.
2. Përdor foto dhe/ose objekte për të shpjeguar mësimin. Fotot e katër djemve të rinj dhe mbretit, një pjatë me ushqime të pasurish (përdor ushqim plastik) dhe një pjatë me perime (përsëri plastike) dhe një karton/tabelë ku shkruhet: "Mënyra e Perëndisë."
3. Përgatite skenën për një banket duke sjellë tasa të mbushur me ushqim me aromë të mirë ose erëza aromatike. Kjo do të ndihmojë të theksosh faktin se refuzimi i ushqimit të mbretit nuk ishte gjithmonë i lehtë!

NISU!

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Koha e zbulimit: Një rrugë!

Qëllimi: T'i sfidojmë nxënësit të ndjekin **rrugën e vetme**.

Aktiviteti 1: Hapësirë e madhe

Shënim: Zhvilloje aktivitetin si të ishte një emision televiziv.

Qëllimi kryesor: Grupet do të udhëtojnë në katër ose pesë stacione për të përfunduar një seri sfidash. Qëllimi i tyre është të gjejnë thesarin e madh në fund të "Kohës së zbulimit". Ata duhet të përfundojnë sfidën në çdo stacion para se të shkojnë te tjetri. Stacionet duhen ndjekur sipas radhës, megjithatë grupet mund të nisin në stacione të ndryshme. Thesari i madh do të gjendet te klasa ku zhvillohet mësimi nga Bibla.

Planifikim shtesë: Në varësi të numrit të nxënësve do të përcaktosh nëse nxënësit do të ndahen në grupe apo do ta kryejnë aktivitetin të gjithë bashkë. Duhet të ketë katër ose pesë stacione. Sfidat e çdo stacioni duhen shkruar në një letër/karton dhe duhen shfaqur pranë stacionit.



Mjetet:

- Letër apo karton për çdo stacion, ku shkruhet "**Një rrugë**" – duhet të kenë edhe hapësirë bosh që të shënosh sfidën e çdo stacioni (burim i printueshëm)
- Mjetet e nevojshme për secilën sfidë
- "Thesari i madh" (mund të jetë një vendosje interesante perimesh si ajo që tregohet në foto; thesari do të gjendet te klasa e mësimit)

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Pas adhurimit, mblidhi të gjithë nxënësit në rreth.
2. Shpjegoju se në çdo stacion do t'u duhet të përfundojnë një sfidë "**Një rrugë**" – pra, ka vetëm një rrugë për ta përmbushur sfidën. Pasi sfida të jetë përfunduar si duhet, do të shkojnë te stacioni i radhës, ku do të përfundojnë një tjetër sfidë "**Një rrugë**". Synimi i tyre është të gjejnë thesarin e madh deri në fund të "Kohës së zbulimit", duke përfunduar të gjitha sfidat "**Një rrugë**".
3. A duket e thjeshtë ndjekja e këtyre sfidave? Mendojeni përsëri! Nëse nxënësit tundohen ta shmangin sfidën apo qoftë edhe të bëjnë kompromis me të, lejoji të diskutojnë dhe pastaj lejoji të bëjnë ç'të duan: t'i bien shkurt ose ta përfundojë siç duhet dhe të marrin thesarin e madh. Sjellja e tyre do të lidhet me mësimin.
4. Sfidoji vazhdimisht nxënësit të ndjekin udhëzimet e sfidës brenda një kufiri kohor, derisa të gjejnë thesarin e madh.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Shembuj sfidash:

- Sfida e hedhjeve pupthi: Të gjithë anëtarët e skuadrës duhet të bëjnë 20 hedhje pupthi. (Nxënësit më të rritur mund të zvarriten poshtë karrigeve, të ecin mbi një dërrasë,etj.)
- Sfida "Hula Hoop"[1] Skuadra duhet të formojë një rreth dhe të kapin duart me njëri-
  -tjetrin. Dy nga anëtarët do t'i kapin duart përmes një "hula hoop"-i. Me ndihmën e drejtuesit, kalojeni "hula hoop"-in nëpër rreth pa shkëputur duart nga njëri-tjetri. (Nxënësit më të rritur mund ta bëjnë dy herë këtë.)
- Sfida e çantave/qeskave me rërë: E gjithë skuadra duhet të qëndrojë në një vijë dhe, me radhë, duhet të hedhin qeskat në një kosh. Një drejtues duhet të qëndrojë pranë koshit, që t'ia kthejë qeskën personit në radhë për ta hedhur. Çdo person duhet të shënojë kosh.
- Sfida e litarit: Anëtarët e skuadrës duhet të kapin duart me njëri-tjetrit, duke formuar një rresht. Pa u shkëputur, duhet të kalojnë poshtë një litar, me radhë.
- Sfida e tunelit: Skuadra duhet të vendoset në rresht në fund të tunelit dhe të zvarriten përmes tij sa më shpejt të munden.
- Sfida e vargut biblik: Zgjidh tre nxënës që do të recitojnë një varg specifik ose vargun e tyre të preferuar.
- Sfida e zvarritjes: E gjithë skuadra duhet të vendoset në rresht dhe të zvarriten nga një vijë te një tjetër, pastaj të kthehen me kërcim te vija e nisjes.
- Sfida e Librave të Biblës: E gjithë skuadra duhet të thotë librat e Dhiatës së Re ose të Dhiatës së Vjetër.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – Lidhja e KZ-së me mësimin: A ishte thjeshtë apo e vështirë të ndiqnit sfidën "**Një rrugë**" gjatë "Kohës së zbulimit" sot? Përse po ose jo? A u tunduat në ndonjë moment të shmangnit sfidën ose të plotësonit vetëm një pjesë të saj, që të nxitonit për te stacioni i radhës? Kjo më kujton se si njerëzit e trajtojnë shpeshherë Fjalën e Perëndisë, Biblën. Disa njerëz mendojnë se duhet të ndjekin rrugën e Perëndisë vetëm në disa raste ose vetëm të dielave. Kjo nuk është e vërtetë; ne duhet të ndjekim rrugën e Perëndisë 100% të kohës, shtatë ditë të javës. Mirëpo, a është kjo e lehtë apo e vështirë? Përse? Sot do të mësojmë për disa djem të rinj që ndërmorën një rrezik dhe ndoqën rrugën e Perëndisë, 100% të kohës.

[1] "Hoola Hoop" është emri që përdoret për një rreth plastik që rrotullohet rreth belit.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Lutu: *Kur ta sfidosh njërin nga nxënësit që të ngrihet në këmbë për t'u lutur, pyete se në ç'situatë do të mund të lutej përpara njerëzve. (Një krizë në shkollë, në shtëpi, në mbrëmje, një rast kur Perëndia ka bekuar një grup njerëzish, etj.)*

Zbuloje: *Pyeti nëse Danieli është në Dhiatën e Re apo në Dhiatën e Vjetër. (Dh. V.) Sfidoji nxënësit të thotë librat e Dhiatës së Vjetër deri te libri i Danielit. Duke i përmendur librat çdo javë, nxënësit do të mësohen me to dhe me shqiptimin e tyre. Shkruaj Danieli 1:1-20 në tabelë dhe kërkoju nxënësve ta gjejnë te Bibla e tyre. Inkurajoji t'i marrin gjithmonë Biblat me vete. Përse? Qëllimi është që çdo nxënës të mësohet me Biblën e vet dhe ta lexojë me siguri kur është vetëm. Nxiti të përdorin edhe libërshenjuesen, në mënyrë që pasazhin ta lexojnë edhe në shtëpi.*

Kronologjia*: Qëllimi i kronologjisë është t'i sfidojë nxënësit ta shohin Biblën si një pamje të plotë e jo si histori individuale që nuk lidhen me njëra-tjetrën. Drejtohu te Danieli në kronologji.*

Prezantimi me mësimin nga Bibla: *Ndërsa bën përsëritjen, referoju kronologjisë.* Kush e kujton se cili ishte mbreti i parë i Izraelit? (Sauli) Kush erdhi pas tij? (Davidi) Si quhej i biri i Davidit, që u bë mbret? (Solomon)

Pas mbretit Solomon, mbretëria e Izraelit u nda në dysh: Izraeli (në veri) dhe Juda (në jug). Mbretërit e Izraelit ishin të këqij dhe nuk i ndoqën planet e Perëndisë. Disa nga mbretërit e Judës ishin të këqinj, disa të tjerë besnikë.

Për nxënësit më të rritur: Perëndia dërgoi profetë edhe në Izrael edhe në Judë, duke i paralajmëruar e duke u thënë të pendoheshin (të ktheheshin nga rrugët mëkatare dhe të bënin atë që ishte e drejtë). Nëse ata nuk pendoheshin, Perëndia premtoi se do të ndëshkoheshin për mëkatin e tyre. Populli i Izraelit vazhdoi të tregonte mosbindje ndaj Perëndisë, prandaj Perëndia lejoi që mbretëria veriore të pushtohej e robërohej nga Asiria (kjo ndodhi në vitin 722 para Krishtit).

A ju kujtohet që mësuam për mbretin Josia? (Ai u bë mbret i Judës kur ishte tetë vjeç, shkatërroi altarët dhe idhujt që u kishin ndërtuar perëndive të rreme, riparoi tempullin e Perëndisë dhe gjeti Librin e Ligjit) Mbreti Josia ishte një nga mbretërit e Judës që i qëndroi besnik Perëndisë dhe e udhëhoqi popullin që të adhuronte vetëm Perëndinë.

Pas mbretit Josia, populli i mbretërisë së Judës iu kthye rrugëve të mbrapshta. Ata nuk e adhuruan më Perëndinë e vërtetë. Perëndia kishte një plan shumë të mirë për popullin e Tij. Perëndia donte që ata të ishin të ndarë veçmas (të shenjtë) dhe Ai të ishte përparësia kryesore në jetën e tyre. Megjithatë, populli zgjodhi dëshirat e veta dhe jo rrugët e Perëndisë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

A ju kujtohet premtimi që Perëndia i bëri mbretit Josia? Ai i tha Josias se pasi të vdiste, populli i Judës do merrte ndëshkimin për mëkatin e vet.

Ashtu siç kishte premtuar Perëndia, më në fund erdhi koha që Juda të ndëshkohej. Perëndia lejoi që mbreti Nebukadnetsar me ushtrinë e tij të pushtonte Judën, të shkatërronte qytetin e Jerusalemit dhe tempullin e Perëndisë, si dhe të robëronte e skllavëronte shumë nga njerëzit e Judës në Babiloni (kjo ndodhi në vitin 586 para Krishtit).

Gjithçka ishte pjesë e planit të Perëndisë dhe sot do të shohim se si Perëndia përdori katër djem të rinj izraelitë për t'i drejtuar njerëzit tek Ai. Danieli ishte një nga njerëzit e robëruar në Babiloni. Le të mësojmë për të dhe tre shokët e tij.

Përvijimi i Shkrimit: Danieli 1:1-20

Mbreti Nebukadnetsar i merr robërit nga Jerusalemi në Babiloni

***Parafrazim i Danielit 1:1-3, 6-7**:*

Disa nga izraelitët që mbreti Nebukandestar mori nga Jerusalemi në Babiloni ishin nga familje të veçanta (mbretërore ose fisnike). Danieli, Hananiahu, Mishaeli dhe Azaria. Kreu i eunukëve ua ndryshoi emrat në Beltshatsar, Shadrak, Meshak dhe Abednego. Le të dëgjojmë pak për këta katër djem dhe çfarë kërkoi mbreti Nebukadnetsar prej tyre. Ata ishin...

Mbreti Nebukadnetsar donte që Danieli dhe tre shokët e tij të shërbenin në pallatin e tij

Lexo Danieli 1:4

Shënim: Lexoje me ngadalë përshkrimin e këtyre tre djemve të rinj, që nxënësit të kenë kohë të kuptojnë se si ishin ata.

Përmbledhje: Danieli, Shedraku, Meshaku dhe Abednego ishin të pashëm dhe të zgjuar. Mbreti Nebukadnetsar donte që ata të trajnoheshin për të shërbyer në pallatin e tij. A e gjeni dot se çfarë tjetër donte prej tyre mbreti Nebukadnetsar?

Mbreti Nebukadnetsar u cakton katër djemve ushqimet e mbretit

Lexo Danieli 1:5

Përmbledhje: Mbreti donte që Danieli dhe shokët e tij të hanin e të pinin nga tavolina e tij. Mirëpo, kishte një problem të madh me ushqimin dhe pijet e mbretit. Cili ishte problemi? Kujtoni që Perëndia donte që izraelitët të ishin ndryshe nga kombet përreth tyre. Një nga ndryshimet ishte lloji i ushqimeve që hanin. Nëse Danieli, Shadraku, Meshaku dhe Abednego hanin nga ushqimi i mbretit dhe pinin nga vera e tij, do të tregonin mosbindje ndaj Perëndisë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përveç kësaj, ushqimi i mbretit mund të ishte ofrim për një idhull apo perëndi të rreme. Le të shohim nëse këta katër djem qëndruan të fortë dhe iu bindën Perëndisë.

Danieli qëndron i fortë

Lexo Danieli 1:8

Përmbledhje: Danieli vërtet dëshironte të jetonte në bindje ndaj Perëndisë. Ai kërkoi leje të mos hante nga ushqimi i mbretit e të mos pinte nga vera e tij. A nuk është e mrekullueshme që Danieli donte të ishte besnik e të jetonte siç i pëlqente Perëndisë? Ai mund të ishte dorëzuar dhe të hante ushqimin para tij, mirëpo u tregua i guximshëm dhe ndoqi 100% rrugën e Perëndisë.

Po ti? A të ka nxitur ndokush të mëkatosh? Cilët mund të jenë disa shembuj? *Po të jetë e nevojshme, ndihmoji me disa shembuj të përshtatshëm për moshën: të shikosh diçka të papërshtatshme në internet, të shohësh një film jo të mirë, të luash lojëra të papërshtatshme, të dëgjosh këngë që përmendin gjëra të cilat nuk i pëlqejnë Perëndisë, të jesh i pasjellshëm ose të bullizosh dikë, të mos u bindesh prindërve, etj.*

A ke zgjedhur të jetosh siç i pëlqen Perëndisë, apo dorëzohesh dhe bën gjëra që nuk i pëlqejnë Perëndisë? Kujto se Perëndia do më të mirën për ty. Ai të do dhe dëshiron të të mbrojë nga gjërat që nuk janë të mira për ty.

Le të shohim se ç'ndodh kur Danieli kërkon leje për të mos ngrënë nga ushqimet e mbretit.

Perëndia po kujdeset për Danielin

Lexo Danieli 1:9

Përmbledhje: A duket se Perëndia po kujdeset për Danielin? (Po!) Ai ishte me Danielin dhe bëri që gjithçka të bashkëvepronte për të mirë. Kur zgjedh të jetosh për t'i pëlqyer Perëndisë, Ai vetë është me ty! Ai e bën gjithçka të bashkëveprojë për të mirën tënde.

Mirëpo, pyes veten nëse kreu i eunukëve e detyroi Danielin dhe shokët e tij të hanin ushqimin e mbretit. Le ta shohim.

Kreu i eunukëve ka frikë nga mbreti Nebukadnetsar

Lexo edhe njëherë Danielin 1:9 dhe Danielin 1:10

Përmbledhje: Kreu i eunukëve kishte frikë se, po të mos i hante ushqimet e mbretit, Danieli nuk do të ishte i shëndetshëm dhe mbreti do ta fajësonte atë, madje mund t'i priste dhe kokën. Mirëpo Perëndia i kishte dhënë urtësi Danielit. Le të shohim se si e përdori ai urtësinë e Perëndisë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Danieli kërkon të bëhet një test

Lexo Danieli 1:11-13

Përmbledhje: Danieli bëri një marrëveshje me kreun e eunukëve, që ta testonte atë dhe shokët e tij. Kreu do t'i lejonte të hanin vetëm perime dhe të pinin vetëm ujë për dhjetë ditë, pastaj do të shihte gjendjen e tyre. Ide shumë e zgjuar, apo jo? A mendoni se kreu ra dakord me testin? Le ta zbulojmë.

Kreu bie dakord të testojë Danielin dhe shokët e tij

Lexo Danieli 1:14

Përmbledhje: Kreu ra dakord me testin! Çfarë mendoni se ndodhi?

Ata e kaluan testin

Lexo Danieli 1:15-16

Përmbledhje: Danieli, Shadraku, Meshaku dhe Abednego e kaluan testin. Ata ishin madje më të shëndetshëm e më të ushqyer se sa të rinjtë që po hanin ushqimin e mbretit. Kështu, Danielit dhe shokëve të tij iu lejua të vazhdonin të hanin perimet dhe të pinin vetëm ujë.

Mos harroni, Perëndia do gjithmonë më të mirën për ju. Cilat janë disa nga gjërat që Perëndia nuk i do për ne? *Kërkoju nxënësve të japin shembuj dhe ndihmoji sipas nevojës: gënjeshtra, kopjimi, vjedhja, zënkat, tallja, etj.*

Për nxënësit më të rritur: *Shembuj: alkooli, zgjedhjet e gabuara në internet, drogërat, programet e këqija televizive, filmat apo videolojërat me demonë apo vrasje, etj.*

Tani mendoni për gjërat që duhet të bëni që të jetoni një jetë që i pëlqen Perëndisë. Mendoni frytin e Frymës. Duhet të tregoni dashuri, gëzim, paqe, durim, mirësi, mirëdashje, zemërbutësi, besim dhe vetëkontroll. Duhet të nderoni e t'u bindeni prindërve, të mbani fjalën e dhënë, të flisni vazhdimisht me Perëndinë përmes lutjes, të lexoni Biblën, të doni Perëndinë dhe të tjerët, etj.

A e dini se Perëndia na bekon kur jetojmë siç i pëlqen Atij? Le të shohim se si e bekoi Danielin, Shadrakun, Meshakun dhe Abednegon.

Perëndia bekon Danielin dhe shokët e tij

Lexo Danieli 1:17

Përmbledhje: Ua! Perëndia vërtet i bekoi! Ai u dha gjithçka për të cilën kishin nevojë që të mund t'i shërbenin mirë mbretit Nebukadnetsar. Danielit madje i dha dhuntinë e interpretimit të ëndrrave dhe vizioneve. A do t'ju pëlqente edhe juve ta kishit këtë dhunti?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Ashtu si Danieli dhe shokët e tij iu bindën Perëndisë dhe jetuan siç i pëlqente Atij, edhe ne duhet të zgjedhim sot ta jetojmë jetën për Perëndinë! Le të shohim se çfarë ndodhi kur Danieli, Shadraku, Meshaku dhe Abednego shkuan sërish te mbreti Nebukadnetsar.

Danieli dhe shokët e tij janë dhjetë herë më mirë se të gjithë magjistarët dhe astrologët e mbretit!

Lexo Danieli 1:18-20

Përmbledhje: Mbreti Nebukadnetsar kuptoi se Perëndia e kishte bërë Danielin dhe shokët e tij dhjetë herë më të mençur sesa magjistarët dhe astrologët e mbretit! Mendoni pak se sa të urtë mund të bëheni nëse përqendroheni që të jetoni sipas Fjalës së Perëndisë!

Përfundimi

Jeta në Babiloni nuk duhet të ketë qenë e lehtë për Danielin, Shadrakun, Meshakun dhe Abednegon. Mirëpo, ata iu bindën Perëndisë edhe pse të tjerët u thanë të bënin të kundërtën. Perëndia i bekoi dhe u dha gjithçka që u duhej për të qenë shërbëtorë të mirë për mbretin Nebukadnetsar. Mirëpo, historia nuk përfundon këtu. Ejani javën e ardhshme për të zbuluar se ç'ndodh në aventurën e tyre në Babiloni!

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

E ke gjithmonë mundësinë e zgjedhjes. Mund të jetosh siç u pëlqen njerëzve në botë, ose mund të jetosh siç i pëlqen Perëndisë. Çfarë do të zgjedhësh? A do të zgjedhësh rrugën e Perëndisë, që të ndihesh besnik dhe Ai të të bekojë? Apo do të zgjedhësh rrugën e botës e pastaj në fund të ndiesh keqardhje? Duhet të zgjedhësh çdo ditë të ndjekësh e t'i bindesh Perëndisë. Mirëpo, cila është gjëja e parë që duhet të bëjmë për të jetuar siç i pëlqen Perëndisë? Le të themi vargun nga "Mendo si duhet". *Kërkoju të recitojnë Gjonin 14:6*. Gjëja e parë që duhet të bëjmë për të jetuar siç i pëlqen Perëndisë është të besojmë në Birin e Tij, Jezusin, që të na shpëtojë nga mëkati dhe ta bëjmë Atë udhëheqësin e jetës sonë. A e keni bërë këtë? Nëse po, atëherë Perëndia ju ka dhënë Frymën e Shenjtë që jeton në ju dhe ju ndihmon t'i bindeni. Nëse nuk jeni lutur kurrë më parë dhe nuk i keni kërkuar Jezusit t'ju falë mëkatin e të bëhet Udhëheqësi i jetës suaj, a do të donit të mësoni se si ta bëni tani? *Mundësi për të shpallur Ungjillin përmes "Librit pa fjalë" dhe për të bërë ftesë për shpëtim.*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Kush ishte Danieli dhe përse gjendej në Babiloni? (Danieli ishte një izraelit që vinte nga një familje mbretërore ose fisnike, i cili ishte marrë si shërbëtor në Babiloni nga mbreti Nebukadnetsar)
2. Çfarë donte mbreti Nebukadnetsar që të bënin Danieli, Shadraku, Meshaku dhe Abednego? (Ai donte që ata të hanin e të pinin nga tavolina e mbreti, si dhe donte t'i trajnonte që t'i shërbenin atij)
3. Përse Danieli dhe shokët e tij nuk donin të hanin nga ushqimi i mbretit? (Ata donin të hanin nga ushqimet që u kishte thënë Perëndia, sidomos për faktin se ushqimet e mbretit mund të ishin flijime për idhuj apo perëndi të rreme)
4. Çfarë marrëveshjeje bëri Danieli me kreun e eunukëve të mbretit? (Ai do t'i linte të hanin perime dhe të pinin vetëm ujë për dhjetë ditë, pastaj do t'i testonte duke i krahasuar me të rinjtë e tjerë që hanin nga ushqimet e mbretit)
5. Çfarë i dha Perëndia Danielit, Shadrakut, Meshakut dhe Abednegos? (Ai u dha mençuri dhe njohuri; Danieli interpretonte ëndrrat dhe vizionet)
6. Si dukeshin Danieli dhe shokët e tij pas dhjetë ditëve? (Ata dukeshin më të shëndetshëm dhe më mirë se të rinjtë që kishin ngrënë nga ushqimi i mbretit)
7. Çfarë mendimi pati mbreti Nebukadnetsar për Danielin, Shadrakun, Meshakun dhe Abednegon kur foli me ta? (Ata ishin dhjetë herë më të mençur e me më shumë njohuri se sa të tjerët në Babiloni)
8. Përse Danieli, Shadraku, Meshaku dhe Abednego ishin më mirë se magjistarët dhe astrologët e mbretit? (Sepse jetuan siç i pëlqente Perëndisë)
9. A do ta jetosh ti jetën siç i pëlqen Perëndisë?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 7
Danieli 2

Kupto si duhet:	Danieli i kërkon Perëndisë urtësi për të interpretuar ëndrrën e Nebukadnetsarit.
Mendo si duhet:	"Por në qoftë se ndonjërit nga ju i mungon urtësia, le të kërkojë nga Perëndia." Jakobi 1:5a
Vepro si duhet:	Unë do t'i kërkoj urtësi Perëndisë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem fitimtar kur kam urtësinë e Perëndisë.

PËRGATITU!

Ndërsa studion Danielin 2 duke u përgatitur për mësimin e javës, mendo për ndryshimin midis urtësisë dhe inteligjencës. Mund të jemi inteligjentë, por të na mungojë urtësia. Të urtë bëhemi duke kaluar kohë me Perëndinë dhe me Fjalën e Tij. Le të lutemi që ky mësim t'i ndihmojë fëmijët të kuptojnë se sa e rëndësishme është të kërkojmë urtësinë e Perëndisë.

Lutu: Kërkoji Perëndisë të vendosë në zemrën e fëmijëve dëshirën për të kërkuar urtësinë e Tij gjatë gjithë jetës. Lutu gjithashtu që prindërit e tyre t'i drejtojnë te urtësia e vërtetë e jo te gjërat e kësaj bote.

Lexo: Danieli 2

Kupto si duhet: Danieli i kërkon urtësi Perëndisë për të interpretuar ëndrrën e Nebukadnetsarit
Kur mbreti Nebukadnetsar pa një ëndërr shqetësuese, ai thirri "burrat e urtë" dhe i sfidoi t'i shpjegonin kuptimin e ëndrrës. Ai u premtoi dhurata, shpërblime dhe nderime të mëdha kujtdo që do t'ia tregonte. Kur i thanë se askush nuk mund të bënte atë që kishte kërkuar, Nebukadnetsari urdhëroi ekzekutimin e të gjithë burrave të urtë në Babiloni. Kur e dëgjuan këtë, Danieli dhe tre shokët e tij kërkuan urtësinë e Perëndisë, që Danieli të mund të interpretonte ëndrrën dhe që burrat e urtë të mos vriteshin. Kur Perëndia ia plotësoi kërkesën, Danieli interpetoi ëndrrën dhe me përulësi ia dha të gjitha meritat Perëndisë. Mbreti Nebukadnetsar pranoi Perëndinë e Danielit dhe e shpalli Perëndinë e perëndive, Zotin e mbretërve dhe zbuluesin e sekreteve. Danieli dhe miqtë e tij morën të gjitha gjërat që mbreti kishte premtuar. Ngjarja e Danielit dhe mbretit Nebukadnetsar na mëson rëndësinë e <u>të kërkuarit të urtësisë nga Perëndia</u>.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënime për mësuesin kryesor:

- Kur shpjegon një mësim nga Bibla, sigurohu të kujtosh se, si me çdo histori, duhet të kesh parasysh këto katër pjesë përbërëse: prezantimin, përvijimin e ngjarjes, pikën kulmore dhe përfundimin.
- Përkufizimi i urtësisë: të përdorësh të vërtetën e Fjalës së Perëndisë për të kuptuar botën dhe për të marrë vendimet e duhura.
- Cila është e kundërta e kërkimit të urtësisë nga Perëndia? Të besosh te aftësitë dhe forcat e tua për të marrë vendimet e duhura. Qëllimi ynë për këtë javë është t'i sfidojmë nxënësit të pranojnë nevojën e tyre për urtësinë e Perëndisë dhe t'ia kërkojnë atë personalisht Atij, për të marrë vendimet e duhura.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla: Para se të fillojë mësimi, bëj gati nga një pjatë plastike për çdo nxënës te të cilat të vizatosh shtatë pika në distancë të barabartë nga njëra-tjetra nëpër cepat e pjatës dhe shkruaj: "Urtësia e vërtetë! – Jakobi 1:5a" në mes të pjatës. Ndërsa shpjegon mësimin, kërkoju nxënësve t'i shkruajnë idetë kryesore ose të bëjnë figura të thjeshta për secilën pjesë të mësimit te secila prej pikave, në drejtimin orar. Ti mund ta bësh shembullin në tabelë. Në fund të mësimit, kërkoju nxënësve të shpjegojnë se çfarë kanë shkruar/vizatuar. Kujtoju se duhet të kërkojnë urtësi të vërtetë, çdo ditë, në çdo situatë.

NISU!

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: A ke urtësi?

Qëllimi: Të zbulojmë rëndësinë e të kërkuarit **urtësi**.

Aktiviteti: Hapësirë e madhe

Mjetet:

- Pishina të vogla ose legenë të mëdhenj (aty do të hidhini solucionin e flluskave)
- Receta për fluska gjigante dhe mjetet:
  - litra ujë të NXEHTË (shumë e rëndësishme);
  - ½ luge e vogël xhel;
  - 1 pako lubrifikues mjekësor;
  - ¼ gotë me glicerinë (99.5%).

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përzieji objektet e mësipërme me përzierës boje që të arrini përmbajtjen e duhur.
    - Pastaj shto të mëposhtmet për të krijuar shkumë:
    - 2 gota me detergjent enësh;
    - ½ gotë me detergjent më të fortë për tenxhere.

- Shkopinj të mëdhenj për të bërë flluska (një për çdo tetë nxënës; shkopinjtë duhet të jenë të njëjtë me atë që ka eksperti)
- Një "Ekspert flluskash" (kërkoja dikujt që do ta bëjë aktivitetin argëtues dhe që mund të praktikojë paraprakisht bërjen e flluskave që të jetë në gjendje të formojë flluska gjigande; ky person duhet të jetë eksperti plot urtësi)
- Ju rekomandojmë që eksperti të shohë një video online, që të ketë edhe njohuri për bërjen e flluskave. Ja një video: https://www.youtube.com/watch?v=VXsPqUFsArM
- Përparëse laboratori për ekspertin, që të duket si një shkencëtar që po kryen një eksperimet.

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndërkohë që nxënësit dalin jashtë për aktivitetin e KZ-së, eksperti i flluskave duhet të jetë duke formuar flluska gjigante.
2. Kërkoju nxënësve të ulen dhe të shohin formimin e flluskave gjigante. Çelësi është që eksperti i flluskave të bjerë në sy e të tregohet i **urtë**.
3. Eksperti i flluskave: Pyeti nxënësit nëse duan të mësojnë se si të bëjnë flluska. Ndërsa nxënësit bërtasin "Po!", thuaju se po tregohen të **urtë** që po kërkojnë këshilla nga një ekspert.
4. Kërkoju nxënësve që ta dëgjojnë me kujdes ekspertin e flluskave, që të mund të marrin nga njohuria që ai ka marrë nëpër ditë/javë/muaj praktike.
5. Pasi të shpjegosh informacionin, thekso se sa i **urtë** është ky person mbi temën e flluskave. Ai mund të përgatisë solucionin, të kuptojë rëndësinë e lagështirës së ajrit, problematikat me erën, di se si të përdorë shkopinjtë e flluskave, etj.
6. **Eksperti i flluskave**: Prano se Perëndia të ka dhënë aftësinë për të studiuar flluskat dhe se Ai ka siguruar mjetet dhe motin për bërjen e flluskave.
7. Kërkoju nxënësve të ndahen në grupe të vogla që të përpiqen të zbatojnë atë që mësuan nga eksperti i flluskave.
8. Rreshtoji nxënësit dhe kalo me radhë tek ata për t'i ndihmuar. Ata që presin, duhet të shohin ata që po bëjnë flluskat e mëdha.
9. Kujtoju t'i kërkojnë ndihmë ekspertit të flluskave nëse u duhet **urtësi** për diçka.
10. Sfidoji të përpiqen t'i bëjnë flluskat sa më të mëdha.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Alternativa për aktivitet brenda:
Sill një "ekspert instrumenti" që di të luajë shumë mirë në një instrument. Kërkoji ekspertit të demonstrojë aftësitë e veta dhe t'u tregojë pak nxënësve se sa kohë ka që luan atë instrument dhe sa praktikë i është dashur për t'u bërë ekspert. Eksperti duhet të tregojë se Perëndia ia dha aftësinë për të luajtur instrumentin. Pastaj eksperti mund t'i japë mundësinë nxënësve të luajnë diçka të shkurtër me udhëzimet e tij të **urta**. Nxënësit duhet ta ndjekin me përpikmëri për të luajtur melodinë e bukur.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesi kryesor – Lidhja e KZ-së me mësimin: Cili është përkufizmi i **urtësisë**? (Të përdorësh të vërtetën e Fjalës së Perëndisë për të kuptuar botën dhe për të marrë vendimet e duhura) A e kishte **urtësinë** e duhur eksperti për të bërë flluskat (apo për të luajtur instrumentin)? Kur kishit probleme ose pyetje, a shkuat te eksperti për ndihmë? Përse? Ishte shumë e rëndësishme të tregoheshit të përulur dhe ta dëgjonit ekspertin. Hapi i dytë ishte të zbatonit atë që ju thoshte eksperti.

Te kush drejtoheni kur ju duhet **urtësi** e vërtetë... e kam fjalën për **urtësinë** më cilësore në botë? Më lejoni t'ju jap një ndihmë (*trego vargun në tabelë*): Jakobi 1:5a: "Por në qoftë se ndonjërit nga ju i mungon urtësia, le të kërkojë nga Perëndia." Ashtu siç u drejtuat tek eksperti i flluskave (apo i instrumentit), duhet të drejtoheni te Perëndia për të marrë **urtësi** në vendimet e vogla dhe ato të mëdha.

Lutu: *Jepi mundësinë njërit prej nxënësve të nisë mësimin me lutje. Para se nxënësit të fillojnë të luten, pyeti: "Çfarë duhet të bëni kur dikush lutet?" Shumica do të thonë: "të mbyllim sytë, të bashkojmë duart dhe të ulim kokën." Kjo është një përgjigje shumë e mirë, por i mungon shpjegimi i "pse" i bëjmë këto gjëra – që të përqendrohemi te Perëndia. Kur një person lutet, po e drejton të gjithë grupin në një lutje të përbashkët. Fjala "Amen" në fund të lutjes do të thotë "Unë bie dakord!". Ti po bie dakord me atë që ka thënë personi që sapo u lut.*

Zbuloje: *Sfidoji nxënësit të thonë librat e Dhiatës së Vjetër deri te Danieli. Duke i recituar ato çdo javë, po përsërit me nxënësit që marrin pjesë rregullisht. Ndërsa nxënësve të rinj po u mëson se si shqiptohen librat. Kërkoju nxënësve të gjejnë Danielin 2 te Biblat e tyre.*

Kronologjia: *Drejtoji te kronologjia dhe kujtoju se jemi në Dhiatën e Vjetër dhe se po studiojmë Danielin.*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Javën e kaluar mësuam për Danielin, Shadrakun, Meshakun dhe Abednegon. Ata ishin izraelitë nga Juda. Edhe pse Danieli dhe miqtë e tij ishin marrë robër në Babiloni, ata qëndruan të fortë dhe jetuan sipas pëlqimit të Perëndisë. Në vend që të hanin ushqimin e mbretit Nebukadnetsar ata hanin perime dhe pinin ujë. Perëndia i bekoi dhe u dha gjithçka që kishin nevojë për të qenë shërbëtorë të mirë për mbretin Nebukadnetsar. A ju kujtohet se sa më mirë dukeshin ata se të gjithë burrat e "urtë" të mbretit Nebukadnetsar? (Dhjetë herë më mirë!) Perëndia ishte me Danielin, Shadrakun, Meshakun dhe Abednegon dhe sot do të shohim se sa nevojë kishin për Të!

Përvijimi i Shkrimit: Danieli 2

Mbreti Nebukadnetsar pa një ëndërr dhe donte ta kuptonte

Parafrazim i Danielit 2:1-13:

A jeni zgjuar ndonjëherë nga gjumi dhe ju është kujtuar një ëndërr që keni parë? A e keni pyetur ndonjëherë veten se çfarë kuptimi kishte?

Një natë mbreti Nebukadnetsar pa një ëndërr. Ëndrra e shqetësoi mbretin aq shumë, saqë donte ta kuptonte. Ai thirri burrat që i mbante për të urtë. Ai u kërkoi t'i tregonin se ç'kishte parë dhe ta interpretonin. Të interpretosh do të thotë të japësh kuptimin. Përse donte që ata t'i tregonin edhe ëndrrën, edhe kuptimin? A nuk është e pamundur që dikush ta dijë se çfarë ke parë në ëndërr nëse nuk ia tregon? Mbreti Nebukadnetsar e dinte që, nëse dikush do të mund t'i tregonte ëndrrën, do t'i besonte edhe për shpjegimin e saktë të saj.

Tani vjen pjesa e frikshme. Ai u tha atyre se, po të mos ia tregonin ëndrrën e të mos e interpretonin, ai do t'i priste në copa dhe do të shkatërronte shtëpitë e tyre! Si mendoni se u ndien ata burra? Duhet të kenë qenë të tmerruar! Burrat i thanë mbretit se askush nuk do të mund ta shpjegonte ëndrrën përveç perëndive! Kjo e zemëroi aq shumë mbretin, saqë urdhëroi vrasjen e gjithë të diturve në Babiloni. E po, gjejeni pak se ç'ndodhi... Këtu përfshihet Danieli, Shadraku, Meshaku dhe Abednego!

Danieli kërkon ndihmën e Perëndisë

Parafrazim i Danielit 2:14-18:

Sapo Danieli zbuloi se mbreti Nebukadnetsar kishte urdhëruar vrasjen e të gjithë të diturve, shkoi te mbreti dhe i kërkoi atij pak kohë, që të kuptonte dhe të interpretonte ëndrrën. Pastaj, Danieli u kthye te miqtë e tij dhe së bashku i kërkuan ndihmë Perëndisë për të marrë urtësi për interpretimin e ëndrrës, që të mos vdisnin.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

A e dini se çfarë është urtësia? Mendoni edhe njëherë për aktivitetin e "Kohës së Zbulimit". Eksperti i flluskave përdori njohurinë që kishte për të bërë flluska me sapun, na tregoi se si t'i bënim flluskat gjigante dhe kështu ia dolëm.

Urtësi do të thotë: "Të përdorësh të vërtetën e Fjalës së Perëndisë për të kuptuar botën dhe për të marrë vendimet e duhura." Kush është i vetmi që mund të të japë urtësi për të marrë vendimet e duhura në jetën e përditshme? (Perëndia)

Shënim për mësuesin kryesor: Nxënësit mund të thonë edhe "prindërit, mësuesit", etj. Dhe është e vërtetë se Perëndia mund të japë urtësi edhe përmes tyre. E rëndësishme është të theksohet se çdo urtësi vjen nga Perëndia.

A të kujtohet ndonjë rast kur ke qenë në telashe? A ke kërkuar ndihmë nga Perëndia? A i kërkon ndihmë Perëndisë kur ke probleme apo kur të duhet të marrësh vendime? Le të themi së bashku vargun nga "Mendo si duhet". *Recitoni Jakobin 1:5a: "Por në qoftë se ndonjërit nga ju i mungon urtësia, le të kërkojë nga Perëndia." Jep një shembull të shkurtër personal të një rasti kur ke kërkuar urtësi nga Perëndia.* A mendoni se Perëndia e ndihmoi Danielin dhe miqtë e tij? Le ta shohim.

<u>Danieli lavdëron Perëndinë që i dha urtësi</u>

Lexo Danieli 2:19-23

Përmbledhje: A nuk është i mrekullueshëm Perëndia ynë? Ai i dha Danielit urtësi dhe i tregoi se çfarë kishte parë në ëndërr mbreti Nebukadnetsar dhe çfarë kuptimi kishte ëndrra. Tani Danieli mund t'ia tregonte ëndrrën mbretit dhe ta interpretonte, kështu ai dhe miqtë e tij nuk do të vdisnin.

<u>Danieli tregon dhe interpreton ëndrrën, duke ia dhënë të gjithë meritat Perëndisë</u>

Lexo Danieli 2:24-28

Përmbledhje: Për kë tha Danieli se ishte i vetmi që mund të shfaqte misterin e ëndrrës? (Për Perëndinë!)

Kur bën diçka të mençur si Danieli, a e merr meritën për vete apo ia jep Perëndisë? A i mori meritat për vete eksperti ynë apo ia dha Perëndisë? Duhet të jemi gjithmonë të përulur dhe t'ia japim meritat Perëndisë, sepse vetë nuk bëjmë dot asgjë të mirë. Urtësia jonë vjen prej Tij. Ashtu siç nuk i merrnim dot meritat për vete as në aktivitetin e "Kohës së zbulimit". Ne morëm urtësi nga eksperti për të bërë flluskat apo për të luajtur në instrument, dhe vepruam pikërisht siç na u tha.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Danieli i tha mbretit Nebukadnetsar se Perëndia donte që mbreti ta kuptonte ëndrrën. Le të shohim se cili ishte kuptimi i saj.

Ëndrra parashikon se ç'do të ndodhë në të ardhmen

Parafrazim i Danielit 2:29-45:

Ëndrra e mbretit Nebukadnetsar tregonte se ç'do të ndodhte në të ardhmen. Një mbretëri më e dobët (perandoria medo-persiane) do të vinte pas Babilonisë. Pastaj një tjetër më e dobët (Greqia) do të vinte pas saj. Më pas, edhe një më e dobët do të vinte (romake). Asnjëra prej tyre nuk do të zgjaste. Në fund, do të vinte një mbretëri e cila nuk do të shkatërrohej **kurrë**. Ajo do të kishte sundim të përjetshëm. Do të flasim më tepër për atë mbretëri shumë shpejt.

Çfarë mendoni se bëri mbreti Nebukadnetsar pasi Danieli i shpjegoi ëndrrën? Le ta shohim.

Mbreti Nebukadnetsar lavdëron Perëndinë

Lexo Danieli 2:46-47

Përmbledhje: Çfarë tha mbreti Nebukadnetsar për Perëndinë? (Ai është Perëndia i perëndive, Zoti i mbretërve dhe Zbuluesi i sekreteve) Mbreti Nebukadnetsar kuptoi se urtësia e Danielit vinte nga Perëndia! Kjo nuk do të thoshte se mbreti e dinte se Perëndia ishte i vetmi i vërtetë, por besonte se Perëndia ishte më i miri ndër perënditë. Gjejeni pak se ç'bëri mbreti Nebukadnetsar pas kësaj?

Mbreti Nebukadnetsar shpërblen Danielin, Shadrakun, Meshakun dhe Abednegon

Lexo Danieli 2:48-49

Përmbledhje: A nuk është e mrekullueshme? Në vend që ta vriste Danielin dhe tre shokët e tij, mbreti i shpërbleu. E gjitha kjo për shkak se Danieli ishte i guximshëm dhe kërkoi urtësi nga Perëndia.

Përfundimi

Kur Danieli dhe miqtë e tij ishin në telashe, a kërkuan urtësinë e Perëndisë apo u mbështetën në njohuritë dhe idetë e tyre? Perëndia i dha Danielit urtësinë për të kuptuar dhe interpretuar ëndrrën e mbretit, dhe Danieli ia dha Perëndisë të gjithë meritat. Mbreti Nebukadnetsar kuptoi se Perëndia i Danielit ishte më i miri dhe e lavdëroi. Në vend që të vriteshin, Danieli dhe tre shokët e tij u shpërblyen.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

“Vepro si duhet” dhe “Ndihu si duhet”

Çfarë bën kur gjendesh në situatë të vështirë? A përpiqesh ta zgjidhësh vetë, a shkon në një cep dhe qan, apo kujtohesh t’i kërkosh ndihmë dhe urtësi Perëndisë? Çfarë na thotë Perëndia të bëjmë te vargu nga “Mendo si duhet”, Jakobi 1:5a? Le ta themi tani së bashku. *Recito Jakobin 1:5a: “Në qoftë se ndonjërit nga ju i mungon urtësia, le ta kërkojë nga Perëndia.”* Kur Perëndia të ndihmon, a i merr meritat për vete apo ia jep Perëndisë me përulësi, siç bëri Danieli? Kur ke nevojë për urtësi, kujto t’ia kërkosh Perëndisë. Pastaj, ndaje atë urtësi me të tjerët.

Edhe diçka tjetër. A ju kujtohet kuptimi i ëndrrës së mbretit Nebukadnetsar? Do të vinin tri mbretëri të dobëta pas tij, por në fund do të vinte një mbretëri e fundit që do të zgjasë përgjithmonë! A e njihni Mbretin e Nbretërisë që do të zgjasë gjithmonë? (Është Jezusi!) A i përkisni Mbretërisë së Tij? Nëse keni besuar në Jezusin për shpëtim nga mëkati dhe e keni bërë Atë udhëheqësin e jetës suaj, atëherë i përkisni Mbretërisë së Tij. Nëse nuk jeni lutur kurrë e nuk keni besuar se Jezusi ju shpëton nga mëkati, a do të donit ta bënit këtë gjë sot? *Mundësi për të shpallur Ungjillin përmes “Librit pa fjalë” dhe për të bërë ftesë për shpëtim.*

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t’i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Çfarë donte mbreti Nebukadnetsar që të bënin burrat e tij të “urtë”? (T’i tregonin ëndrrën dhe t’ia interpretonin)
2. Përse donte mbreti Nebukadnetsar që t’ia tregonin ëndrrën para se t’ia interpretonin? (Që të sigurohej se po e interpetonin vërtet)
3. Çfarë do të bënte mbreti në rast se askush nuk do të mund t’ia tregonte dhe interpretonte ëndrrën? (Do t’i vriste të gjithë të diturit, përfshirë Danielin, Shadrakun, Meshakun dhe Abednegon)
4. Kur Danielit iu desh të tregonte dhe interpretonte ëndrrën, çfarë bëri bashkë me shokët e tij? (Kërkuan urtësi nga Perëndia)
5. Çfarë bëri Perëndia? (Perëndia i dha Danielit urtësinë për ta treguar dhe interpretuar ëndrrën e mbretit Nebukadnetsar)
6. Për kë tha Danieli se ishte i vetmi që mund të zbulonte sekretet e ëndrrës? (Për Perëndinë)
7. Çfarë tha mbreti Nebukadnetsar për Perëndinë pasi Danieli i tregoi dhe i interpretoi ëndrrën? (Perëndia i Danielit është Perëndia i perëndive, Zoti i mbretërve dhe Zbuluesi i sekreteve)
8. Çfarë ndodhi me Danieli dhe shokët e tij? (Mbreti u dha atyre shpërblimet e premtuara)
9. A do t’i kërkosh ti urtësi Perëndisë?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 8
Danieli 3

Kupto si duhet:	Shadraku, Meshaku dhe Abednego hidhen në furrën e ndezur.
Mendo si duhet:	"A nuk të urdhërova unë? Ji i fortë dhe trim; mos ki frikë dhe mos u thyej, sepse ZOTI, Perëndia yt, është me ty kudo që të shkosh." Jozueu 1:9 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do t'i besoj fuqisë së Perëndisë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i guximshëm dhe në paqe kur besoj në fuqinë e Perëndisë.

PËRGATITU!

A e ke dëshmuar fuqinë e Perëndisë në jetën tënde dhe në botën rreth teje? Perëndia është i mrekullueshëm, i fuqishëm, madhështor dhe Ai vepron në miliona mënyra! Mahnitu nga Perëndia ndërsa përgatitesh për këtë mësim, duke çuar ndërmend gjithçka që Ai ka bërë dhe që do të bëjë në të ardhmen.

Lutu: Kërkoji Perëndisë të lëvizë fuqishëm mes nxënësve – të largojë shpërqendrimet, të hapë zemrat, të mundësojë të kuptuarit e qartë të Shkrimit dhe të sjellë ndryshim në jetën e tyre.

Lexo: Danieli 3

Kupto si duhet: Shadraku, Meshaku dhe Abednego hidhen në furrën e ndezur
Edhe pse mbreti Nebukadnetsar e pranoi Pe rëndinë e Danielit si Ai që zbulon ëndrrat, gjithsesi nuk ndaloi së adhuruari perënditë e rreme, të bëra nga njeriu. Në fakt, ai ngriti një figurë prej ari që ishte gati 30m e lartë dhe gati 3m e gjerë, dhe urdhëroi që çdokush në mbretëri ta adhuronte. Kur Shadraku, Meshaku dhe Abednego nuk pranuan t'i bindeshin këtij urdhri, mbreti Nebukadnetsar i kërcënoi se do t'i hidhte në furrën e ndezur. Të armatosur me besim në fuqinë e Perëndisë për t'i çliruar, tre shokët besnikë e kundërshtuan dhe u hodhën mes flakëve. Mbreti Nebukadnetsar pa ndërsa Shadraku, Meshaku dhe Abednego, si dhe një i katërt që iu bashkua mrekullisht, ecën përmes zjarrit të padëmtuar. Mbreti urdhëroi që tre shokët të nxirreshin nga zjarri, lavdëroi Perëndinë e tyre dhe i shpërbleu me ngritje në detyrë. Shadraku, Meshaku dhe Abednego janë shembuj të vërtetë të kurajës dhe besimit në fuqinë e Perëndisë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënim për mësuesin kryesor:

- Si ta shndërrosh këtë mësim nga një "histori entuziazmuese" në "jetë ndryshuese"? Hapi i parë është ta lejosh të ndryshojë fillimisht jetën tënde. Çfarë po të mëson Perëndia? A është vërtet i fuqishëm Ai? Si ta dinë nxënësit se ti vërtet i beson një Perëndie të fuqishëm?
- Nëse ndonjëri nga nxënësit thotë se nuk mund të mbështetet te partneri i vet gjatë KZ-së, sqaroji se njerëzit bëjnë gabime dhe nuk mund të mbështetemi përherë te ta, mirëpo Perëndia është i përsosur dhe Atij mund t'i besojmë gjithmonë.
- Ndërsa ndihmon me KZ-në, shiko cilët janë nxënësit që e dëgjojnë udhëzuesin, që i besojnë vërtet dhe veprojnë sipas fjalëve të tij. Nëse nxënësit e zhvillojnë sfidën duke i besuar vetes, tregoju se janë skualifikuar sepse kanë bërë me hile apo se kanë derdhur ujin dhe janë lagur.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Përdor figura për të ilustruar mësimin. Krijo skenat kryesore duke përdorur objekte shtëpie. Mund të gjeni ide shtesë për këtë mësim duke kërkuar në internet.
2. Vizato paraprakisht figurat kryesore në një letër tabak. Detajet shtoji ndërkohë që shpjegon.
3. Gjatë mësimit kërkoju nxënësve të ngrihen në këmbë sa herë që dëgjojnë se një person i beson Perëndisë. Bëj një tabelë për t'i shënuar këto momente të rëndësishme: kush qëndroi i fortë, sfida që pati dhe pasoja(t) e mundshme për vendimin e marrë.

NISU!

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Faktori i besimit

Qëllimi: T'i ndihmojmë nxënësit të kuptojnë se Perëndia është i plotfuqishëm, se Ai është gjithmonë me ta dhe se, edhe pse nuk mund ta shohin Atë fizikisht, mund t'i **besojnë** Atij plotësisht.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Aktiviteti: Hapësirë jashtë

Mjetet:

- Vijë nisjeje – mjaft e gjatë, në mënyrë që të gjitha dyshet të qëndrojnë së bashku te vija
- Vijë përfundimi – mjaft e gjatë, në mënyrë që të gjitha dyshet të qëndrojnë së bashku te vija (duhet të ketë distancë të konsiderueshme midis dy vijave, rreth 23m.
- Shumë tullumbace me ujë, kova me ujë dhe pishina të vogla (nëse e bëni aktivitetin brenda përdorni pjata ose tasa plastikë)
- Zorrë ose një burim uji
- Dy konë të mëdhenj me nga një flamur secili (të vendosur te dy vijat)

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në dyshe.
2. Secila dyshe duhet të qëndrojë në vijën e nisjes.
3. Njëri nga të dy do t'i ketë sytë e mbyllur (sigurohuni që personi të mos shohë).
4. Sfidoje personin që sheh, ta udhëheqë partnerin që i ka sytë e mbyllur nëpër "fushën me ujë", pa u lagur, dhe që ta kapë flamurin i pari.
5. Partneri me sytë e mbyllur duhet të **besojë** se shoku i vet nuk do të lejojë që ai të shkelë në kurthe. Nëse partneri shkel një tullumbace apo laget, skuadra e tij skualifikohet nga marrja e flamurit.
6. Nëse partneri bën me hile, skuadra skualifikohet. Të gjithë drejtuesit dhe ndihmësit duhet të tregohen të kujdesshëm për të parë nxënësit.
7. Skuadra që nuk laget aspak dhe arrin e para te flamuri, fiton nga pesë etiketa shpërblyese për secilin.
8. Pasi të kenë përfunduar të gjitha grupet, përsëriteni aktivitetin duke ndërruar pozicionet e partnerëve dhe drejtimin. Vija e përfundimit bëhet vija e nisjes për grupin e dytë.
9. Vazhdo të theksosh fjalën **besim** ndërkohë që nxënësit e lejojnë partnerin e tyre t'i drejtojë përmes garës.

Këshilla për "Kohën e zbulimit":

1. Sigurohu që nxënësit t'i kenë mbyllur mirë sytë.
2. Partneri që drejton duhet të udhëzojë fizikisht dhe verbalisht. Nëse nxënësit janë të rritur, atëherë drejtimi mund të jetë vetëm verbal. Kjo do të theksojë rëndësinë e të dëgjuarit Perëndinë dhe besimit në Fjalët e Tij. Gjithashtu, do të jetë mirë nëse aktiviteti bëhet më tepër sfidues; kjo është thelbësore për këtë "Kohë zbulimi".
3. Ndoshta është më mirë që nxënësit të luajnë pa këpucë.
4. Sigurohu që partnerët drejtues ta kuptojnë mirë rolin e tyre. Ata duhet të jenë udhëzues të **besueshëm** dhe të përgjegjshëm.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

5. Paralajmëroi nxënësit të mos bëjnë me hile. Do të jetë shumë e dukshme.
6. Shpejtësia është shumë e rëndësishme, sepse ka vetëm një flamur.
7. Sa më tepër tullumbace, kova dhe legenë me ujë të ketë në fushë, aq më mirë!
8. Sigurohu që në fund të aktivitetit, nxënësit të mos fillojnë të marrin tullumbacet me ujë duke ia hedhur njëri-tjetrit.
9. Mund të duhet të marrësh disa ndihmës më shumë për këtë aktivitet.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesi kryesor – **Lidhja e KZ-së me mësimin**: Si u ndiet kur i kishit sytë e mbyllur dhe partneri po ju udhëhiqte përmes fushës me ujë? A i **besuat** partnerit? Si e treguat se vërtet kishit besim tek ata? (Duke dëgjuar e duke iu bindur udhëzimeve) A u mbështetët dot te partneri që të mos lageshit nga uji dhe a besuat se ai donte më të mirën për ju? Përse? (Sepse udhëzuesi e kishte pamjen e plotë të fushës me pengesa, por personi me sytë e mbyllur nuk arrinte ta shihte) Sa i **besuat** partnerit – 100% apo më pak se 100%?

Ashtu siç ndoqët partnerin, mund t'i tregoni Perëndisë se i **besoni** Atij duke dëgjuar Fjalën e Tij dhe duke ndjekur Atë. Qëllimi i Tij është të të mbrojë e të të udhëzojë. Ai është i plotfuqishëm dhe ti mund t'i **besosh** në ecjen tënde. Jeta nuk është gjithmonë e thjeshtë, por mos harroni, mund t'i **besoni** 100% Perëndisë, në kohë të mira dhe të vështira.

Lutu: *Inkurajoji nxënësit të jenë të guximshëm, si Danieli, duke qëndruar të fortë e duke u lutur në heshtje. Sfidoji të luten që të mësojnë diçka të re që do t'i bëjë më të fortë e më të guximshëm për Krishtin. Kujtoju se kur lutemi, Perëndia i plotfuqishëm i universit na dëgjon. Lëri të luten në heshtje për disa çaste, pastaj mbylle duke kaluar një kohë të shkurtër në lutje.*

Zbuloje: *Pyeti nxënësit nëse libri i Danielit gjendet në Dhiatën e Re apo në Dhiatën e Vjetër. (Dh. V.) Sfidoji t'i përmendin librat e Dhiatës së Vjetër deri te Danieli, pa i parë. Pasi të recitojnë librat e Dh. V., shiko se kush mund ta gjejë i parë Danielin në Bibël. Ndihmoni ata që janë për herë të parë.*

Kronologjia: Ku e shohim fuqinë e Perëndisë në kronologji? *Jepi një etiketë shpërblyese çdo përgjigjeje të mirë.* Do të shohim edhe njëherë sot fuqinë e Perëndisë në jetën e Danielit.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Le të rikujtojmë mësimet e fundit. Danieli, Shadraku, Meshaku dhe Abednego ishin izraelitë që jetonin në Jude. Për shkak se shumë izraelitë nuk i ishin bindur Perëndisë, Ai lejoi që mbreti Nebukadnetsar të pushtonte Judën. Mbreti Nebukadnetsar mori shumë izraelitë si robër në Babiloni që t'i shërbenin atij. Edhe pse Danieli, Shadraku, Meshaku dhe Abednego ishin robër në tokë të huaj dhe u ishte kërkuar të jetonin sipas dëshirave të mbretit, ata qëndruan të fortë dhe zgjodhën të jetonin siç i pëlqente Perëndisë. Javën e kaluar mësuan se Danieli u mbështet në urtësinë e Perëndisë dhe mund të tregonte e të interpretonte ëndrrën e mbretit Nebukadnetsar. Për ta shpërblyer Danielin dhe shokët e tij, mbreti e bëri Danielin sundues mbi Babiloni dhe Shadrakun, Meshakun dhe Abednegon i bëri udhëheqës. A do të ishte tani jeta e thjeshtë për Danielin dhe miqtë e tij, apo do të ishte sfidë për ta të qëndronin e të ndiqnin rrugën e Perëndisë? Le ta zbulojmë!

Përvijimi i Shkrimit: Danieli 3

Mbreti Nebukadnetsar ngre një statujë të artë

Parafrazim i Danielit 3:1-3:

Mbreti Nebukadnetsar ngriti një statujë prej ari shumë të madhe. Ishte tridhjetë metra e lartë dhe tre metra e gjerë. Pastaj thirri të gjithë udhëheqësit në Babiloni të vinin në ceremoninë e përurimit. Udhëheqësit erdhën dhe qëndruan përballë statujës gjigante prej ari. Dëgjoni se çfarë urdhëroi mbreti Nebukadnetsar për të gjithë njerëzit.

Mbreti Nebukadnetsar urdhëron që të gjithë të përulen e të adhurojnë statujën

Lexo Danieli 3:4-6

Përmbledhje: Mbreti Nebukadnetsar urdhëroi që të gjithë të përuleshin dhe të adhuronin statujën prej ari sa herë të dëgjonin muzikën! Mirëpo, a ju kujtohet se çfarë ka thënë Perëndia te Dhjetë Urdhërimet? Ai u tha izraelitëve – edhe neve – që të mos adhurojmë asgjë tjetër përveç Tij! Çfarë bënë Shadraku, Meshaku dhe Abednego? A iu bindën mbretit apo iu bindën Perëndisë? Do ta zbulojmë për pak.

Po ju? Kë apo çfarë adhuroni? Njerëzit kudo nëpër botë përulen dhe adhurojnë statuja sepse besojnë se ato janë perëndi, mirëpo këto perëndi nuk janë të vërteta; janë të rreme. Njerëzit adhurojnë edhe gjëra të tjera – gjëra që për ta janë më të rëndësishme se Perëndia. Ndoshta është paraja, miqtë, sportet, video-lojërat, muzika apo gjëra të tjera. Jepu kohë nxënëse të mendojnë për gjëra që njerëzit i bëjnë më të rëndësishme se Perëndinë. Ndoshta nuk duket sikur përulemi para tyre dhe i adhurojmë, mirëpo janë bërë për ne më të rëndësishme se Perëndia. Ky është mëkat, sepse asgjë në këtë botë nuk duhet të jetë më e rëndësishme për ne sesa Perëndia.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Le t'i drejtohemi sërish Biblës për të parë nëse Shadraku, Meshaku dhe Abednego iu bindën mbretit Nebukadnetsar apo Perëndisë.

Shadraku, Meshaku dhe Abednego i binden Perëndisë

Lexo Danieli 3:7-12 me theks të veçantë në vargun 12

Përmbledhje: Shadraku, Meshaku dhe Abednego qëndruan të fortë dhe iu bindën Perëndisë! Ata nuk do të adhuronin e as nuk do t'i shërbenin statujës! Le të zbulojmë se ç'bëri mbreti Nebukadnetsar.

Mbreti Nebukadnetsar urdhëron që ata të hidhen në furrën e zjarrtë

Lexo Danieli 3:13-15 duke theksuar fjalinë e fundit të vargut 15

Përmbledhje: Mbreti Nebukadnetsar urdhëroi që Shadraku, Meshaku dhe Abednego të hidheshin në furrën e ndezur, po të mos përuleshin e të adhuronin figurën e ngritur. Ai nuk mendonte se ndonjë perëndi mund t'i shpëtonte. Mirëpo, dëgjoni se çfarë i thanë ata mbretit Nebukadnetsar.

Shadraku, Meshaku dhe Abednego i besojnë fuqisë së madhe të Perëndisë

Lexo Danieli 3;16-18 duke theksuar vargjet 17-18

Përmbledhje: Kush mendoni se e kishte fuqinë për t'i shpëtuar? (Perëndia) Ata i besuan fuqisë së Perëndisë për t'i shpëtuar. Ashtu si në "Kohën e zbulimit" sot duhej t'i besonit partnerit që t'ju drejtonte që të mos lageshit. Shadraku, Meshaku dhe Abednego i thanë edhe diçka tjetër mbretit. Ata thanë se, edhe sikur Perëndia të mos i shpëtonte, ata nuk do t'u shërbenin kurrë perëndive të mbretit Nebukadnetsar e as nuk do ta adhuronin statujën e artë.

A nuk ju gëzon fakti që Shadraku, Meshaku dhe Abednego qëndruan të fortë dhe i besuan fuqisë së Perëndisë? Po sikur të kishit qenë ju? A mendoni se do të kishit qëndruar të fortë, si ata?

Pa prit... le të mendojmë për diçka që mund të ndodhë në ditët e sotme. Nëse në shkollë mësuesi do t'ju kërkonte të ngriheshit në këmbë nëse jeni të krishterë, a do të ngriheshit menjëherë apo do të shihnit njëherë përreth nëse do të ngrihej edhe ndonjë tjetër? Nëse mësuesi do të thoshte: "Perëndia nuk është i vërtetë, është histori e trilluar", a do të ishit mjaft të guximshëm për ta kundërshtuar e për të mbrojtur atë që besoni? Mund të besoni se Perëndia do të jetë me ju kur të qëndroni të fortë për Të.

Shadraku, Meshaku dhe Abednego hidhen në furrën e ndezur

Lexo Danieli 3:19-23

Përmbledhje: Sa herë e nxehu furrën mbreti Nebukadnetsar? (Shtatë herë më shumë se normalja) Furra ishte kaq e nxehtë, saqë ushtarët që hodhën

Shadrakun, Meshakun dhe Abednegon brenda, u dogjën dhe vdiqën! Mirëpo, ç'ndodhi me Shadrakun, Meshakun dhe Abednegon? A u dogjën ata?

Katër burra po ecnin mes zjarrit, të padëmtuar

Lexo Danieli 3:24-25

Përmbledhje: Sa burra ishin në zjarr? (Katër) Kush mendoni se ishte i katërti? Ndoshta ishte një engjëll i Perëndisë, ose ndoshta ishte Jezusi! Bibla nuk na e thotë, megjithatë e dimë se një i katërt ishte aty dhe askush nuk u dëmtua, sepse fuqia e Perëndisë i mbrojti. Perëndia i udhëhoqi dhe i mbajti të sigurt.

Shadraku, Meshaku dhe Abednego dalin nga furra

Lexo Danieli 3:26-27

Përmbledhje: A mësoi mbreti Nebukadnetsar se Perëndia i Shadrakut, Meshakut dhe Abednegos ishte Perëndia i vërtetë dhe se kishte fuqinë t'i shpëtonte? (Po) Dëgjoni se ç'tha mbreti Nebukadetsar?

Mbreti Nebukadnetsar lavdëron Perëndinë e vërtetë

Lexo Danieli 3:28-30

Përmbledhje: Mbreti Nebukadnetsar lavdëron Perëndinë. Ai u thotë të gjithëve se Shadraku, Meshaku dhe Abednego i besuan fuqisë së Perëndisë dhe Ai i shpëtoi. Çfarë urdhëroi mbreti për këdo që thoshte diçka kundër Perëndisë së vërtetë? (Ata do të priteshin në copa dhe shtëpia e tyre do të katandisej në vend plehrash) Ai madje i dha Shadrakut, Meshakut dhe Abednegos punë më të rëndësishme!

Përfundimi

Shadraku, Meshaku dhe Abednego janë shembuj shumë të fuqishëm për ne. Ata i besuan fuqisë së Perëndisë për t'i shpëtuar nga zjarri. Jo vetëm kaq, ata i besuan fuqisë së Perëndisë edhe po të mos i shpëtonte nga zjarri. Ata e dinin që, nëse Perëndia do të lejonte që ata të vdisnin, do të kishin jetë të përjetshme me Të. Perëndia i shpëtoi dhe madje i bekoi më tepër se më parë!

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

A jeni si Shadraku, Meshaku dhe Abednego? A i besoni fuqisë së madhe të Perëndisë? Cili varg jua kujton fuqinë e madhe të Perëndisë? (Jozueu 1:9) Gjatë një stuhie, a i besoni Atij dhe a thoni vargun te Jozueu 1:9 që ta përqendroni mendjen tek Ai? Gjatë një urgjence mjekësore, a i besoni vërtet Atij? Nëse shokët ju tundojnë të bëni gjëra të gabuara, a besoni se Perëndia do t'ju ndihmojë të shmangni tundimin? Perëndia është po aq i vërtetë sot, sa ishte në kohën e Shadrakut, Meshakut dhe Abednegos. Mund t'i besoni Atij, siç i besuan ata.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Hapi i parë për t'i besuar Perëndisë është të pranosh se ke mëkatuar, të besosh në Jezusin për të të falur dhe ta lejosh të jetë Udhëheqësi i jetës sate. A do të donit të mësoni se si ta bëni këtë? *Mundësi për të shpallur Ungjillin përmes "Librit pa fjalë" dhe për të bërë ftesë për shpëtim.*

Para se të largohemi sot, le të kalojmë pak çaste duke menduar se si mund ta zbatojmë këtë mësim në jetën tonë këtë javë. Ndoshta duhet ta bësh Perëndinë "Perëndinë tënd", duke vendosur të bëhesh anëtar i familjes së Tij, siç folëm. Ose ndoshta duhet të vendosësh tani t'i besosh fuqisë së madhe të Perëndisë në një situatë të vështirë që po kalon. Le ta mendojmë dhe pastaj mund të flasësh me Perëndinë që të të ndihmojë ta zbatosh në jetën tënde.

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Çfarë urdhëroi mbreti Nebukadnetsar që të bënin të gjithë? (Të përuleshin dhe të adhuronin statujën prej ari kur të dëgjonin muzikën)
2. Kush nuk po i bindej urdhërit të mbretit për t'u përulur dhe adhuruar figurën prej ari? (Shadraku, Meshaku dhe Abednego)
3. A u treguan ata të guximshëm apo frikacakë? (Të guximshëm)
4. Përse nuk e adhuruan figurën prej ari Shadraku, Meshaku dhe Abednego? (Sepse Perëndia ka thënë të mos adhurojmë asgjë tjetër veç Tij)
5. Çfarë tha mbreti Nebukadnetsar se do t'i ndodhte Shadrakut, Meshakut dhe Abednegos nëse nuk e adhuronin figurën prej ari? (Ata do të hidheshin në furrën e ndezur)
6. Për kë thanë Shadraku, Meshaku dhe Abednego se ishte në gjendje t'i shpëtonte? (Perëndia)
7. Çfarë ndodhi me ushtarët që i hodhën tre shokët te furra e ndezur? (Furra ishte aq e nxehtë, saqë ata vdiqën)
8. Çfarë ndodhi me Shadrakun, Meshakun dhe Abednegon në furrë? (Ata ecën në furrë dhe një "person" i katërt eci me ta; ata nuk u dëmtuan)
9. Çfarë tha mbreti Nebukadnetsar për Perëndinë, pasi Ai i shpëtoi tre shokët në furrë? (Nëse ndokush do të thoshte diçka kundër Perëndisë, do të vritej dhe shtëpia e tij do të shndërrohej në grumbull plehrash)
10. A do t'i besosh gjithmonë fuqisë së Perëndisë kur të gjendesh në situata të vështira?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 9
Danieli 6

Kupto si duhet:	Danieli hidhet në gropën e luanëve.
Mendo si duhet:	"Prandaj, o vëllezërit e mi të dashur, qëndroni të fortë e të patundur, duke tepruar përherë në veprën e Zotit, duke e ditur se mundi juaj nuk është i kotë në Zotin." 1 e Korintasve 15:58 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do të qëndroj i përkushtuar ndaj Perëndisë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem besnik kur qëndroj i përkushtuar ndaj Perëndisë.

PËRGATITU!

Kur bëhesh pjesë e familjes së Perëndisë, Ai përkushtohet ndaj teje dhe ti ndaj Tij. Përkushtimi i Perëndisë nuk zbehet kurrë; mbetet i fortë dhe i qëndrueshëm. Si njerëz të rënë, besnikëria e qëndrueshme është sfidë për ne. Fatmirësisht, me hirin e Perëndisë, kemi gjithmonë mundësi të dyta. Ai gjithashtu na jep Fjalën e Tij që të na nxisë. Danieli është një shembull i shkëlqyer i përkushtimit nën presionin e botës për të na hequr fokusin e për të na lëkundur. Le ta ripërkushtojmë jetën tonë këtë javë ndaj Perëndisë, e të qëndrojmë të fortë si Danieli!

Lutu: Kërkoji Perëndisë t'i ndihmojë nxënësit të kuptojnë rëndësinë e nderimit të përkushtimit, në një botë ku zotimet zakonisht nuk mbahen. Lutu që ata të kuptojnë dhe të vlerësojnë të vërtetën e përkushtimit të Perëndisë ndaj tyre, tani dhe përjetësisht.

Lexo: Danieli 6

Kupto si duhet: Danieli hidhet në gropën e luanëve
Ashtu siç kishte parathënë Perëndia përmes ëndrrës së mbretit Nebukadnetsar, Babilonia u pushtua nga fuqia tjetër që erdhi në botë. Mbreti i ri, Dar, e admironte Danielin dhe donte ta ngrite në detyrë që ai të mbikëqyrte mbretërinë e tij. Zyrtarët e tjetër të Babilonisë e manipuluan mbretin Dar që të nxirrte një ligj të ri që ndalonte rreptësisht lutjen ndaj çdo mbreti tjetër. Ata që nuk i bindeshin këtij dekreti do të hidheshin në gropën e luanëve. Kur Danieli vazhdoi t'i lutej me besnikëri të vetmit Perëndie të vërtetë, mbreti Dar nuk kishte zgjidhje tjetër veçse ta hidhte këshilltarin e tij të besuar në gropën e luanëve. Perëndia dërgoi engjëllin e Tij që të mbronte Danielin dhe luanët u ushqyen me zyrtarët e tjerë të Babilonisë. Pavarësisht kërcënimit për vdekje, Danieli tregoi se si të gjithë ne duhet të qëndrojmë <u>të përkushtuar ndaj Perëndisë</u>.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënime për mësuesin kryesor:

- Ji i vëmendshëm gjatë "Kohës së zbulimit" që të shohësh se cilët janë nxënësit të cilët nuk e mbajnë zotimin. Përse nuk e mbajnë? Çfarë i shpërqendron? Përdor disa nga këto ilustrime gjatë mësimit për të treguar si dhe pse njerëzit nuk i mbajnë zotimet e bëra ndaj Perëndisë.
- Përkufizimi i përkushtimit: një premtim i bërë me qëllim përmbushjen e tij deri në fund.
- Çfarë është përkushtimi për nxënësit? A shkelen shpeshherë zotimet? Ndërsa u mëson fëmijëve që të qëndrojnë të përkushtuar ndaj Perëndisë, kujto se shumë prej tyre e marrin shumë lehtë jetën. Mësoju vlerën e përkushtimit te mësimi i sotëm dhe vlerën që ka përkushtimi në marrëdhënien e tyre me Perëndinë.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Jepu nxënësve kartonë të vegjël me efekte zanore nga mësimi (për shembull: hungërima e luanit, lutja e Davidit, qarje, etj.) Shpërndajua, dhe në momentin e caktuar gjatë mësimit, nxënësi që ka kartën me efektin përkatës, e tregon atë.
2. Krijo gropën e luanëve në dhomë. Mund të zbehësh pak dritën dhe të vendosësh në sfond hungërimën e luanëve ndërkohë që nxënësit vijnë.

NISU!

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Përgjithmonë bashkë!

Qëllimi: Të mësojmë rëndësinë e **përkushtimit**.

<u>**Aktiviteti:** Hapësirë jashtë</u>

Mjetet:

- Konë, bojë me spërkatëse ose litar
- Tabelë ku shkruhet "eleminuar" (burim i printueshëm)
- Pistoleta me ujë
- Etiketa shpërblyese për dyshen fituese

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Udhëzime për ambientin: Përcaktoni kufij paraprakisht me konë, bojë me spërkatëse apo litarë, që nxënësit të kuptojnë mirë hapësirën e caktuar për të luajtur. Vendos tabelën "Eliminuar" në zonën e përcaktuar. Zgjidh drejtues që do të lagin nxënësit me pistoletat me ujë (nëse është moti i mirë).

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Mblidhi të gjithë nxënësit dhe shpjegoju lojën "**Përkushtim** në lojën me djegie".
   a. Shpjegoju se do të luajnë në dyshe lojën me të 'djegur'. Dyshet do të lidhen me njëra-tjetën duke u kapur nga bërrylat. Duhet të qëndrojnë të **përkushtuar** (fjalë kyç për lojën) dhe të bashkuar, edhe nëse lagen!
   b. Nëse dyshja ndahet, partnerët eliminohen.
   c. Dyshet që dalin jashtë kufijve, eliminohen. (Tregoju kufijtë e përcaktuar)
   d. Dyshet që "digjen" nga personi i caktuar si "djegësi", eliminohen.
   e. Dyshja e fundit që mbetet do të fitojë nga dy etiketa shpërblyese për secilin.
2. Pasi të shpjegosh lojën, zgjidh një drejtues apo një nxënës që do të jetë "djegës" (mund të zgjedhësh disa persona me radhë, nëse keni kohë)
3. Kërkoji secilit të gjejë një partner dhe të lidhen me njëri-tjetrin duke kapur bërrylat.
4. Shpjegoju edhe njëherë se çfarë do të thotë **përkushtim**: ata duhet të qëndrojnë së bashku deri në fund të lojës.
5. Filloni lojën.
6. Argëtohuni dhe përsërite vazhdimisht fjalën **përkushtim** gjatë lojës! Thekso rëndësinë e të qëndruarit së bashku deri në fund.
7. Shpërble me dy etiketa shpërblyese dyshen e fundit në lojë.
8. Përsëriteni nëse keni kohë.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesi kryesor – Lidhja e KZ-së me mësimin: Çfarë do të thotë fjala **përkushtim**? Kur luajtët, a qëndruat të **përkushtuar** ndaj partnerit dhe, a ishte e thjeshtë? Përse po ose jo? A ishte arsye për të thyer zotimin lagia me ujë apo vështirësia e sfidës? A e kuptoni se, po të jeni të krishterë, duhet të qëndroni të **përkushtuar** ndaj Perëndisë njëzet e katër orë në ditë, shtatë ditë të javës – edhe në fushën e futbollit, edhe kur del me miqtë? Ky është **përkushtim** serioz. Sot do të mësojmë për një person që qëndroi 100% i **përkushtuar** ndaj Perëndisë, madje deri në vdekje!

Lutu: Në disa vende të botës njerëzit nuk e kanë lirinë për t'u lutur me zë të lartë në publik. Konsiderohet krim dhe mund të përfundosh në burg. Në vende të tjera e kanë këtë liri. Le të falënderojmë Perëndinë sot që mund të lutemi së bashku me zë të lartë. Kush do të donte të lutej? *Sfido një nga nxënësit të ngrihet në këmbë dhe të lutet për mësimin.*

Zbuloje: *Shkruaj Danieli 6 në tabelë dhe mbuloje me një letër. Sapo ta zbulosh, nxënësit duhet të garojnë për ta gjetur referencën në Bibël. Shpërbleje fituesin me dy etiketa shpërblyese.*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Kronologjia: Cili person në kronologji qëndroi i përkushtuar ndaj Perëndisë, edhe kur situata ishte shumë e vështirë? *Jepu kohë nxënësve të përgjigjen.* Sot do të përqendrohemi te Danieli.

Prezantimi me mësimin nga Bibla: A ju kujtohet se çfarë mësuam për ëndrrën e mbretit Nebukadnetsar? Kush ia dha Danielit urtësinë për të treguar dhe interpretuar ëndrrën? (Perëndia) Përmes kësaj ëndrre, Perëndia i tha mbretit Nebukadnetsar se do të vinin mbretëri të tjera që do ta pushtonin Babiloninë, dhe se do të kishte mbretër të rinj. Danieli ishte ende në Babiloni kur kjo filloi të ndodhte. Emri i mbretit të ri ishte Dar. Sot do të mësojmë për një sfidë shumë të madhe me të cilën u përball Danieli kur Dari u bë mbret.

Përvijimi i Shkrimit: Danieli 6

Danieli është më i miri ndër udhëheqësit e caktuar nga mbreti Dar

Parafrazim i Danielit 6:1-5:

Mbreti Dar e pushtoi Babilonë, pikërisht siç kishte thënë Perëndia. Danieli ishte një nga tre burrat që mbreti zgjodhi për ta vënë në krye të mbretërisë. Për shkak se Danieli ishte i përkushtuar ndaj Perëndisë, ai bëri punë aq të shkëlqyer, saqë mbreti Dar e vendosi atë në krye të të gjithë mbretërisë. Zyrtarët e tjerë të mbretit ishin xhelozë për Danielin. Të jesh xheloz do të thotë se nuk je i kënaqur, madje je i zemëruar kur dikush ka diçka që ti nuk e ke. Është mëkat! Zyrtarët e tjerë nuk donin që Danieli të ishte në krye të mbretërisë, ndaj u përpoqën të gjejnë një mënyrë tjetër për ta futur Danielin në telashe. Kur nuk gjetën asgjë gabim te Danieli, vendosën ta zinin në kurth mbretin Dar. Le të shohim se ç'bënë ata.

Mbreti Dar nxjerr një dekret të ri

Lexo Danieli 6:6-9

Përmbledhje: Prefektët e mashtruan mbretin Dar, që të nënshkruante një ligj të ri që thoshte: nëse ndokush do t'i lutej ndonjë perëndie a njeriu, përveç mbretit Dar, gjatë tridhjetë ditëve të ardhshme, do të hidhej në gropën e luanëve. Mbreti Dar e firmosi dhe e nxorri dekretin dhe ai nuk mund të ndryshohej edhe po të donte mbreti Dar. Çfarë do të bënte tani Danieli? Si do të tregohej i guximshëm e të ruante përkushtimin e bërë ndaj Perëndisë?

Çfarë do të kishe bërë ti në vendin e Danielit? Mendoje pak. A e ke ndonjëherë të vështirë të qëndrosh i përkushtuar ndaj Perëndisë? Le të mendojmë për disa nga sfidat me të cilat mund të përballen bashkëmoshatarët tuaj. Po sfidat tuaja në shtëpi? A e keni të vështirë t'u bindeni prindërve apo të jeni të sjellshëm me vëllezërit dhe motrat? Po në shkollë? A keni turp që të tjerët të dinë se jeni të krishterë? A keni ndonjëherë frikë të luteni apo të lexoni Biblën

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

para shokëve? A lejoni që të tjerët t'ua mbushin mendjen të bëni gjëra që Perëndisë nuk i pëlqejnë? Ndoshta fjalët e pista apo ndonjë imazh jo i mirë në internet, ndoshta të talleni me dikë apo të mos respektoni mësuesin. Po kur jeni në shtëpinë e ndonjë shoku/shoqeje? A shihni filma apo luani video lojëra që e di se janë të papërshtatshme? Cili nga 12 vargjet kyç të ndihmon të qëndrosh i përkushtuar ndaj Perëndisë, pavarësisht gjithçkaje? Është vargu i sotëm nga "Mendo si duhet". *Kërkoju nxënësve të recitojnë 1 e Korintasve 15:58.* Le të kthehemi te mësimi për të zbuluar nëse Danieli qëndroi i përkushtuar ndaj Perëndisë apo iu bind mbretit.

Danieli qëndron i përkushtuar ndaj Perëndisë

Lexo Danieli 6:10

Përmbledhje: A e zbatoi Danieli dekretin e ri të mbretit Dar? (Jo) Përse jo? (Sepse nuk donte të mëkatonte; është mëkat të adhurosh këdo apo çfarëdo gjëje tjetër veç Perëndisë së vërtetë) A qëndroi Danieli i përkushtuar ndaj Perëndisë? (Po) Si? Çfarë bëri Danieli? (Ai u gjunjëzua dhe u lut tri herë në ditë përpara një dritareje të hapur) A do të zbulonin prefektët xhelozë se Danieli po e shkelte ligjin? A do ta hidhte vërtet mbreti Dar Danielin në gropën e luanëve?

Mbreti Dar nuk dëshiron ta hedhë Danielin në gropën e luanëve

Lexo Danieli 6:11-15

Përmbledhje: A e dëgjuat? A donte mbreti Dar ta hidhte Danielin në gropën e luanëve? (Jo) A u përpoq mbreti Dar ta shpëtonte Danielin? (Po) A e shpëtoi dot? (Jo) Çfarë mendoni se ndodhi me Danielin?

Mbreti Dar do që Perëndia ta shpëtojë Danielin nga luanët

Lexo Danieli 6:16

Përmbledhje: Çfarë tha mbreti Dar kur Danieli u hodh në gropën e luanëve? Lejo njërin prej tyre të përgjigjet pastaj përsërit Danielin 6:16 për ta theksuar. A mendoni se ishte e rëndësishme që mbreti Dar të shihte se Danieli i qëndronte besnik Perëndisë edhe në një situatë kaq sfiduese? (Po)

A është e rëndësishme që njerëzit të shohin se ti i qëndron besnik Perëndisë, edhe kur të bëhet presion për të mos qëndruar? (Po) Mos harroni që, nëse jeni të krishterë, njerëzit ju shohin për të kuptuar nëse jeni vërtet ndjekës të Jezusit. A qëndroni të përkushtuar ndaj Perëndisë apo vendosni gjëra të tjera para Tij? Le të shohim se ç'bëri Perëndia.

Danieli kalon natën në gropën e luanëve

Lexo Danieli 6:17-23

Përmbledhje: A e lënduan ndopak luanët Danielin? (Jo) Çfarë bëri Perëndia për të mbrojtur Danielin? (Ai dërgoi një engjëll që ua mbylli gojën luanëve)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

A nuk është e mrekullueshme që Perëndia është kaq i fuqishëm, saqë mund të na mbrojë?

Për nxënësit më të rritur: Nëse jeni të krishterë, duhet të kuptoni diçka shumë të rëndësishme: Danieli i besoi Perëndisë dhe Perëndia zgjodhi ta mbronte. A ju kujtohet Stefani? Mësuam për të disa muaj më parë. *Kanë mësuar për Stefanin në tremujorin e kaluar (Viti 3 – Tremujori 3).* Stefani i besoi Perëndisë dhe qëndroi i fortë për Të, mirëpo Perëndia lejoi që ai të vritej me gurë. Ku shkoi Stefani pasi vdiq? (Në qiell) Le të kujtojmë gjithashtu Shadrakun, Meshakun dhe Abednegon, të cilët qëndruan të fortë dhe besuan se Perëndia mund t'i shpëtonte nga zjarri, por gjithashtu thanë se, edhe po të mos i shpëtonte, ata nuk do të adhuronin kurrë diçka apo dikë tjetër veçse Perëndisë së vërtetë. Pavarësisht se çfarë lejon Perëndia të ndodhë në jetën tënde, qoftë e mirë apo e keqe në dukje, apo qoftë jetë a vdekje, duhet të qëndrosh i përkushtuar ndaj Tij dhe Ai vetë do të kujdeset për ty. Cili është vargu nga 12 vargjet kyç që na ndihmon ta kujtojmë këtë gjë? (1 e Korintasve 15:58) Le ta themi tani vargun. *Recitoni 1 e Korintasve 15:58 së bashku.*

Tani le të kthehemi te libri i Danielit dhe të shohim se ç'ndodhi më pas.

Prefektët xhelozë dhe familjet e tyre hidhen në gropën e luanëve

Lexo Danieli 6:24

Përmbledhje: Ua! Këta prefektë xhelozë donin që Danieli të vdiste në gropën e luanëve. Mirëpo, e kundërta ndodhi dhe ata, bashkë me familjet e tyre, vdiqën për shkak të mëkatit të tyre! Ma merr mendja që të gjithë morën një mësim të mirë atë ditë prej tyre. A e pyesni veten se ç'ndodhi me Danielin? Le të vazhdojmë të lexojmë.

Mbreti Dar lavdëron Perëndinë

Lexo Danieli 6:25-28

Përmbledhje: A besoi tani mbreti Dar në Perëndinë e vetëm të vërtetë? (Po) Mbreti Dari lavdëron Perëndinë dhe nxjerr një ligj të ri që thoshte se çdo njeri në mbretëri duhet të adhurojë Perëndinë e Danielit, Perëndinë e vërtetë.

Përfundimi

Çdo gjë bashkëveproi për mirë për Danielin. Jo vetëm që qëndroi i përkushtuar ndaj Perëndisë, por ishte edhe njëri nga profetët e mëdhenj që tregoi për planin e Perëndisë për të ardhmen. Kemi mësuar shumë nga Danieli dhe tre miqtë e tij, Shadraku, Meshaku dhe Abednego-ja. Edhe pse u rrezikohej jeta, ata e mbajtën përkushtimin ndaj Perëndisë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

“Vepro si duhet” dhe “Ndihu si duhet”

Le ta themi sërish vargun nga “Mendo si duhet”. *Kërkoju nxënësve të recitojnë 1 e Korintasve 15:58*. A qëndron dot i përkushtuar ndaj Perëndisë pavarësisht gjithçkaje? Mundesh, po të kesh besuar në Jezusin për shpëtim nga mëkati dhe po ta kesh bërë Udhëheqësin e jetës sate. Mendo disa mënyra se si mund të qëndrosh i përkushtuar ndaj Perëndisë dhe të bësh atë që Ai do prej teje. *Kërkoju nxënësve shembuj. Sugjero sipas nevojës.* Tani mendo për rastet kur nuk e ke ruajtur përkushtimin ndaj Perëndisë. Madje, përkundrazi, ke bërë diçka që nuk i ka pëlqyer Perëndisë. Kërkoju nxënësve të japin shembuj. Jep sugjerime sipas nevojës. Nëse i ke besuar Jezusit, kush banon brenda teje dhe të ndihmon të mbash përkushtimin? (Fryma e Shenjtë) Mos harro, Perëndia të ka dhënë Frymën e Tij të Shenjtë, ndaj e ke fuqinë që të duhet për ta mbajtur zotimin. Sa herë që të veprosh kështu, do të ndihesh besnik.

Po sikur të mos i kesh besuar Jezusit për të të shpëtuar nga mëkati dhe të mos e kesh bërë Atë Udhëheqësin e jetës sate? A do të doje të mësoje sot se si ta bëje këtë? Mundësi për të shpallur Ungjillin përmes “Librit pa fjalë” dhe për të bërë ftesë për shpëtim.

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t’i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Përse donin ta fusnin në telashe Danielin, prefektët e mbretit Dar? (Ata ishin xhelozë dhe nuk donin që mbreti Dar ta vendoste në krye të të gjithë mbretërisë)
2. Çfarë bëri mbreti Dar që mund të vuloste vdekjen e Danielit? (Ai nxorri një dekret që thoshte se, po t’i luteshin ndonjë personi apo dikujt tjetër veç mbretit Dar, kushdo do të hidhej në gropën e luanëve)
3. Çfarë vazhdoi të bënte Danieli pavarësisht ligjit të mbretit Dar? (Ai qëndroi i përkushtuar dhe iu lut Perëndisë tri herë në ditë)
4. Çfarë tha mbreti Dar kur Danieli u hodh në gropën e luanëve? (“Perëndia yt, të cilit ti i shërben vazhdimisht, do të vijë vetë të të shpëtojë”)
5. Çfarë ndodhi me Danielin në gropën e luanëve? (Perëndia dërgoi engjëllin e Tij që t’ia mbyllte gojën luanëve dhe Danieli shpëtoi)
6. Çfarë ndodhi me prefektët që u përpoqën ta vrisnin Danielin? (Mbreti Dar i hodhi ata, bashkë me familjet e tyre në gropën e luanëve dhe ata vdiqën)
7. Çfarë ligji nxori mbreti Dar pasi Perëndia shpëtoi Danielin? (Çdokush në mbretëri duhej të adhuronte Perëndinë e Danielit)
8. A do të qëndrosh i përkushtuar pavarësisht gjithçkaje?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 10
Libri i Esterit

Kupto si duhet:	Me guxim, Esteri rrezikon jetën e saj dhe Perëndia e përdor për të shpëtuar popullin e Tij.
Mendo si duhet:	"Por bëhuni bërës të fjalës dhe jo vetëm dëgjues, që gënjejnë vetveten." Jakobi 1:22
Vepro si duhet:	Unë do të jem i gatshëm të ndërmarr rreziqe për të bërë atë që është e drejtë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndiej mbështetjen e Perëndisë kur i ndërmarr rreziqet për të bërë atë që është e drejtë.

PËRGATITU!

Kur ne rrezikojmë rehatinë dhe sigurinë tonë për të bërë atë që është e drejtë, ndërmarrim veprime duke ditur se Perëndia është para dhe pas nesh, dhe se asgjë nuk e pengon planin e Tij. Duhet të jemi të shpejtë për të vepruar drejt dhe për të nderuar e kënaqur Perëndinë, pavarësisht çmimit. Ashtu siç veproi Perëndia përmes Esterit për të shpëtuar popullin e judenjve, Ai mund të veprojë përmes secilit prej nesh, që fjalët e veprat tona të reflektojnë Atë. Ndërsa studion librin e Esterit, kërkoji Perëndisë të të tregojë se si mund të të përdorë në mënyra të reja ndërkohë që ti ndërmerr rreziqe për Të.

Lutu: Lutu që nxënësit të kërkojnë vërtet Perëndinë dhe të veprojnë drejt. Lutu me Fjalët e Urta 2:1-11 për nxënësit, çdo ditë të javës.

Lexo: Libri i Esterit

Kupto si duhet: Me guxim, Esteri rrezikon jetën e saj dhe Perëndia e përdor për të shpëtuar popullin e Tij
Pas vdekjes së mbretit Dar, pasardhësi i fronit ishte djali i tij i dytë, i njohur si mbreti Asuero I-rë. Libri i Esterit filloi me shkarkimin e mbretëreshës Vashti për shkak se nuk pranoi t'i bindej një kërkese vulgare nga mbreti Asuero si dhe me zëvendësimin e saj nga një vajzë e bukur judease e quajtur Ester, e cila ishte rritur nga i afërmi i saj, Mardokeu. Mbreti Asuero, nxitur nga i besuari i tij hakmarrës, Hamani, në padije të prejardhjes judaike të gruas së tij të re, firmosi ligjin për të ekzekutuar të gjithë judenjtë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Esteri e dinte se Perëndia mund ta përdorte për të shpëtuar popullin e saj, mirëpo do t'i duhej të rrezikonte jetën e saj për t'u paraqitur para pranisë së mbretit, të zbulonte prejardhjen e saj dhe të nxirrte në dritë planin e ligë të Hamanit për të shfarosur popullin jude. Mbreti i zemëruar e anuloi gjenocidin e pamend dhe ekzekutoi Hamanin. Frymëzuar nga ngjarja e Esterit dhe duke u mbështetur nga Perëndia ynë i plotfuqishëm, edhe ne mund të përdoremi prej Tij po të jemi <u>të gatshëm të ndërmarrim rreziqe për të vepruar drejt</u>.

BËHU GATI!

Shënim për mësuesin kryesor:

- Ky mësim flet për virgjëresha dhe për eunukë. Kjo pjesë e tekstit do të parafrazohet dhe nuk do të lexohet drejtpërdrejt nga Bibla. Nëse nxënësit vënë re termat dhe pyesin për kuptimin e tyre, orientoji me kujdes që të pyesin prindërit kur të kthehen në shtëpi.
- Do të mbulojnë një libër të tërë të Biblës brenda një mësimi. Parafrazo me kujdes që të japësh pamjen e plotë të historisë, sipas kohës që ke në dispozicion.
- Për shkak se mbulojmë një përmbajtje me shumë hollësira, është shumë e rëndësishme të jesh i përgatitur për ta shpjeguar mësimin në bazë të nivelit të moshës. Nxënësve më të rritur mund t'u japësh më shumë detaje, ndërsa nxënësve më të vegjël do t'u japësh një pamje më të përgjithshme.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Zgjidh një objekt për çdo kapitull të librit të Esterit. Kur të jesh duke folur për secilin kapitull, nxirr objektin përkatës.
   a. Kapitulli 1: Ushqim mbretëror në një pjatë të veçantë – i vërtetë ose jo (për të përfaqësuar banketin)
   b. Kapitulli 2: kurorë, krëhër për flokët, shishe parfumi (trajtimet mbretërore të bukurisë)
   c. Kapitulli 3: Një pergamenë me vulë dhe një fjongo (dekreti mbretëror)
   d. Kapitulli 4: Pjatë bosh (agjërimi)
   e. Kapitulli 5: Ushqim mbretëror në një pjatë të veçantë – i vërtetë ose jo (për të përfaqësuar një banket)
   f. Kapitulli 6: *nuk do merremi me të; nuk ka nevojë për objekt*
   g. Kapitulli 7: Ushqim mbretëror në një pjatë të veçantë – i vërtetë ose jo (për të përfaqësuar një banket)
   h. Kapitujt 8-10: Fletë ku shkruhet "Shpëtimi i popullit jude" me xixa të arta
2. Var diku veshjet për këta personazhe: mbreti Asuero, Hamani, Mardokeu dhe Esteri. Ndërsa shpjegon, qëndro përbri secilës prej veshjeve dhe pyeti nxënësit se si mund të jetë ndier personi ose çfarë do të kishin bërë ata po të kishin qenë në vendin e tij/saj.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

NISU!

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Kush është i pari?

Qëllimi: T'i sfidojmë nxënësit të vendosin të tjerët të parët dhe t'i **ndihmojnë** të tjerët edhe kur mund t'u kushtojë.

Aktiviteti 1: Hapësirë e madhe brenda ose jashtë

Mjetet:

- Një hapësirë e caktuar e ndarë në dy anë të barabarta me një vijë ndarëse në mes
- Topa prej sfungjeri (vendosi te vija ndarëse në mes)

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në dy skuadra. Të gjithë do të jenë në lojë në fillim.
2. Qëllimi është t'ia hedhësh topin një anëtari të skuadrës tjetër dhe ta godasës nga shpatulla e poshtë. Nëse ndonjëri goditet nga shpatulla e poshtë, digjet, dhe duhet të qëndrojë jashtë fushës, por pranë skuadrës. Nëse ndonjëri nga nxënësit goditet në kokë, nuk digjet, por digjet personi që ka hedhur topin.
3. Anëtarët e skuadrës do të kenë mundësi të ndërmarrin një rrezik dhe të **ndihmojnë** njërin nga anëtarët e djegur të kthehet në lojë, nëse arrijnë të kapin një nga topat që hidhet drejt tyre. Nëse e kapin topin, njëri nga anëtarët e djegur të skuadrës mund të kthehet në lojë. Në një përpjekje të tillë ata rrezikojnë të digjen vetë, sepse po t'u bjerë topi nga dora, humbasin.
4. Nxënësit që ndërmarrin rrezikun për të **ndihmuar** njërin nga anëtarët e skuadrës që të rikthehet në lojë, do të fitojnë tre etiketa shpërblyese për çdo përpjekje të suksesshme.
5. Skuadra me lojtarin e fundit në fushë, fiton. Secili anëtar i skuadrës do të marrë dy etiketa shpërblyese.
6. Përsëriteni nëse keni kohë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Aktiviteti 2: Hapësirë e madhe brenda ose jashtë

Mjetet:

- Copë/shall për të mbyllur sytë (për gjysmën e nxënësve)
- Etiketa shpërblyese
- Një vijë e gjatë nisjeje dhe një përfundimi, rreth 9m larg njëra-tjetrës
- Disa pengesa të vendosura midis dy vijave (sigurohu që rruga me pengesa të jetë mjaft sfiduese për moshën e fëmijëve)

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në dyshe dhe vendosi pas vijës së nisjes.
2. Jepu shalle për të mbyllur sytë (njëri nga çdo dyshe). Gjysma tjetër (që ka sytë hapur) merr nga dy etiketa shpërblyese.
3. Informoji nxënësit që i kanë sytë e mbyllur se kanë mundësinë të fitojnë një etiketë shpërblyese nëse kalojnë me sukses rrugën me pengesa. Personi me sytë e mbyllur duhet ta kalojë sfidën, mirëpo partneri mund të zgjedhë nëse do ta ndihmojë ose jo, pasi të kuptojë rregullat e aktivitetit.
4. Shpjegoju rregullat e lojës: Partneri me sytë e mbyllur duhet të kalojë zonën me pengesa, pa u përplasur me asnjërën prej tyre. Nëse e përfundojnë me sukses, pa u përplasur me asnjë nga pengesat, dhe nëse i mbajnë sytë e mbyllura gjatë gjithë kohës, do të fitojnë pesë etiketa shpërblyese. Nëse partneri zgjedh ta ndihmojë, mund ta udhëzojë duke i ecur përkrah dhe duke i dhënë udhëzime verbale, por nuk mund ta prekë.
5. Shpjego kleçkën: Nëse ndonjëri nga nxënësit do ta **ndihmojë** partnerin që ka sytë mbyllur, duhet të heqë dorë nga dy etiketat e veta. Kujtoju se ndonjëherë është e kushtueshme t'i vendosësh të tjerët të parët, për t'i **ndihmuar**.
6. Lejoji nxënësit të vendosin se çfarë do të bëjnë dhe merrua dy etiketat shpërblyese atyre që zgjedhin t'i ndihmojnë partnerët. Ata që zgjedhin të mos ndihmojnë duhet ta shohin sfidën në heshtje.
7. Udhëzoji nxënësit të vendosin shallin te sytë dhe të fillojnë sfidën.
8. TË GJITHË DREJTUESIT: Shqyrtoni me kujdes reagimet e nxënësve! A do të jetë ndonjëri i gatshëm të heqë dorë nga dy etiketat e veta për të ndihmuar partnerin? Kush është i gatshëm të sakrifikojë për të bërë gjënë e duhur dhe për ta vendosur partnerin të parin?
9. Në fund të sfidës, trego se të dy do të marrin nga pesë etiketa shpërblyese, nëse kanë bashkëpunuar për të përfunduar me sukses rrugën me pengesa (pa u përplasur dhe pa hequr shallin nga sytë). *Shënim: Mos e trego para kohe se nxënësit që heqin dorë nga dy etiketat e tyre do të fitojnë pastaj pesë etiketa, sepse do të bëjnë veprimin e duhur për arsyet e gabuara.*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesi kryesor – Lidhja e KZ-së me mësimin: Ndonjëherë jeta është e rehatshme dhe plot argëtim. Perëndia na bekon me periudha të tilla! Mirëpo, ndonjëherë fillojmë të mendojmë se të qenët rehat dhe argëtimi janë aq të rëndësishme, saqë vendosim veten në vendin e parë, duke harruar se qëllimi ynë është të bëjmë atë që është e drejtë dhe të nderojmë Perëndinë. (*Parashtro pyetje në bazë të aktivitetit që zgjodhe: A dëshiroje të kapje topin për të ndihmuar anëtarët e skuadrës? A ishe i gatshëm të hiqje dorë nga etiketat e tua shpërblyese për të ndihmuar partnerin?*) Përse po ose jo? Sot do të mësojmë për një person që mund të kishte vënë veten në vend të parë e të shijonte kohën në pallatin mbretëror, mirëpo veproi siç duhej edhe pse mund t'i kishte kushtuar jetën.

Lutu: *Kërkoji njërit prej nxënësve të nisë mësimin me lutje. Nëse kanë nevojë për sugjerime, inkurajoji të luten që të mësojnë diçka të re dhe që të jenë të zellshëm për ta vënë në zbatim atë që mësojnë.*

Zbuloje: *A gjendet libri i Esterit n*ë Dhiatën e Vjetër apo në Dhiatën e Re? (Dh. V.) Kërkoju nxënësve të përmendin librat e Dhiatës së Vjetër deri te Esteri ndërkohë që gjejnë Esterin te Bibla e tyre.

Kronologjia: *Trego të gjithë mbretërit në kronologji. Sot do të flasim për një mbretëreshë – mbretëresha Ester. Esteri jetoi pas kohës së Danielit, por para kohës së Ezdrës dhe Nehemias. Tregoje te kronologjia.*

Ide alternative: Tani që është fundi i tremujorit, nëse përdorni shigjetat prej letre, hiqini dhe sfidojini nxënësit t'i vendosin sipas radhës.

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Kemi mësuar për Danielin, që zgjodhi të bënte atë që ishte e drejtë, megjithëse kjo nënkuptonte se do rrezikonte jetën. Sot do të mësojmë për mbretin Asuero, i cili sundonte nga India në Afrikën veriore; për Hamanin, një burrë që i urrente judenjtë; për Esterin, që ishte tmerrësisht shumë e guximshme dhe për Mardokeun, kushëririn e Esterit.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përvijimi i Shkrimit: Libri i Esterit

Mbreti Asuero

Parafrazimi i Esterit 1:

Mbreti Asuero ishte një mbret i fuqishëm e shumë i pasur. Ai bëri një festë ku shpalosi të gjithë pasurinë dhe shkëlqimin e tij. Festa zgjati 180 ditë. I bie gjashtë muaj! Të gjithë njerëzit e rëndësishëm në atë zonë, përfshirë princër, udhëheqësit e ushtrisë dhe fisnikët erdhën për festën. Në fund të festës, ai shtroi një banket që zgjati shtatë ditë. Ftoi këdo që jetonte apo punonte në pallatin e tij, nga më i vogli te më i madhi.

Në atë kohë, mbreti Asuero kishte një grua të quajtur mbretëresha Vashti. Ajo mbajti banketin e vet me gratë në pallatin mbretëror. Gjatë festës, mbreti Asuero i kërkoi asaj të shkonte te festa e tij, që ai t'u tregonte miqve të vet se sa e bukur ishte ajo. Mbretëreshës Vashti nuk i pëlqeu aspak kjo ide! Ajo tha "jo" dhe nuk pranoi të shkonte. Mosbindja ndaj mbretit ishte veprim i rëndë. Mbreti Asuero u zemërua aq shumë, saqë deklaroi se ajo nuk do të ishte më mbretëreshë.

Esteri bëhet mbretëreshë

Parafrazim i Esterit 2:1-7:

Ndihmësit personalë të mbretit thanë se duhej të niste kërkimi për një mbretëreshë të re. A ju kujtohet se si mbreti Nebukadnetsar pushtoi Jerusalemin dhe robëroi judenjtë në Babiloni? Në njërën prej familjeve që u sollën në Babiloni ishte një burrë i quajtur Mardoke dhe kushërira e tij, Ester. Mardokeu e mori Esterin si fëmijët e vet, sepse prindërit e saj kishin vdekur kur ajo kishte qenë shumë e re. Esteri ishte shumë e bukur. Le të zbulojmë se çfarë i ndodhi Esterit.

Lexo Esteri 2:8-11

Përmbledhje: Esteri u paraqit në pallatin mbretëror si mbretëresha e mundshme. Kushëriri i saj Mardokeu i tha të mos i tregonte askujt që ishte judease, kështu ajo e mbajti sekret.

Parafrazim i Esterit 2:12-17:

Esteri mori përkujdes dhe trajtim mbretëror për muaj të tërë, derisa më në fund erdhi radha e saj për t'u paraqitur para mbretit. Mbretit i pëlqeu Esteri dhe e bëri atë mbretëreshë. Ai vendosi një kurorë në kokën e saj dhe kështu roli i saj u zyrtarizua.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Lexo Esteri 2:18
Përmbledhje: A e imagjinoni dot se si ka qenë që një person i zakonshëm, papritur të bëhej mbretëror?

Për shkak të kufizimit të kohës, nuk do të lexojmë Esterin 2:19-23.

Hamani kërkon të shkatërrojë judenjtë

Parafrazim i Esterit 3:
Njëri nga zyrtarët në pallatin e mbretit ishte një burrë i quajtur Haman. Hamani nuk i pëlqente judenjtë. Ai mendonte se ai vetë ishte shumë i madh dhe i detyronte të gjithë drejtuesit e tjerë në pallatin mbretëror të përuleshin para tij te porta. Mardokeu nuk pranoi ta bënte këtë, edhe pse mori mospëlqim nga njerëzit për këtë veprim. Hamani u zemërua aq shumë, saqë u zotua të vriste të gjithë popullin e Mardokeut. Ai madje e bindi mbretin ta bënte ligj shkatërrimin e gjithë judenjve.

Esteri bën atë që është e drejtë

Parafrazim i Esterit 4:
Mardokeu mësoi se çfarë kishte ndodhur dhe e dinte se populli i tij do të shkatërrohej. Mardokeu dhe i gjithë populli jude grisën rrobat dhe qanë si shenjë e trishtimit dhe trazimit për atë që do të ndodhte. Esteri dëgjoi se çfarë po bënin judenjtë dhe mësoi për planin e tmerrshëm të Hamanit për të vrarë të gjithë popullin e saj. I gjithë populli jude filloi të lutej.

Mardokeu iu lut Esterit t'i ndihmonte, megjithëse nuk do të ishte e lehtë. Ajo nuk mund të shkonte te mbreti pa e kërkuar ai më parë. Ishte kundër ligjit. Nëse shkonte tek ai pa u thirrur, mund ta vrisnin. Mirëpo Mardokeu i kujtoi asaj se, ndoshta ishte bërë mbretëreshë pikërisht për këtë arsye – "për një kohë të tillë". A mendoni se ajo do të ndihmonte që populli i saj të shpëtonte? Le ta zbulojmë.

Lexo Esteri 4:15-17
Përmbledhje: Ua! Esteri ishte shumë e guximshme! Ajo tha se do të përpiqej ta shpëtonte popullin e saj – popullin e veçantë të Perëndisë – edhe nëse kjo do t'i rrezikonte jetën. Përveçse ishte e gatshme të vdiste për popullin e saj, Esteri ishte edhe e urtë, sepse i kërkoi popullit të vet të agjëronte. Kur njerëzit agjërojnë, heqin dorë nga ushqimi për njëfarë kohë dhe kalojnë më shumë kohë në lutje. A ke pasur ndonjëherë ndonjë problem dhe u ke kërkuar miqve dhe familjarëve të luten?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Ungjilli

Pa prisni pak! Kjo më kujton dikë nga Dhiata e Re që ishte i gatshëm të vdiste për të shpëtuar popullin. Ai u kërkoi edhe miqve të luteshin. A e gjeni dot se për kë po flas? (Jezusi) *Shpall Ungjillin duke përdorur "Librin pa fjalë", duke u siguruar të bësh ftesë për t'u lutur e për të pranuar Jezusin si Shpëtimtar.*

Esteri shkon te mbreti

Lexo Esteri 5:1-8

Përmbledhje *dhe parafrazim i 5:9-14:*

Mbreti Asuero e lejoi Esterin të shkonte tek ai dhe të bënte një kërkesë. Ajo kërkoi që edhe mbreti edhe Hamani t'i bashkoheshin për darkë. Hamani e mendoi veten edhe më të rëndësishëm tani, sepse do të hante darkë me mbretin dhe mbretëreshën. Gjatë darkës, Esteri e ftoi mbretin dhe Hamanin t'i bashkoheshin të nesërmen për një tjetër darkë të veçantë.

Më vonë gjatë asaj dite, Hamani pa Mardokeun. Mardokeu sërish nuk iu përul, gjë që e zemëroi shumë Hamanin – aq shumë, saqë planifikoi me detaje se si do ta vriste Mardokeun.

Për nxënësit më të rritur: Hamani përgatit një trekëndësh njëzet e një metra të lartë që të varte Mardokeun.

Për shkak të kufizimit të kohës, do ta kalojmë Esterin 6.

Hamani zihet mat

Lexo Esteri 7:1-7

Përmbledhje: Mbretëresha Ester i tregoi mbretit për planin e ligë të Hamanit për të vrarë popullin e saj! Kur mbreti e dëgjoi këtë, u tërbua!

Parafrazim i 7:8-10:

A ju kujtohet se Esteri dhe judenjtë e tjerë agjëruan dhe u lutën tre ditë? Perëndia u përgjigj me "po" dhe i shpëtoi.

Për nxënësit më të vegjël: Për shkak se mbreti ishte kaq i zemëruar, e vrau Hamanin.

Për nxënësit më të rritur: Për shkak se mbreti ishte kaq i zemëruar, ai e vari Hamanin në po të njëjtin trekëndësh që ai kishte përgatitur për Mardokeun.

Mbreti bekon Esterin

Parafrazim i Esterit 8:

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Në po të njëjtën ditë, mbreti i dha mbretëreshës Ester gjithçka që i kishte përkitur Hamanit. Mbreti, gjithashtu, i dha Mardokeut autoritetin dhe fuqinë që kishte pasur Hamani dhe populli i judenjve shpëtoi.

Përfundimi (përfshin Esterin 9-10)

Esteri ishte e guximshme dhe Perëndia e përdori për të shpëtuar popullin e Tij. Perëndia vazhdoi të përdorte Esterin dhe Mardokeun për të bekuar popullin e judenjve. Mund ta përfundosh librin e Esterit në shtëpi me prindërit, duke lexuar kapitujt nëntë dhe dhjetë.

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

Esteri mund të kishte pasur telashe të mëdha me mbretin Asuero, mirëpo ajo e mbrojti popullin e vet gjithsesi. U tregua trime dhe e guximshme, si dhe i besoi Perëndisë. Po ju? Nëse në shkollë dikush do t'ju kërkonte t'i bashkoheshit për t'u tallur me një fëmijë tjetër, a do të thoshit "jo"? A do të bëheshit miq me personin që po përpiqeshin të tallnin? Apo, nëse miqtë duan t'ju tregojnë diçka të papërshtatshme në telefon, a bëni gjënë e duhur dhe largoheni duke inkurajuar edhe të tjerët të largohen? Esteri mund ta kishte injoruar Mardokeun dhe popullin e vet dhe të shijonte jetën në pallatin mbretëror, mirëpo kuptoi se nuk jetonte për të kënaqur veten, por për t'u shërbyer të tjerëve. Ashtu siç ishit disa prej jush të gatshëm të hiqnit dorë nga etiketat shpërblyese për të ndihmuar shokun gjatë "Kohës së zbulimit", edhe Esteri, me guxim, vendosi të tjerët të parët dhe veproi drejt, dhe Perëndia e përdori për të shpëtuar popullin e judenjve.

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Si quhej mbreti që mbajti 180 ditë festë mbretërore? (Mbreti Asuero)
2. Kur mbreti vendosi që mbretëresha Vashti nuk do të ishte më mbretëreshë, çfarë bënë ndihmësit e mbretit? (Filluan të kërkonin një mbretëreshë të re)
3. Si quhej mbretëresha e re? (Ester)
4. A ishte pjesë e planit të Perëndisë që Esteri të bëhej mbretëreshë? (Po)
5. Si quhej kushëriri i Esterit i cili u kujdes për të pasi i vdiqën prindërit? (Mardokeu)
6. Si quhej ai burri që thuri një plan të ligë për të vrarë popullin jude? (Haman)
7. Çfarë bënë Mardokeu, Esteri dhe i gjithë populli jude për tre ditë? (Ata agjëruan)
8. A iu përgjigj Perëndia lutjeve të tyre, duke i shpëtuar? (Po)
9. Esteri ndërmori një rrezik të madh për të bërë atë që ishte e drejtë. Kur mund të të duhet të ndërmarrësh një rrezik për të bërë atë që është e drejtë?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 11
Dita e përsëritjes

Kupto si duhet:	Urtësia e vërtetë vjen nga Fjala e Perëndisë.
Mendo si duhet:	"Por rrituni në hirin dhe në njohjen e Zotit dhe të Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht." 2 e Pjetrit 3:18a (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do të kujtoj Fjalën e Perëndisë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem plot urtësi kur kujtoj Fjalën e Perëndisë.

PËRGATITU!

Ditët e përsëritjes janë ditë feste edhe për nxënësit ,edhe për drejtuesit. Është gëzim i madh t'i shohësh nxënësit ta kuptojnë më tepër Perëndinë përmes Fjalës së Tij. Shijo frytet e veprës së Perëndisë në ta gjatë këtij tremujori!

Lutu: Lutu që, ndërsa përsërisni këtë javë, nxënësit të kujtojnë se çfarë kanë mësuar gjatë këtij tremujori dhe që kjo e vërtetë të zërë vend në zemrat e tyre!

Lexo: Përsërisni mësimet e tremujorit.

Kupto si duhet: Urtësia e vërtetë vjen nga Fjala e Perëndisë
Më në fund do të marrim një ditë për të reflektuar e për të kujtuar gjithçka që Perëndia na ka mësuar gjatë këtij tremujori. Ju ftojmë të na bashkoheni tremujorin e ardhshëm, ndërsa do të rikthehemi te libri i Zanafillës dhe do të studiojmë krijimin e botës dhe shpalosjen e planit të Perëndisë për të na shpëtuar nga mëkati. Zoti të bekoftë që ke shërbyer me përulësi!

BËHU GATI!

Plan i veçantë për ditën e përsëritjes:
15 minuta: Loja e përsëritjes para shërbesës
15 minuta : Adhurimi
20 minuta: Koha e Zbulimit
10 minuta: Diskutim (shih më poshtë)

NISU!

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Koha e zbulimit: Gara e përsëritjes!

Qëllimi: T'i sfidojmë nxënësit të kujtojnë çfarë kanë mësuar gjatë tremujorit, ndërkohë që argëtohen!

Aktiviteti: Hapësirë jashtë

Mjetet:

- Drejtues për lojën
- Kronometër i madh
- Një copë e madhe me vrima dhe vlerë në pikë (mund të përdorni copë, dru të madh, etj. Nxënësit do të duhet të shënojnë për të fituar pikë.)
- Topa të ndryshëm: futbolli, volejbolli, sfungjeri, etj.)
- Një copë letër për çdo drejtues, ku të mbajë shënim pikët
- Zile apo bori
- Muzikë për të krijuar atmosferë konkurruese
- Vija ose kone prej nga ku do të godasin nxënësit (nëse nxënësit janë të rritur vija duhet të jetë më larg)
- Diçka për të ngrënë për të gjithë nxënësit dhe diçka të veçantë për skuadrën fituese (ushqimi për të gjithë duhet të jetë më i thjeshtë, në mënyrë që të përpiqen më shumë për të fituar ushqimin e veçantë)
- Listë me pyetje (përdorni pyetjet e përsëritjes së mësimeve dhe pyetjet e "Hartës së gjurmuesit: nga shtojca); pyetjet duhet të jenë e vërtetë/e gabuar, me alternativa ose me plotësimin e vendeve bosh, dhe duhet të përqendrohesh te:
    - Aftësia për të dalluar persona kyç që e kanë studiuar tremujorin (Mendo si duhet).
    - Aftësia për të zbatuar mësimin nga Bibla në situata të përditshme (Vepro si duhet).
    - Temat e "Hartës së gjurmuesit".

Përmbledhje e aktivitetit të "Kohës së zbulimit": Në këtë aktivitet, nxënësit do të punojnë si skuadër për të fituar pikë, duke hedhur topat te shënjestra qendrore. Mësuesi kryesor do të bëjë pyetjet e përsëritjes dhe kur nxënësi të përgjigjet saktë, vrapon te vija e caktuar dhe hedh dy topa për të shënuar pikë. Mësuesi vazhdon të bëjë pyetjet ndërkohë që nxënësit kalojnë me radhë te vija nga ku do të godasin me topat. Drejtuesi i KZ-së qëndron te shënjestrat për të mbajtur pikët. Pasi nxënësi te vija t'i ketë bërë të dyja përpjekjet, kthehet te pjesa tjetër e skuadrës. Skuadra me më shumë pikë fiton ushqimin e veçantë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Thuaj: “Sot do të kemi garë në grupe (ndaji në dy skuadra). Keni kohë të kufizuar për të shënuar sa më shumë pikë të mundeni. Secili prej jush do të marrë diçka për të ngrënë në fund, mirëpo vetëm skuadra fituese do të marrë “ushqimin e veçantë” (tregojua që të nxiten për të luftuar më fort për ta fituar).”
2. Mësuesi u bën pyetjet grupeve. Nëse nxënësi përgjigjet saktë, shkon te vija dhe përpiqet të shënojë pikë te shënjestra duke goditur topin. Drejtuesi i KZ-së qëndron te shënjestra për të shënuar pikët.
3. Dikush mund të kujdeset për t’i kthyer topat te vija.
4. Loja duhet të ketë ritëm të shpejtë dhe fëmijët duhet të jenë duke nxituar nga vendi i skuadrës te vija për të shënuar pikë.
5. Drejtuesi i lojës u kujton skuadrave pikët herë pas here dhe u thekson se sa kohë ka mbetur.
6. Në fund të aktivitetit të përsëritjes, skuadra me më shumë pikë fiton ushqimin e veçantë.

Ide alternative: Në vend që të garojnë kundër njëri-tjetrit, sfidoji të përpiqen të shënojnë një numër të caktuar pikësh që të marrin ushqimin e veçantë. Në këtë mënyrë, të gjithë mund ta fitojnë ushqimin e veçantë, nëse arrijnë numrin e pikëve. Nëse nuk i arrijnë pikët, nuk marrin ushqimin e veçantë.

Diskutimi përmbyllës në klasë

- Nxënësit do të kthehen në klasë për një përmbyllje të shkurtër të tremujorit dhe/ose për një kohë diskutimi.
- Për ndihmësit: Ndërkohë që nxënësit kthehen në klasë, ndihmoji të marrin ushqimin që kanë fituar.

Alternativa 1: Ndaji nxënësit në dy skuadra. Sfidoji të bëjnë një listë me fakte që kanë mësuar këtë tremujor. Ndihmësit mund të bëhen kapitenët e skuadrave. Pas përfundimit të sfidës, uluni në rreth me nxënësit dhe diskutoni se si i kanë zbatuar ata gjërat që kanë mësuar. Disa shembuj të mirë mund t’i vlerësoni me etiketa shpërblyese.

Alternativa 2: Për nxënësit më të vegjël: Përdorni letër tabak ku nxënësit të vizatojnë mësimin e tyre të preferuar nga ky tremujor.

Alternativa 3: Jepi secilit një kopje të posterit “Ndihu si duhet” (burim i printueshëm). Ndërsa rishikoni secilin nga personazhet për të cilët keni mësuar këtë tremujor, kërkoju të shënojnë emrat e tyre pranë njërit prej emocioneve. Pyeti se përse ai personazh mund të jetë ndier ashtu; kjo duhet të nxisë biseda më të thella frymërore.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Shtojca

Harta e gjurmuesit

Mësimi tematik: Të njohim librin e Psalmeve

Kupto si duhet:	Psalmet janë një përmbledhje këngësh drejtuar Perëndisë.
Mendo si duhet:	"U miratofshin para teje fjalët e gojës sime dhe përsiatjet e zemrës sime, o Zot, kështjella ime dhe shpengimtari im." Psalmi 19:4
Vepro si duhet:	Unë do ta adhuroj Perëndinë në çdo situatë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem mirë që e adhuroj Perëndinë në çdo situatë.

PËRGATITU!

Ky mësim ka për qëllim t'i prezantojë nxënësit me librin më të gjatë në Bibël – Psalmet. Do të mësojnë disa baza për këtë libër si dhe për përmbajtjen e tij dhe llojet e ndryshme të psalmeve. Përmes Psalmeve, populli i Perëndisë komunikon me Të me zell dhe pasion, e pavarësisht ndjenjave, shkruesi i kthehet gjithnjë besimit te Perëndia dhe dëshirës për ta adhuruar e për t'ju bindur.

Lutu: Lutu që Perëndia t'i ndihmojë nxënësit ta kuptojnë librin e Psalmeve dhe të kenë dëshirën për të adhuruar Perëndinë dhe për t'ju bindur Atij.

Lexo: Psalmi 19:14, që është vargu nga "Mendo si duhet" për këtë mësim. Do të ishte mirë të lexoje edhe Psalme të tjera për të rifreskuar mendimet mbi emocionet e ndryshme që shprehen në këtë libër (Psalmi 34, 42 dhe 95)

Kupto si duhet: Psalmet janë një përmbledhje këngësh drejtuar Perëndisë

BËHU GATI!

Shënime për mësuesin kryesor:

- Libri i Psalmeve na kujton se ne adhurojmë dhe i shërbejmë një Perëndie që jo vetëm sundon mbi gjithë krijimin, por që gjithashtu dëshiron të jetë afër nesh personalisht. Ai kërkon bindjen tonë si dishepuj, por nuk na lë vetëm në larmishmëritë e jetës.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

- Psalmet janë një përmbledhje e mrekullueshme këngësh nga njerëz që shkojnë te Perëndia ashtu siç janë – jo duke u ndrequr apo duke u përpjekur të shmangin fjalë të caktuara e duke thënë: “Unë nuk jam mjaft i mirë për të shkuar para Perëndisë”.
- Psalmet nuk janë të mërzitshme apo mediokre! Ky libër i Biblës shfaq një shumëllojshmëri të emocioneve njerëzore. Kur flet për gëzimin, nuk tregon për një moment të shkurtër lumturie, por për gëzim të thellë, të pabesueshëm që mbush shpirtin. Kur flet për hidhërimin, nuk tregon për trishtim të çastit, por një hidhërim të thellë për boshllëkun e trishtimit të zgjatur. Kjo është mundësia jote për ta bërë këtë libër më personal për çdo nxënës. Inkurajoji t’i binden Perëndisë me gjithë zemër e t’i shprehen me ndershmëri Atij që i ka krijuar.

Ide krijuese për mësimin biblik:

1. Idetë e mëposhtme janë përfshirë edhe në mësim:
   a. Tre kartonë te të cilët të shkruash: “I besueshëm”, “I fuqishëm”, “I dashur”
   b. Diçka të vogël për të ngrënë për nxënësit, që t’u tregosh se i mban premtimet (shembulli në mësim është biskota)
   c. Pamje të krijimit të jashtëzakonshëm të Perëndisë: oqeanet, malet, galaksitë (burim i printueshëm)

   d. Vizato një fytyrë të lumtur në njërën anë dhe një fytyrë të trishtuar në anën tjetër të një pjate plastike të bardhë (nga një për çdo nxënës). Shpërndaji pjatat kur të arrish te pjesa e mësimit që thotë “Perëndia do që t’i tregojmë Atij ndjenjat tona”. Pasi të lexoni çdo pasazh të Shkrimit, kërkoju nxënësve të ngrenë lart pjatën në anën që tregon emocionin që po tejçohet në atë pasazh.
2. Përgjatë mësimit, referoju posterit “Ndihu si duhet”.

NISU!

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t’i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Alternativa 1: Koha e zbulimit: Art adhurimi!

Qëllimi: T’u japim nxënësve mundësinë të adhurojnë Perëndinë duke u treguar krijues përmes artit.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Vendndodhja: Hapësirë e madhe

Mjetet:

- Letër tabak ose letra të mëdha
- Mjete zbukurimi (lapustila, bojëra dhjami, bojëra uji, etj.)
- Muzikë adhurimi në sfond

Udhëzime për "Kohën e zbulimit":

1. Ndërkohë që luhet muzika e adhurimit, inkurajoji nxënësit të përdorin njohuritë e tyre për Perëndinë që të krijojnë një vepër arti, që u tregon të tjerëve se kush është Perëndia. Mund të pikturojnë ose vizatojnë një figurë të bukur adhurimi ose të shkruajnë fjalë që i ndihmojnë të adhurojnë.
2. Ide: Pikturo diçka të bukur që Perëndia ka krijuar, vizato një vend kur të pëlqen të adhurosh Perëndinë, shkruaj fjalë që të kujtojnë Perëndinë ose shkruaj një varg nga Bibla që e di.
3. Alternativë: Në fund të aktivitetit të "Kohës së zbulimit", ftoji nxënësit të tregojnë se çfarë kanë krijuar dhe pse.

Alternativa 2: Koha e zbulimit: Adhuro kudo!

Qëllimi: T'i ndihmojmë nxënësit të kuptojnë se mund ta adhurojnë Perëndinë kudo dhe në çdo kohë.

Vendndodhja: Hapësirë e madhe

Mjetet:

- Pesë tabela/letra të mëdha ku shkruhet:
  - "Kisha", "Shtëpia", "Shkolla" dhe "Parku" (vendosi nëpër katër cepat e ambientit)
  - "Jashtë" (vendose te vendi ku do të qëndrojnë nxënësit e eliminuar)
- Këngë adhurimi që përqendrohen te atributet e Perëndisë
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për "Kohën e zbulimit":

1. Mblidhi nxënësit në rreth dhe shpjegoju lojën:
   a. Bibla është një libër i madh, i përbërë nga shumë libra të vegjël. Libri më i gjatë i Biblës është libri i Psalmeve. Psalmet është një libër që shpreh se si ndihen shkruesit – mirë, keq, të trishtuar, të gëzuar, e shumë më tepër! Kur lexojmë Psalmet shohim se mund ta adhurojmë Perëndinë kudo. Sot do të luajmë një lojë të shpejtë që na e kujton këtë.
   b. Kur të them një deklaratë/komandë, ju do të keni pesë sekonda kohë për ta kryer shpejt veprimin. Nxënësit që e përfundojnë të fundit do të përjashtohen nga raundi; do të shkoni te zona "jashtë" dhe do të jeni tifozë për shokët derisa

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

të vijë raundi tjetër. Kur të kenë mbetur vetëm pak nxënës në lojë, do të marrin etiketat shpërblyese dhe do të nisim me raundin e ri.

c. Shpjegoju deklaratat/komandat:
   - "Ne mund ta adhurojmë Perëndinë në _____!" (thuaj një nga vendndodhjet e katër cepave – kisha, shtëpia, shkolla apo parku; nxënësit kanë pesë sekonda kohë për të vrapuar deri atje)
   - "Ne mund ta adhurojmë Perëndinë kudo!" (Nxënësit duhet të ulen menjëherë në gjunjë)
   - "Adhurim në veprim!" (bëni një pushim të shkurtër dhe vendos një këngë të shkurtër; të gjithë nxënësit – përfshirë edhe ata që janë "jashtë" – duhet të ndalojnë dhe të bëjnë veprimet e këngës; askush nuk eliminohet në këtë komandë)
   - "Mund ta adhurojmë Perëndinë kur ndihemi të _____!" (thuaj një emocion – të lumtur, të trishtuar, të zemëruar, të trembur, etj.; nxënësit kanë pesë sekonda kohë të vrapojnë në mes për të bërë mimikën që përkon me emocionin)

2. Mbaj ritëm të shpejtë për aktivitetin. Thuaji komandat shpejt dhe ngatërro radhën e tyre.
3. Drejtuesit e tjerë duhet të luajnë rolin e "arbitrit", duke parë se cilët janë nxënësit që e kryejnë të fundit komandën dhe pastaj t'i çojnë te zona "jashtë".
4. Vazhdoji komandat derisa të mbeten tre deri në pesë nxënës. Ata do të marrin nga dy etiketa shpërblyese secili.
5. Bonus: Jepu nga një etiketë shpërblyese nxënësve në zonën "Jashtë" që brohorasin për ata që janë ende në lojë.
6. Përsërite raundin nëse keni kohë.

Alternativa 3: Koha e zbulimit: A gjendet te Psalmet?

Qëllimi: T'i nxisim nxënësit të mendojnë për temat e ndryshme që mbulon libri i Psalmeve.

Shënim: *Ky aktivitet është më i përshtatshëm për nxënësit pak më të rritur.*

Mundësi alternative: *Përdore këtë aktivitet si "Lojë përsëritjeje" në fund të mësimit. Nëse keni hapësirë, njërën anë të dhomës caktoje si pjesën "Po" dhe tjetrën si pjesën "Jo". Nëse hapësira që keni është e vogël, jepi çdo nxënësi nga një pjatë plastike, ku në njërën anë shkruhet "Po", ndërsa në tjetrën "Jo". Në këtë rast, ata qëndrojnë ulur dhe ngrenë lart përgjigjen e tyre. Nxënësit që japin përgjigjen e gabuar dalin anash dhe presin raundin e ardhshëm.*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Vendndodhja: Hapësirë e madhe

Mjetet:

- Dy tabela/kartonë të mëdha: "PO" dhe "JO" (vendosur në dy anët e kundërta të hapësirës suaj)
- Zile ose bori e madhe (që të dëgjohet në të gjithë dhomën)
- Listë me pyetje (shiko më poshtë)

Udhëzime për "Kohën e zbulimit":

1. Mblidhi nxënësit në rreth për t'u shpjeguar lojën:
   a. Kujtoni se Bibla është një libër i madh i përbërë nga shumë libra të vegjël. Cili është libri më i gjatë i Biblës? (Psalmet) Psalmet është një libër që shpreh se si ndihet shkruesi – mirë, keq, i trishtuar, i gëzuar, dhe shumë më tepër! Do të luajmë një lojë, ku ju do të hamendësoni se çfarë shkruhet te libri i Psalmeve.
   b. Unë do t'ju bëj disa pyetje "Po/Jo" dhe ju do ta zgjidhni përgjigjen duke vrapuar në vendin e caktuar.
   c. Nëse vraponi drejt përgjigjes së gabuar, do të përjashtoheni nga raundi.
   d. Do të luajmë dy raunde, secili me 10 pyetje. Pas çdo raundi, nxënësit e mbetur në lojë do të fitojnë nga dy etiketa shpërblyese secili. Nxënësit që u eliminuan në raundin e parë do të ribashkohen për raundin e dytë.
2. Udhëzoji nxënësit të shpërndahen nëpër zonën e caktuar pastaj fillo leximin e deklaratave të mëposhtme dhe pas secilës pyeti: "A gjendet në librin e Psalmeve?"
3. Nxënësit do të kenë 10 sekonda kohë për ta marrë vendimin dhe për të zgjedhur anën e dhomës ku do të shkojnë. Kur t'i biesh ziles/borisë, nxënësit duhet të ngrijnë.
4. Tregoju përgjigjen e duhur (po ose jo).
5. Nxënësit që kanë zgjedhur përgjigjen e gabuar, përjashtohen.
6. Vazhdo derisa t'i kesh bërë 10 pyetjet, pastaj jepu etiketat shpërblyese. Përsërite aktivitetin me 10 pyetjet e mbetura.

Shënim: *Nuk duhet t'i lexosh referencat apo vargjet gjatë lojës, por mund t'i përsërisësh paraprakisht në rast se ka pyetje.*

Pyetjet e raundit 1:

1. Adhurimi i Perëndisë me gjithçka që kemi. A gjendet te Psalmet? (Po; Psalmi 86:12)
2. Lloji i ushqimit që Perëndia shijon. A gjendet te Psalmet? (Jo)
3. Profeti Jona. A gjendet te Psalmet? (Jo)
4. Të kërkosh falje. A gjendet te Psalmet? (Po; Psalmi 25:11)
5. Të falënderosh Perëndinë. A gjendet te Psalmet? (Po, Psalmi 136:26, Psalmi 75:1)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

6. Jezusi lindi në Bethlehem dhe emri i nënës së tij ishte Mari. A gjendet te Psalmet? (Jo)
7. Rëndësia e të qenët i duruar. A gjendet te Psalmet? (Po, Psalmi 37:7)
8. Dallgët e detit. A gjendet te Psalmet? (Po; Psalmi 93:3-4)
9. Si të përballemi me trishtimin. A gjendet te Psalmet? (Po; Psalmi 34:18)
10. Duhet të inkurajojmë të tjerët. A gjendet te Psalmet? (Po; Psalmi 10:17)

Pyetjet e raundit 2:

11. Tema e sëmundjeve. A gjendet te Psalmet? (Po; Psalmi 41:3-4)
12. Rëndësia e pagëzimit. A gjendet te Psalmet? (Jo)
13. Gëzimi. A gjendet te Psalmet? (Po; Psalmi 95:1-2)
14. Forca. A gjendet te Psalmet? (Po; Psalmi 84:5)
15. Admirimi i Perëndisë për shkak se Ai është Krijuesi. A gjendet te Psalmet? (Po; Psalmi 146:6)
16. Paralajmërim se shumë kohë para ekranit është keq për zemrën dhe mendjen. A gjendet te Psalmet? (Jo)
17. Durimi. A gjendet te Psalmet? (Po; Psalmi 27:14)
18. Rëndësia e gjumit të mjaftueshëm çdo natë. A gjendet te Psalmet? (Jo)
19. Historia e Abrahamit dhe bijve të tij? A gjendet te Psalmet? (Jo)
20. Bindja. A gjendet te Psalmet? (Po; Psalmi 119:35-36)

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – Lidhja e KZ-së me mësimin: **Alternativa 1 e KZ-së:** Gjatë "Kohës së zbulimit" sot përdorët njohuritë që kishit për Perëndinë, që të krijonit një vepër të bukur arti për t'u treguar të tjerëve se kush është Perëndia. Kjo është një nga mënyrat se si e adhurojmë Perëndinë! Sot do të mësojmë për një libër në Bibël që flet vetëm për adhurimin. Libri i Psalmeve na ndihmon të mësojmë se mund të shkojmë para Perëndisë, pavarësisht se çfarë po na ndodh apo si po ndihemi dhe t'i thërrasim Atij përmes këngëve, fjalëve dhe veprimeve.

Alternativa 2 e KZ-së: Gjatë "Kohës së zbulimit" sot mësuam se mund ta adhurojmë Perëndinë kudo! Sot do të mësojmë për një libër në Bibël që flet vetëm për adhurimin. Libri i Psalmeve na ndihmon të mësojmë se mund të shkojmë para Perëndisë, pavarësisht se çfarë po na ndodh apo si ndihemi, dhe t'i thërrasim Atij përmes këngëve, fjalëve dhe veprimeve.

Alternativa 3 e KZ-së: Gjatë "Kohës së zbulimit" sot, hamendësuat se çfarë përfshihej ose jo në librin e Psalmeve. Sot do të zbulojmë shumë për Psalmet. Ky libër na ndihmon të mësojmë se mund të shkojmë para Perëndisë, pavarësisht se çfarë po na ndodh apo si ndihemi, dhe t'i thërrasim Atij përmes këngëve, fjalëve dhe veprimeve.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Lutu: *Inkurajo njërin nga nxënësit ta udhëheqë klasën në lutje. Kjo do t'i mësojë të luten në ambiente publike dhe të zhvillojnë aftësitë e udhëheqësisë frymërore.*

Zbuloje: A gjenden Psalmet te Dhiata e Vjetër apo te Dhiata e Re? (Dh.V.) Libri i Psalmeve është në mes të Biblës, pak para gjysmës. *Tregojua duke hapur Biblën tënde në mes. Inkurajoji të përdorin Biblat e tyre. Sfidoji të gjejnë faqen e parë dhe faqen e fundit të Psalmeve, duke mbajtur të gjitha faqet bashkë. Kështu do të mund të shohin se sa faqe nga e tërë Bibla zënë Psalmet.* Është një pjesë e mirë e Biblës. Ka 150 kapituj në librin e Psalmeve – kjo e bën atë librin më të gjatë të Biblës. Psalmet duhet të jenë të rëndësishme nëse u dedikohet një pjesë kaq e mirë e Biblës!

Kronologjia: Nuk e gjejmë librin e Psalmeve në kronologjinë tonë për shkak se është shkruar përgjatë shumë viteve, nga shumë njerëz të ndryshëm. Dimë që është shkruar gjatë Dhiatës së Vjetër. *Drejtohu te Dhiata e Vjetër në kronologji.* Dimë gjithashtu se mbreti David shkroi ose gjysmën e psalmeve, ose dikush i shkroi në nderim të tij. A e shihni mbretin David në kronologji? Nxënësit duhet të tregojnë mbretin David. Gjysma tjetër e Psalmeve u shkruajt nga shumë njerëz të ndryshëm – Moisiu (*trego Moisiun në kronologji*), biri i Davidit, Solomoni (*trego Solomonin në kronologji*) dhe Asafi (*një drejtues adhurimi, i caktuar nga mbreti David*). Psalmet e fundit janë shkruar gjatë kohës së Ezdrës (*trego Ezdrën në kronologji*). Shiko se sa shumë mbulojnë Psalmet nga kronologjia! U desh një kohë e gjatë për t'i mbledhur të gjitha këngët që gjenden te Psalmet.

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Fjala "psalm" do të thotë një këngë që zakonisht këndohet me instrumente muzikore. Këngët shkruhen për tema të ndryshme, dhe këngët e Psalmeve po njësoj. Ato janë shkruar për tema të ndryshme. Nuk kemi meloditë e tyre, por vargjet janë tekstet. Çdo psalm pikturon një pamje me fjalë, që të mund ta gjesh veten tek ajo që po përjeton shkruesi. Shkruesit e këtyre këngëve dhe poemave ndonjëherë ndihen të trishtuar, ndonjëherë të zemëruar, ndonjëherë të hutuar dhe ndonjëherë të lumtur – mirëpo, pavarësisht ndjenjave të tyre, ata zgjidhnin të adhuronin Perëndinë e t'i bindeshin Atij. Këto këngë dhe poema janë shkruar për të adhuruar Perëndinë.

Alternativë: Për nxënësit më të rritur
<u>Llojet e ndryshme të Psalmeve!</u>
Shënim për mësuesin kryesor: Për t'i ndihmuar nxënësit të përpunojnë informacionin e mëposhtëm, shkruaji llojet e psalmeve (zhanret) paraprakisht në tabelë.

Njëri kapitull i Psalmeve mund të kremtojë Perëndinë, i Cili krijoi gjithçka. Kapitulli tjetër mund të flasë për nevojën e faljes. Pastaj, kthen faqen dhe kapitulli pasardhës është i mbushur me fjalë të bukura që adhurojnë Perëndinë. Këto janë disa nga kategoritë kryesore të psalmeve:

- **Falënderim**. Ka psalme falënderimi që i tregojnë Perëndisë se sa mirënjohës ishin ata për Perëndinë dhe për gjithçka që Ai ka krijuar dhe bërë.
- **Lavdërim dhe adhurim.** Shumë nga psalmet janë shkruar si pjesë e adhurimit, duke lavdëruar Perëndinë e duke shpallur madhështinë e Tij. Ato nxjerrin në pah se Perëndia është Perëndia i vërtetë dhe i vetmi që meriton adhurimin tonë.
- **Ankesa.** Kjo mund të jetë fjalë e re. "Të ankohesh" do të thotë të qahesh, të shpreshësh trishtim ose të vajtosh. Kur i lexon këto psalme, ndien zemrën e thyer të personit që e ka shkruar. Shkruesi e fton Perëndinë të jetë pjesë e trishtimit të tij dhe ta ndihmojë ta kalojë.
- **Falje.** Disa nga psalmet përqendrohen te nevoja e shkruesit për falje. Ato rrëfejnë mëkatin e mosbindjes ndaj Perëndisë dhe i kërkojnë që Ai ta falë atë mëkat.
- **Ndihmë.** Shpeshherë gjendemi në telashe dhe nuk dimë se çfarë të bëjmë. Do të bindeshim po ta dinim se si. Mund të shkojmë te Perëndia dhe t'i kërkojmë Atij ndihmë për t'u përballur me çfarëdolloj gjëje që duket sikur po na mbyt, dhe Fjala e Tij do të na udhëheqë. Shumë nga psalmet janë "të lutem, më ndihmo Zot".

Ka disa psalme që nuk duket se i përkasin asnjë prej këtyre kategorive, por shumica janë për falënderim, lavdërim dhe adhurim, ankim, falje ose ndihmë.

Përvijimi i Shkrimit

<u>Të hedhim themelin – çfarë dimë për Perëndinë</u>

Kur ne adhurojmë Perëndinë, po e falënderojmë për Atë që është dhe po i kujtojmë vetes çfarë dimë për Perëndinë. Le të mendojmë pak se çfarë dimë për Perëndinë.

<u>Ne dimë se Perëndia është i besueshëm</u>

Së pari dimë se mund t'i besojmë Perëndisë. Ai është i BESUESHËM. Çfarë do të thotë të jesh i besueshëm? Do të thotë se kur thua se do ta bësh diçka, e bën. Do të thotë se të tjerët mund të kenë besim tek ti. Do të thotë se, po t'ju them se do t'ju jap një biskotë (*ose zgjidh diçka tjetër që mund t'ua japësh – edhe diçka që ata nuk presin se ti do ta bësh*), unë do ta bëj. *Jepua nxënësve biskotën, apo çfarëdo që u premtove.*

Çfarë nënkuptojmë kur themi se Perëndia është i besueshëm? Duam të themi se Ai i mban gjithmonë premtimet. Ai nuk gënjen kurrë. Një nga premtimet e Perëndisë ishte se do të na dërgonte një Shpëtimtar. A e bëri Ai? (Po, Ai dërgoi

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Jezusin!) Ky është vetëm njëri nga premtimet e përmbushura që vërteton se Perëndia është i besueshëm.

Le të lexojmë Psalmin 9:10a. Ky varg na mëson se Perëndia është i besueshëm.
Lexo Psalmin 9:10a.

Në një karton apo fletë të madhe, shkruaj "I BESUESHËM".

Ne e dimë se Perëndia është i fuqishëm

Së dyti, ne dimë se Perëndia është I FUQISHËM.

Nga e di se Perëndia është i fuqishëm? E dimë se është i fuqishëm për shkak se Bibla na tregon për gjërat e mrekullueshme dhe të fuqishme që bën Perëndia. Perëndia krijoi gjithë botën. Disa vende në universin tonë janë të mrekullueshme – na ndihmojnë të kujtojmë se sa i fuqishëm është Perëndia: oqeani, galaksitë, kanionet e mëdha dhe malet e larta. Tregoju nxënësve foto të këtyre vendeve ndërsa flet për to.

Vetëm Perëndia ynë i fuqishëm mund t'i krijonte këto vende të mrekullueshme dhe të bukura!

A ju kujtohet kur mësuam se Jezusi ringjalli Llazarin? Edhe ai rast na tregoi për fuqinë e Tij.

Le të lexojmë Psalmin 68:35. Ky varg na mëson se Perëndia është i fuqishëm.

Lexo Psalmin 68:35.
Në një letër/karton të madh, shkruaj "I FUQISHËM"

Ne e dimë se Perëndia është i dashur

Ne gjithashtu dimë se Perëndia është I DASHUR. Nga e di ti që Perëndia të do? Unë e di se Perëndia më do për shkak se dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezu Krishtin, që të më shpëtonte. Gjoni 3:16 ma thotë këtë! Di gjithashtu se Perëndia nuk më rri larg. Mos harroni se, kur e pranojmë Jezusin si Shpëtimtarin tonë, Fryma e Shenjtë vjen të banojë brenda nesh. Kjo do të thotë se Perëndia është gjithnjë me mua. Ai është pranë meje. Ai më dëgjon. Ai më do, pavarësisht se si ndihem. *Mundësi për të shpallur Ungjillin duke përdorur "Librin pa fjalë" dhe për të bërë ftesë për shpëtim.*

Le të lexojmë Psalmin 103:8. Ky varg na mëson se Perëndia është i dashur.

Lexo Psalmin 103:8

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Në një fletë/karton të madh shkruaj "I DASHUR", pastaj vendosi të tre kartoni mbi njëri-tjetrin.

Psalmet janë këngë adhurimi dhe poema

Ne e dimë se Perëndia është i besueshëm, i fuqishëm dhe i dashur. Shkrimtarët e psalmeve e dinin këtë gjë për Perëndinë dhe i përdorën njohuritë e tyre për të shkruar këngë dhe poema. Le të lexojmë së bashku një psalm.

Lexoni Psalmin 100

Si e përshkruan ky psalm Perëndinë?

1. Thotë se Perëndia është Krijuesi ynë. (Ai është i fuqishëm!)
2. Thotë se i përkasim Perëndisë dhe Ai do të kujdeset për ne si një bari që kujdeset për delet e veta. (Ai është i besueshëm!)
3. Thotë se Perëndia është i mirë dhe se dashuria e Tij zgjat përgjithmonë. (Ai është i dashur!)

Perëndia do që ne t'i shprehim Atij emocionet tona

Shënim: Nëse po përdor pjatat plastike, jepua nxënësve dhe shpjegoju aktivitetin.

Si ndihesh kur dëgjon Psalmin 100? Kërkoju nxënësve të ngrenë lart pjatat. Mua më jep gëzim! Ndihem i lumtur dhe se më duan, kur kujtoj se kush është Perëndia. Gëzimi është ndjenjë e mirë, apo jo? E po, Perëndia do që të shkojmë tek Ai kur ndiejmë gëzim. Pse? Për shkak se Ai të do dhe dëshiron ta ndajë atë gëzim me ty!

Megjithatë, nuk ndihemi përherë të gëzuar, apo jo? Ndonjëherë jemi të hutuar, të trishtuar ose të frikësuar. Ka psalme edhe për ato ndjenja.

Do t'ju lexoj disa vargje nga psalme të ndryshme për rastet kur ndihemi të frikësuar, të trishtuar apo të hutuar.

Lexo Psalmin 23:4; *pastaj kërkoju nxënësve të ngrenë lart pjatat*
Psalmi 23 është një psalm shumë i mirë për ta lexuar kur ndihesh i frikësuar. Na ndihmon të kujtojmë se Perëndia është Bariu ynë dhe se Ai është gjithmonë me ne.

Lexo Psalmin 130:1-2; *pastaj kërkoju nxënësve të ngrenë lart pjatat*
Në këtë psalm, shkruesi po thërret Perëndinë. Ai ndihet i trishtuar dhe po i kërkon Perëndisë ta dëgjojë dhe t'i gjendet pranë.

Lexo Psalmin 121:1-2; *pastaj kërkoju nxënësve të ngrenë lart pjatat*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Nëse ndihesh i hutuar, Psalmi 121 mund të na ndihmojë të kujtojmë se Perëndia është gjithmonë me ne dhe është i gatshëm të na ndihmojë.

Edhe pse ndjesitë e trishtimit, frikës apo hutimit nuk janë të pëlqyeshme, gjithsesi i përjetojmë, mirëpo Perëndia do që ne të shkojmë tek Ai me ndjesitë tona. Përse? Sepse Ai na do dhe dëshiron të na ngushëllojë. Perëndia na do dhe na dëgjon në çdo kohë. Si ndihesh për këtë? Kërkoju nxënësve të ngrenë pjatat lart.

Shkruesit e Psalmeve e dinin këtë! Secili prej psalmeve është shkruar nga një person që shpreh se si po ndihej në atë moment. Janë 150 kapituj ku njerëzit tregohen plotësisht të sinqertë me Perëndinë për jetën. Pa shtirje! Ata po i tregojnë Perëndisë se ç'kanë në mendje dhe në zemër. Perëndia te Psalmet përshkruhet si një Perëndi personal, i cili interesohet për gjërat që na gëzojnë vërtet... (*kërkoju nxënësve të ngrenë pjatat lart*) dhe për gjërat që na bëjnë të qajmë prej trishtimit të zemrës... (*kërkoju nxënësve të ngrenë pjatat lart*) dhe për gjërat që na bëjnë të mbledhim grushtat nga acarimi (*kërkoju nxënësve të ngrenë pjatat lart*). Ai është Perëndia të cilit mund t'i lutemi për ndihmë. Të gjitha këto – gëzimi, trishtimi, acarimi – mund të jenë të kënaqshme për Perëndinë, nëse reagojmë ndaj ndjesive duke i shërbyer Atij me bindje të plotë, pavarësisht situatës. Le ta lexojmë Psalmin 19:14.

Lexo Psalmin 19:14; *kërkoju nxënësve të ngrenë lart pjatat.*
A e dëgjuat? Ky person kërkon me zell që, çdo gjë që ka zemra e tij të jetë e pëlqyeshme për Perëndinë, edhe në kohët e mira, edhe në kohët e vështira.

Kur ndihemi të trishtuar apo të hutuar (*kërkoju nxënësve të ngrenë lart pjatat*), ne gjithsesi zgjedhim t'i bindemi Perëndisë, sepse e dimë se Ai është me ne dhe se na do (*kërkoju nxënësve të ngrenë lart pjatat*).

Përfundimi

Kur kalojmë kohë me librin e Psalmeve, kujtojmë se mund të shkojmë gjithmonë te Perëndia. Ai na dëgjon e na do në çdo kohë, pavarësisht se si ndihemi. Për shkak se e dimë që mund t'i besojmë gjithmonë Atij, mund t'i bindemi, pavarësisht se si ndihemi. Ashtu si shkruesit e Psalmeve, ne mund t'i besojmë Perëndisë tonë të mirë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

“Vepro si duhet” dhe “Ndihu si duhet”

Prandaj, kur të ndihesh i acaruar, i lumtur, i trishtuar, i zemëruar apo me çfarëdo ndjesie tjetër, vepro kështu:

1. Pyete veten: Çfarë di unë për Perëndinë?
2. Lexo një psalm. Kujto se njerëzit e tjerë që e donin Perëndinë dhe i bindeshin, ndiheshin njësoj si ti! Këngët dhe poemat që ata i shkruan Perëndisë, mund të na ndihmojnë edhe neve ta adhurojmë Perëndinë!
3. Në fund, zgjidh t’i bindesh Perëndisë për shkak se e di që Ai është i mirë dhe se mund t’i besosh.

Le të lutemi dhe ta falënderojmë Perëndinë, sepse është gjithnjë i besueshëm, i fuqishëm dhe i dashur. *Mbylle me lutje.*

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t’i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. A gjenden Psalmet në Dhiatën e Re apo në Dhiatën e Vjetër? (Dh.V.)
2. Çfarë është një psalm? (Një këngë apo poemë që adhuron Perëndinë)
3. Cila është mënyra më e mirë për t’i gjetur Psalmet kur hap Biblën? (Shko në mes të saj)
4. Përmend disa persona që shkruan këngë dhe poema adhurimi për Perëndinë? (Moisiu, mbreti David, mbreti Solomon, etj.)
5. Sa kapituj kanë Psalmet? (150)
6. A mund t’i bindesh Perëndisë edhe kur je i zemëruar apo i trishtuar? Pse? (Po, për shkak se e dimë që Ai është i mirë dhe mund t’i besojmë Atij)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Harta e gjurmuesit
Mësimi tematik: Kur ndodh tragjedia

Kupto si duhet:	Perëndia është streha dhe ndihma jonë në kohë fatkeqësie.
Mendo si duhet:	"ZOTI i ushtrive është me ne; Perëndia i Jakobit është streha jonë." Psalmi 46:11
Vepro si duhet:	Unë do t'i drejtohem Perëndisë në kohë fatkeqësie.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem mirë kur shkoj te Perëndia.

PËRGATITU!

Fatkeqësitë dhe humbjet na e thyejnë zemrën. Shpeshherë nuk e kuptojmë se përse ndodhin gjërat e tmerrshme në botën tonë dhe duam që Perëndia t'i ndreqë. Kur bota errësohet dhe na mbush me hidhërim, mund të gjejmë ngushëllim, duke ditur se Perëndia është afër. Psalmi 46:1 na kujton se, në çdo kohë, mund të mbështetemi te Perëndia si streha, forca dhe ndihma jonë. Këtë javë do ta ndajmë këtë shpresë me nxënësit tanë. Ndërsa përgatitesh, lutu që paqja e përsosur e Perëndisë të të mbushë ty dhe nxënësit e tu. Kërkoji Atij të veprojë brenda secilit prej jush përmes Fjalës së Tij. E dimë se bota jonë është thyer prej mëkatit; kjo do të thotë se zemrat tona do të vazhdojnë të thyhen nga fatkeqësitë. Në momente të tilla mund të gjejmë ngushëllim te Perëndia, që është gjithmonë me ne.

Lutu: Lutu që nxënësit të ndiejnë vërtet thellësinë e dashurisë së Perëndisë për ta në këtë javë. Lutu që ta kërkojnë Atë si të vetmin burim ngushëllimi dhe force kur të përballen me sfidat e jetës. Lutu gjithashtu për të pashpëtuarit që ke në klasë. Para se të shkojmë te Perëndia si burim ngushëllimi dhe force në kohë të vështira, duhet të kemi një marrëdhënie me Të. Kjo do të thotë se duhet t'i dorëzohemi Jezusit si Zot dhe Shpëtimtar. Lutu që të pashpëtuarit të kenë zemrën e butë dhe të kuptojnë qartë mesazhin e Ungjillit dhe t'i përgjigjen thirrjes së Perëndisë në jetën e tyre.

Lexo: Psalmi 46

Kupto si duhet: Perëndia është streha dhe ndihma jonë në kohë fatkeqësie

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënime për mësuesin kryesor:

- Ndërsa përgatitesh për të shpjeguar një temë të vështirë:
  - Kalo kohë në lutje. Lutu që Perëndia të të bëjë të ndjeshëm ndaj nevojave të nxënësve dhe që Fryma e Shenjtë të flasë përmes teje. Lutu për paqe që ia tejkalon çdo njohurie (Filipianëve 4:7).
  - Ji i ndjeshëm ndaj moshës së nxënësve. Mos trego asgjë që nuk është e përshtatshme për moshën; mos ji specifik për llojet e fatkeqësive (veçse po të jesh duke e përdorur këtë mësim duke e lidhur me një fatkeqësi që ka prekur komunitetin tuaj). Fokusi i këtij mësimi është në forcën, praninë dhe ngushëllimin e Perëndisë gjatë kohëve të vështira, jo t'i trembim fëmijët.
  - Lexoje letrën e prindit që përfshihet me këtë mësim.
- Gjatë mësimit:
  - Nëse keni kaluar ndonjë ngjarje tragjike si komunitet, siguroji nxënësit se është shumë normale të ndiejnë frikë, zemërim apo trishtim. Këto ndjenja janë të natyshme dhe të përshtatshme në rrethana të tilla. Modeloje për ta ndarjen e ndjenjave me Perëndinë. Modeloju se si t'ua shprehin ndjenjat të afërmve. Mos i turpëro dhe as mos i zvogëlo ndjesitë e tyre. Fëmijët duhet të kenë mjaft hapësirë për të përpunuar emocionet e dhimbshme; kisha duhet të jetë ajo hapësirë.
  - Nëse ke fëmijë të vegjël: Kur fëmijët e vegjël përjetojnë rrethana të vështira, mund të ndihen (ose të jenë vërtet) të pasigurt. Mundohu të krijosh një ambient të sigurt për ta. Përgjatë mësimit thekso se janë të sigurt edhe në bisedat që po bëjnë dhe se janë të sigurt edhe brenda kësaj klase.
  - Nëse ke fëmijë më të rritur: Shndërroje klasën në një hapësirë ku nxënësit mund të ndajnë ndjesitë e tyre. Dëgjoji me vëmendje shqetësimet dhe frikërat e tyre dhe mos ki frikë kur nuk i ke të gjitha përgjigjet. Nëse nuk e ke përgjigjen për diçka, mund të thuash kështu:
    - "Nuk e di, por ky varg mund të të ndihmojë të gjesh paqe."
    - "A do të doje që të merrja pak më tepër informacion për këtë pyetje? Mund të kthehem javën e ardhshme me pak më tepër informacion."

Ide krijuese për mësimin biblik:

1. Jepu nga një fletë të bardhë të cilën do ta ngjyrosin ndërkohë që ti shpjegon. Ftoji ta ilustrojnë pasazhin që po u lexon.
2. Referoju shpeshherë posterin "Ndihu si duhet" përgjatë mësimit.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

3. Krijo një “fortesë/strehë” brenda klasës dhe uli brenda saj nxënësit kur të jesh duke shpjeguar mësimin.
4. Për nxënësit më të rritur: Printo paraprakisht Psalmin 46 dhe ftoji të nënvizojnë dhe të qarkojnë fjalë që u mbeten në mendje ndërsa e studioni pasazhin së bashku.
5. Disa ide krijuese për pjesë specifike të mësimit:
   - Përdor objekte me ngjyrat e “Librit pa fjalë” kur të shpallësh Ungjillin.
   - Përdor tinguj/regjistrim stuhie kur të lexosh vargjet 2-3.
   - Shkruaj paraprakisht në një fletë/karton: “Gjëra të vërteta që dimë për Perëndinë...”. Gjatë “Përfundimit” diskuto me nxënësit se çfarë dimë për Perëndinë nga këto vargje që studiuam. Ndihmësit mund t’i shënojnë gjërat që thotë nxënësit.



Shënim për mësuesin kryesor: Ju rekomandojmë që në mësim të përfshini një letër që u duhet dërguar prindërve në shtëpi. Aty shpjegoni se çfarë u diskutua në mësim, disa referenca nga Shkrimi dhe një sugjerim libri, si dhe inkurajojini prindërit t’i ruajnë letrat, që t’i lexojnë nëse familja apo komuniteti i tyre përballet me një fatkeqësi. Te shtojca do të gjeni një shembull. (buirm i printueshëm)

NISU!

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t’i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Streha jonë

Qëllimi: T’i prezantojmë nxënësit me konceptin e Perëndisë si **streha** jonë.

Shënim: Këto aktivitete të “Kohës së zbulimit” mund të zhvillohen si para, edhe pas mësimit.

<u>**Alternativa 1:** Stacioni i artit</u>

Mjetet:

- Karton me pikën “Kupto si duhet” në shkronja të mëdha (burim i printueshëm)
- Bojëra dhjami
- Bojëra uji
- Furça pikture
- Gota me ujë
- Muzikë adhurimi



Udhëzime për "Kohën e zbulimit":

1. Para se të shpërndash kartonin, pyeti nxënësit: "A e keni dëgjuar ndonjëherë fjalën **strehë**?" Nxiti të shpjegojnë kuptimin e saj.
2. Shpjego: Qëllimi i një vendi **strehimi** është t'i mbrojë njerëzit nga rreziku. Sot do të mësojmë se si Perëndia është **streha** jonë.
3. Shpërndaju kartonët dhe mjetet. Shpjegoju se duhet të vijëzojnë shkronjat me bojëra dhjami pastaj t'i mbushin me bojëra uji. Bojërat e dhjamit nuk do të lejojnë që boja e ujit të dalë nga shkronjat. Boja e dhjamit është si një strehë për bojën e ujit. Ajo e mbron.
4. Vendos muzikë në sfond ndërkohë që nxënësit punojnë me posterin.
5. Ndërsa punojnë, bëju këto pyetje:
   a. Çfarë gjërash ju frikësojnë?
   b. Çfarë gjërash ju trishtojnë?
   c. Kur mendoni se do të ishte mirë ta shihnit këtë poster?
   d. Ku do ta vendosni këtë poster?
   e. Çfarë dëshironi të kujtoni rreth Perëndisë kur keni frikë apo jeni të trishtuar?
6. Në fund të "Kohës së zbulimit", vendosini diku posterat që të thahen, pastaj, pas përfundimit të takimit, nxënësit mund t'i marrin me vete në shtëpi.

Alternativa 2: Hapësirë e madhe

Mjetet:

- Mjete për të bërë një fortesë (jastëkë, çarçafë, karrige, kuti, etj.)
- Ngjitës i fortë shirit (ndaje klasën/dhomën në dy apo tre zona, që skuadrat të kenë hapësirën e tyre)
- Etiketa shpërblyese
- Për nxënësit më të rritur:
  - vijë ndarëse;
  - topa sfungjeri

Udhëzime për "Kohën e Zbulimit":

1. Ndaji nxënësit në dy ose tre skuadra, duke i vendosur në hapësirën e caktuar për çdo skuadër.
2. Para se të shpjegosh aktivitetin, pyeti: "A e keni dëgjuar ndonjëherë fjalën **strehë**?" Nxiti nxënësit të shpjegojnë kuptimin e fjalës.
3. Shpjego: qëllimi i një vendi **strehimi** është mbrojtja e njerëzve nga rreziku. Sot do të mësojmë se Perëndia është **streha** jonë. Që ta kuptojmë më mirë idenë e "strehës", do të bëjmë një garë ndërtimi fortesash! Skuadra me fortesën më të mirë do të fitojë nga dy etiketa shpërblyese për secilin.
4. Jepu nxënësve rreth dhjetë minuta kohë për ta ndërtuar fortesën. Pasi të përfundojë koha, drejtuesit do të gjykojnë fortesat. Mund të bëni një lojë

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

topadjegësi, rreth tre minuta, ku nxënësit do të shohin se sa të qëndrueshme janë fortesat e tyre. Skuadra fituese merr nga dy etiketa shpërblyese për secilin.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – Lidhja e KZ-së me mësimin: Gjatë "Kohës së zbulimit" mësuam për fjalën **strehë**. Streha është një vend ku mund të gjejmë siguri dhe mbrojtje. Perëndia është streha jonë!

Alternativa 1: Sot do të zbulojmë disa vargje nga Bibla që na mësojnë se Perëndia është streha jonë. Kjo është diçka që duhet të duam ta dimë e ta kujtojmë: Perëndia është gjithmonë me ne dhe ai është mburoja jonë. Prandaj i kemi bërë këto postera... që të na ndihmojnë të kujtojmë!

Alternativa 2: Keni ndërtuar fortesa shumë krijuese sot. Fortesa është një vend ku shkojmë për mbrojtje. Një tjetër fjalë për të është "strehë"! Kur përjetojmë diçka të frikshme apo të trishtë, mund të shkojmë te Perëndia, sepse Ai është streha jonë e sigurtë.

Shënim: Nëse nxënësit kanë përjetuar vende apo strehë të pasigurta, kujtoju se, meqenëse pasojat e mëkatit gjendet kudo në botë, Perëndia është e vetmja strehë e përsosur.

Lutu: *Kërkoji njërit prej nxënësve ta nisë mësimin me lutje. Kujtoju se kur lutemi, flasim me Perëndinë. Ai i dëgjon gjithmonë lutjet tona dhe Atij i pëlqen kur i drejtohemi në lutje.*

Zbuloje: A keni dëgjuar për librin e Psalmeve? Ky libër i Dhiatës së Vjetër është plot me poema, këngë adhurimi dhe lutje të shkruara nga njerëz të ndryshëm, në kohë të ndryshme. Disa Psalme janë këngë të gëzueshme adhurimi, disa të tjera janë shkruar nga persona që kishin frikë dhe kërkonin Perëndinë, dhe ka të tjerë që janë kujtesë e premtimeve të Perëndisë dhe të faktit që Ai na shpëtoi nga mëkati. Libri i Psalmeve gjendet në Dhiatën e Vjetër, midis Jobit dhe Fjalëve të Urta.

Për nxënësit më të rritur: Libri i Psalmeve është pjesë e atyre që i quajmë "Librat Poetikë" të Biblës. Këta libra – Jobi, Psalmet, Fjalët e Urta, Predikuesi dhe Kënga e Këngëve – janë plot me mësime të urta, me këngë e poezi që na ndihmojnë të mësojmë për Perëndinë dhe botën që Ai krijoi.

Kronologjia: Nuk po mësojmë për një ngjarje specifike në kronologji sot, mirëpo do të lexojmë vargje të shkruara nga njerëz që jetuar gjatë periudhës së Dhiatës së Vjetër. Cila pjesë e kronologjisë na tregon Dhiatën e Vjetër? *Kërkoju nxënësve të drejtohen te kronologjia.* Sot do të lexojmë nga Psalmi 46.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Për nxënësit më të rritur: Psalmi 46 u shkrua nga bijtë e Koreut. Këta burra ishin pasardhës të Levit, një prej bijve të Jakobit. A e shihni Jakobin dhe dymbëdhjetë bijtë e tij në kronologjinë tonë? *Kërkoju nxënësve të drejtohen te kronologjia.*

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Le të shohim fillimin e kronologjisë sonë. Te Zanafilla 1, Perëndia krijoi botën. Dhe bota ishte e përsosur! Ishte e mbushur me gjëra të bukura dhe të mira. Mirëpo, kjo nuk zgjati shumë për shkak se mëkati hyri në botë kur Adami dhe Eva nuk iu bindën Perëndisë. Çfarë është mëkati? (Gjithçka që mendojmë, themi ose bëjmë kundër Perëndisë)

Cila është pasoja e mëkatit? (Vdekja) *Shiko Romakëve 6:23.* Kjo nuk do të thotë thjesht që një ditë do të vdesim të gjithë; kjo do të thotë gjithashtu se bota jonë është e thyer. Ndonjëherë njerëzit sëmuren, ndonjëherë u bëjnë të këqija të tjerëve, ndonjëherë na thyhet lodra e preferuar dhe ndonjëherë, njerëzit që duam, ndërrojnë jetë. Këto gjëra janë të trishta dhe të frikshme. Çdo e keqe në botë ekziston për shkak të mëkatit.

Mirëpo, ka shpresë. Jezusi është plani i shpëtimit të Perëndisë! Ai erdhi për të falur mëkatin tënd e për të hequr ndëshkimin e tij. Ai është Shpëtimtari ynë. *Shih 1 e Gjonit 4:14; Gjoni 3:16; Gjoni 14:6.*

Çdo e mirë në botë është prej Jezusit. Kur Jezusi na shpëton, ne mund të besojmë se Ai do të jetë me ne dhe do të na ngushëllojë. Nga e di që Jezusi të ka shpëtuar? *Ftoji nxënësit të përgjigjen; përdore këtë mundësi për të shpallur Ungjillin dhe bëj ftesë për shpëtim.*

Në fund, Jezusi do të kthehet dhe do ta shkatërrojë mëkatin dhe vdekjen. Ato nuk do të ekzistojnë më! Dua t'ju lexoj diçka. Ky është një premtim nga Fjala e Perëndisë për kohën kur Jezusi do të shkatërrojë mëkatin dhe vdekjen. ***Lexo Zbulesa 21:4.*** Një ditë nuk do të ketë më lot, nuk do të ketë më gjëra të frikshme dhe nuk do të ketë më vdekje. Gjithçka do të jetë sërish e përsosur, siç ishte në fillim kur Perëndia e krijoi botën!

Derisa Jezusi të kthehet, do të ketë errësirë në botën tonë. Mëkati është ende këtu, që do të thotë se gjërat e këqija do të ndodhin. Në fakt, kur Jezusi jetoi në tokë, Ai përjetoi humbje dhe trishtim gjithashtu, edhe pse nuk mëkatoi kurrë. Shokët e Tij të ngushtë, Gjon Pagëzori dhe Llazari, vdiqën. Pati luftëra dhe vetë Jezusin e lënduan, e tallën dhe e vranë. Mirëpo, fundi është i lumtur, sepse Jezusi u ringjall dhe premtoi se do t'u japë fund gjithë të këqijave një ditë. Megjithatë, ne ndërkohë, kur ndodhin të këqijat, mund të jemi të sigurtë se Jezusi e kupton shumë mirë se si ndihemi.

Çfarë bëjmë kur përballemi me diçka të tmerrshme, të frikshme ose të trishtë? Dua t'ju prezantoj disa vargje nga Bibla që mund të jenë ngushëllim në ato raste.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përvijimi i Shkrimit: Psalmi 46

Edhe në situata të trishta, të rrezikshme apo të frikshme, Perëndia është streha dhe forca jonë

Lexo Psalmin 46:1-3

Përmbledhje: Çfarë ju vjen në mendje kur dëgjoni fjalën "strehë"? *Lejoji nxënësit të përgjigjen.* Kur gjendemi në një vend strehimi, qëllimi është të qëndrojmë të sigurt e të mbrojtur nga gjithçka që mund të jetë e rrezikshme ose e frikshme. Këto vargje e përshkruajnë Perëndinë si strehën tonë! Ato gjithashtu thonë se Ai është forca jonë dhe ndihma gjithnjë e gatshme. Çfarë mendoni kur dëgjoni këto fjalë përshkruese për Perëndinë? *Lejoji nxënësit të përgjigjen.*

Do t'i lexoj sërish vargjet 2-3. Dua që të mbyllni sytë e të imagjinoni sikur po shihni një video të kësaj që po lexoj. *Lexoji sërish vargjet 2-3.* Çfarë imagjinuat ndërsa lexova këto vargje? *Lejoji nxënësit të përgjigjen.* Si ndiheni? *Përdorni posterin "Ndihu si duhet" për t'i ndihmuar të përshkruajnë ndjesitë e tyre.*

Në këto vargje, shkruesi po përshkruan gjëra të frikshme, apo jo? Shkruesi po përpiqet të na tregojë se, kur duket sikur gjithçka rreth teje po shkatërrohet, Perëndia është i fortë dhe i sigurt, dhe Ai premton se do të jetë gjithmonë me ty. Perëndia e di se si ndihesh dhe Ai nuk do të të braktisë kurrë! Cilin varg nga 12 vargjet kyç të kujton kjo? (Jozueu 1:9)

Perëndia sjell paqe dhe drejtësi

Lexo Psalmin 46:4-6

Për nxënësit më të rritur: Çfarë kuptimi mendoni se kanë shprehjet "kombet do të ziejnë" dhe "mbretëritë do të tronditen"? (luftë, konflikt, zënka, pasiguri, etj.) A ndodhin këto gjëra edhe sot? (Po) *Nëse e sheh të përshtatshme, referoju ngjarjeve të kohëve të fundit, të cilat nxënësit më të rritur i dinë.*

Për të gjithë nxënësit: Edhe në situata të frikshme, si rastet e zënkave apo luftërave, ku është Perëndia? *Nxiti të përgjigjen; drejtoji te vargjet 4-5.* Perëndia është akoma këtu dhe Ai premton se do të sjellë paqe dhe drejtësi! Luftë nuk do të ketë gjithmonë, ndërsa Perëndia do të ketë gjithmonë kontrollin.

Perëndia ka qenë gjithmonë i njëjti dhe Ai është gjithmonë me ne

Lexo Psalmin 46:7

Përmbledhje: Kush është Perëndia i Jakobit? *Jepu mundësinë atyre të përgjigjen*. Le të kthehemi pas në kronologji. A adhuronte Jakobi të njëjtin Perëndi që adhurojmë edhe ne sot? (Po) Perëndia është gjithmonë i njëjti.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Ai ka qenë gjithnjë pranë popullit të Tij dhe Ai premton se do të jetë gjithnjë pranë tyre. Nëse e ke pranuar Jezusin si Shpëtimtarin tënde, ti je pjesë e popullit të Tij!

Kur e lexoj këtë varg ndihem i mbrojtur, i sigurt dhe mirënjohës. Si ndihesh kur e dëgjon këtë varg? *Përdor posterin "Ndihu si duhet" dhe nxiti nxënësit të përgjigjen.*

Perëndia lartësohet; kjo do të thotë se Ai është fitimtar

Lexo Psalmin 46:8-10

Përmbledhje: Këto vargje përshkruajnë se Perëndia është fitimtar. Çfarë do të thotë fjala "fitimtar"? *Nxiti nxënësit të përgjigjen.* Kur e përshkruajmë Perëndinë si fitimtar, nënkuptojmë se Ai gjithmonë e mposht mëkatin. Ai është më i fuqishëm dhe është gjithmonë në kontroll. A nuk është e mrekullueshme që ne njohim dhe duam Perëndinë fitimtar? Kur i drejtohemi Perëndisë në lutje, kemi sigurinë se Ai e ka fuqinë për t'i dëgjuar lutjet tona dhe për t'iu përgjigjur në mënyrën e duhur.

Te vargu 10, Perëndia thotë: "Ndaluni dhe pranoni që jam Perëndi..."

Përse mendoni se Perëndia do që të ndalemi dhe të pranojmë se Ai është Perëndi? *Nxiti të përgjigjen.* Kur ne ngadalësojmë dhe kujtojmë se kush është Perëndia, mund të mbushemi me guxim dhe shpresë. Ne kujtojmë se nuk jemi vetëm. Perëndia është gjithnjë me ne!

Për nxënësit më të rritur: Le të praktikojmë tani! Do t'ju jap një minutë kohë për t'u ndalur e për të kujtuar se çfarë kemi mësuar për Perëndinë. *Qëllimi i këtij ushtrimi është t'u japësh atyre mundësinë për të medituar paqësisht mbi Shkrimin. Kur të keni përfunduar, kërkoju të përshkruajnë se si ndihen (përdorni posterin "Ndihu si duhet" për ta nisur këtë bisedë).*

Perëndia premton se do të jetë me ne

Lexo Psalmin 46:11

Përmbledhje: Ky varg tingëllon i dëgjuar. A e gjeni dot se ku e kemi lexuar më parë? (vargu 7) Kur diçka në Bibël përsëritet, do të thotë se duhet t'i kushtojmë shumë vëmendje. Çfarë mendoni se duhet të mësojmë nga ky varg? *Nxiti nxënësit të përgjigjen.* Edhe në vendet më të errëta, të trishta e të frikshme, Perëndia premton të jetë me ne. Ai ka qenë gjithmonë i njëjti dhe ashtu do të jetë përjetësisht.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përfundimi

Çfarë të vërtetash mund të mësojmë për Perëndinë prej këtyre vargjeve? (Perëndia është me ne, Perëndia është i fuqishëm, Perëndia është i fortë, Perëndia është fortesa/streha/mburoja jonë, etj.)

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

Këto janë gjëra të rëndësishme për t'u kujtuar, sidomos në një botë të errët ku ndodhin gjëra të këqija. Ne zakonisht nuk e kuptojmë përse ndodhin gjërat e këqija; edhe sikur të bëjmë pyetjet e duhura, mund të mos e zbulojmë kurrë përsenë. Mirëpo, edhe po të ndihemi të hutuar apo të frikësuar, mund të kujtojmë se Perëndia premton të jetë me ne dhe të na ngushëllojë.

Alternativë, për nxënësit më të rritur: 1 e Korintasve 13:12 thotë se tani, edhe pse jetojmë në botën e thyer, i kuptojmë pjesërisht gjërat. Ky varg na thotë se realiteti i përngjan një pasqyre të mjegulluar – kur sheh drejt saj nuk dallon gjithçka. Ky varg na thotë se në të ardhmen, kur të jemi me Perëndinë, do të kuptojmë gjithçka qartësisht. Për tani, mund të besojmë se Perëndia di gjithçka dhe ka planin më të mirë për ne.
Lutuni së bashku për të përfunduar.

Shpërndaju letrat që do t'ua japin prindërve.

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Çfarë do të thotë fjala "strehë"? (Një vend sigurie/mbrojtjeje)
2. Perëndia është për ne një _____ dhe një _____. (strehë, forcë)
3. Nga cili libër i Biblës lexuam sot? (Psalmet)
4. Përse është e thyer bota jonë? (Për shkak të mëkatit)
5. Çfarë dimë për Perëndinë nga vargjet që studiuam sot? (Perëndia është me ne, Perëndia është i fuqishëm, Perëndia është i fortë, Perëndia është streha/fortesa/mburoja jonë, etj.)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Harta e gjurmuesit
Mësimi tematik: Kisha

Kupto si duhet:	Kisha përbëhet nga njerëz që ndjekin Jezusin dhe përlëvdojnë Perëndinë së bashku.
Mendo si duhet:	"Dhe ju jeni trupi i Krishtit dhe gjymtyrët e tij, veç e veç." 1 e Korintasve 12:27
Vepro si duhet:	Si pjesë e kishës, unë do të përlëvdoj Perëndinë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i gëzuar kur përlëvdoj Perëndinë.

PËRGATITU!

Në këtë mësim duam t'i ndihmojmë nxënësit të kuptojnë se, kur Bibla i referohet kishës, nuk i referohet një ndërtese. Ky është një koncept shumë i rëndësishëm për t'u rrokur dhe ndryshon nga ajo që nënkupton zakonisht shoqëria kur flet për kishën. Kisha përbëhet nga njerëz që besojnë në Jezusin dhe e ndjekin Atë – *ne* jemi kisha! Në fakt, Bibla shpeshherë e quan kishën "trupi". Të qenët pjesë e trupit të kishës dhe përlëvdimi i Perëndisë është një dhuratë e madhe për besimtarët në Jezusin!

Lutu: Lutu që Perëndia të të ndihmojë ta kuptosh qartë Shkrimin dhe që nxënësit të kuptojnë se njerëzit janë kisha. Lutu gjithashtu për ata që nuk janë të shpëtuar – mund të marrin pjesë në takimet brenda një ndërtese kishe pa qenë pjesë e kishës. Lutu që edhe ata të bëhen sot pjesë e kishës.

Lexo: 1 e Korintasve 12:27

Kupto si duhet: Kisha përbëhet nga njerëz që ndjekin Jezusin dhe përlëvdojnë Perëndinë së bashku

BËHU GATI!

Shënime për mësuesin kryesor:

- Ne duam t'i ndihmojmë nxënësit të kalojnë nga të kuptuarit e kishës si një vendndodhje te diçka në të cilën janë vetë pjesë. Ky është një ndryshim i madh e i rëndësishëm! Kisha si vendndodhje nuk e përfshin pjesëmarrjen e tyre. Nuk kërkon një zgjedhje nga ana e tyre. Nuk lëviz apo merr frymë. Nuk merr

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

dashurinë e Perëndisë. Perëndia nuk do ndërtesën e as të ketë marrëdhënie me të.

- Kisha filloi në Dhiatën e Re pasi Jezusi u largua nga kjo tokë.
- Të përlëvdosh do të thotë të lavdërosh dhe të adhurosh Perëndinë me mendimet, fjalët dhe veprimet.

Ide krijuese për mësimin biblik: Merr me vete çadrën më të madhe që mundesh. Sa më e madhe të jetë çadra, aq më ndikim do të ketë. Bëj një shënim mbi çadër që thotë: Përlëvdo Perëndinë. Bëj gjashtë shënime më të vogla që thonë: Mblidhuni rregullisht, adhuroni, lutuni, jetoni në përbashkësi, Ndihmoni të tjerët dhe shtojini besimtarëve. Vendosi gjashtë shënimet në litar dhe ngjiti nën çadër ndërsa shpjegon mësimin. Nëse çadra nuk qëndron vetë, kërkoji një ndihmësi ta mbajë ndërkohë që ti drejton mësimin. *Këtë ide do ta gjeni edhe në mësim.*

NISU!

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Kisha nuk është një ndërtesë!

Qëllimi: T'u japim nxënësve një pamje të kishës që bashkëpunon për të arritur një qëllim.

Alternativa 1: Ambient i hapur

Mjetet:

- Kuti kartoni – sa më tepër, aq më mirë!
- Ngjitës i fortë shirit
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për "Kohën e zbulimit":

1. Ndaji nxënësit në skuadra me tetë deri në dhjetë nxënës.
2. Vendosi kutitë mbi njëra-tjetrën (sa më tepër, aq më mirë!), 6 metra larg katrorëve të bërë me ngjitësin e fortë shirit.
3. Kërkoju nxënësve të qëndrojnë në rresht nga kutitë te katrori i skuadrës.
4. Sfidoj skuadrat të bëjnë ndërtesën e kishës si skuadër.
5. Skuadra duhet t'i kalojë dorë më dorë kutitë nga kutitë te ndërtuesi që gjendet në fund të vijës (i cili do t'i vendosë kutitë). Pasi të ndërtohet një shtresë me kutitë, ndërtuesin çoje të fillim të rreshtit. Përsërit të njëjtën gjë për çdo shtresë.
6. Skuadra me ndërtesën më të mirë të kishës (e drejtë dhe e lartë) fiton nga tre etiketa shpërblyese për çdo person.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Ide alternative: Nëse keni hapësirë të kufizuar, merrini këto objekte dhe kërkoju nxënësve të krijojnë një "fortesë" që mund të përfaqësojë ndërtesën e kishës: çarçafë, mushama, tuba, etj. Lejoji nxënësit të punojnë si skuadër për të ndërtuar kishën.

Alternativa 2: Ambient i hapur

Mjetet:

- Topa ushtrimesh (nga një për çdo skuadër)
- Mur
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për "Kohën e zbulimit":

1. Ndaji nxënësit në skuadra me nga dhjetë persona (ose përshtate numrin në varësi të gjatësisë së murit).
2. Secila skuadër nxënësish do të shtrihet në tokë, në rresht, me këmbët te muri. Këmbët duhet të jenë të përthyera. Nxënësit duhet të jenë të paktën 60cm larg njëri--tjetrit, nuk mund ta prekin njëri-tjetrin.
3. Vendose topin në fillim të rreshtit midis murit dhe këmbëve të personit të parë. Topi nuk duhet ta prekë tokën.
4. Topi i madh duhet të kalojë nëpër rreshtin e nxënësve dhe të kthehet mbrapsht.
5. Nëse topi bie dhe prek tokën, kthehet nga fillimi.
6. Grupi i parë që e përfundon sfidën, fiton nga tre etiketa shpërblyese për secilin.
7. Përsëriteni disa herë.

Shënim: Nëse ka vajza me funde apo fustane, përshtateni dhe mund të luani duke e kaluar topin sipër kokë, pa mbështetje te muri.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – Lidhja e KZ-së me mësimin: Ndërsa punonit si skuadër sot, secili kishte një rol të rëndësishëm për të luajtur. Çfarë do të kishte ndodhur nëse ndonjëri do të vendoste të mos merrte pjesë? E njëjta gjë është e vërtetë për kishën – çdo person është i rëndësishëm. Dhe, kur dikush zgjedh të mos marrë pjesë, gjërat fillojnë të shkatërrohen. Sot do të mësojmë se si bashkëpunon kisha, si e gjen ti veten në të dhe cili është qëllimi kryesor i kishës.

Lutu: *Inkurajo njërin nga nxënësit të drejtojë klasën në lutje. Kjo do t'i ndihmojë të mësojnë të luten në ambiente publike dhe të zhvillojnë aftësitë e udhëheqësisë frymërore.*

Zbuloje: Do të lexojmë disa vargje sot, mirëpo një pjesë e tyre gjenden te libri i Veprave të Apostujve. A gjenden Veprat e Apostujve në Dhiatën e Vjetër apo në Dhiatën e Re? (Dhiata e Re) A mund t'i gjeni Veprat e Apostujve në Biblat tuaja? *Për nxënësit më të*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

rritur mund të përdorësh metodën e stërvitjes me shpata. Veprat e Apostujve është një libër i mrekullueshëm që flet për fillimin e kishës.

Kronologjia: A e gjeni dot te kronologjia nisjen e kishës në Dhiatën e Re, pasi Jezusi shkoi në qiell? Mund të shihni edhe "Epokën e kishës", në të cilën jemi pjesë edhe ne.

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Çfarë është një kishë? Kur mendojmë zakonisht për një kishë, na vjen ndërmend një ndërtesë. Mirëpo, Perëndia nuk nënkupton këtë kur flet për kishën. Kisha përbëhet nga të krishterë që mblidhen për të adhuruar Perëndinë. Cili është qëllimi i kishës? Qëllimi i kishës është të përlëvdojë Perëndinë. Drejtohu te maja e çadrës. Të përlëvdosh Perëndinë do të thotë ta lavdërosh dhe ta adhurosh me mendimet, fjalët dhe veprimet e tua. Perëndia i ka dhënë secilit dhunti të veçanta, që të punojmë së bashku. Disa njerëz në kishë janë mësues, disa janë inkurajues, të tjerë organizues dhe disa mund të drejtojnë adhurimin. Perëndia u jep shumë dhunti të ndryshme njerëzve në kishë. Nëse je i krishterë, Perëndia të ka dhënë një dhunti të veçantë që ta përdorësh në kishë. Le të shohim te Bibla për të zbuluar më tepër në lidhje me atë që thotë Perëndia për kishën dhe atë që Ai pret prej saj.

Përvijimi i Shkrimit

Mblidhuni së bashku rregullisht

Ngjite letrën "Mblidhuni rregullisht" poshtë çadrës

Lexo Hebrenjve 10:25

Përmbledhje: Besimtarët te Veprat e Apostujve mblidheshin rregullisht. Kjo ishte shumë e rëndësishme.

A e imagjinoni dot të jeni pjesë e një skuadre futbolli dhe të merrni pjesë vetëm gjysmën e ndeshjes? Skuadra do ta ndiente mungesën dhe me shumë mundësi nuk do ta fitonte lojën. E njëjta gjë është e vërtetë në kishë. Kur ti nuk vjen në kishë, ndihet mungesa jote.

Në Dhiatën e Re, kur njerëzit shkonin në kishë, studionin Fjalën e Perëndisë. Ata donin të mësonin më shumë për Jezusin dhe dëgjonin me dëshirë, që të bëheshin ndjekës më të mirë. Cilin varg na kujton kjo? (2 e Pjetrit 3:18a) Ata ndanin vakte së bashku, ashtu siç kishin ngrënë dishepujt me Jezusin. Kur ndajmë bukën në kishë, siç bëri Jezusi në darkën e fundit me dishepujt, e quajmë "Darka e Zotit".

Çfarë duhet të bëjë kisha sot? Duhet ta bëjmë prioritet të mbledhurit bashkë rregullisht. Nëse je ndjekës i Krishtit dhe je pjesë e trupit të kishës, duhet të mblidhesh me të tjerë që e ndjekin Jezusin. Më e rëndësishmja, kur ne mblidhemi, ne duhet të studiojmë, të hamë së bashku dhe ta marrim Darkën e

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Zotit në një mënyrë që i jep lavdi Perëndisë. *Drejtohu te maja e çadrës.* Mos harroni, të përlëvdosh do të thotë të lavdërosh dhe të adhurosh Perëndinë me mendimet, fjalët dhe veprimet. Nëse nuk përlëvdojmë Perëndinë, nuk ka arsye për të studiuar, për të ngrënë apo për të marrë Darkën e Zotit së bashku.

Adhuroni

Ngjit letrën "Adhuroni" poshtë çadrës.

Lexo Psalmin 86:9-10

Përmbledhje: Adhurim do të thotë t'i tregosh Perëndisë sa sa shumë vlen Ai. Asgjë nuk është më e rëndësishme për ne sesa Ai. Nëse Perëndia është vërtet më i rëndësishmi për ne, atëherë asgjë nuk duhet ta pengojë çdo anëtarë të trupit – të kishës – të mblidhet në adhurim.

Çfarë ndodh në adhurim? Përmes muzikës, qetësisë, lutjes, artit dhe fjalëve të folura, ne shprehim se sa vlerë ka Perëndia për ne. Të mbledhurit në adhurim inkurajon dhe fuqizon secilin prej nesh. Një kohë e rregullt në adhurim është kur mendja dhe zemra jonë është në linjë me Perëndinë. Ne mund ta adhurojmë Perëndinë kur jemi vetëm gjatë javës, por është e rëndësishme të mblidhemi me ndjekës të tjerë të Jezusit si një zë i vetëm për të adhuruar. Më e rëndësishmja, kur ne mblidhemi bashkë, ne adhurojmë në një mënyrë që i jep lavdi Perëndisë. *Drejtohu te maja e çadrës.* Kisha adhuron Perëndinë që ta përlëvdojë Atë.

Lutuni

Ngjit fletën "Lutuni" poshtë çadrës.

Lexo 1 e Thesalonikasve 5:16-18

Përmbledhje: Lutja është diçka e rëndësishme që bën kisha për të përlëvduar Perëndinë. Kur ne lutemi, ne ia parashtrojmë çdo gjë Perëndisë. Ne pranojmë se nuk e kemi fuqinë për t'u kujdesur vetë për situatën. Kujtoni se përlëvdimi i Perëndisë është lavdërimi dhe adhurimi i Tij, dhe pikërisht kështu duhet të jetë lutja. Kur lutemi duhet të themi gjëra të tilla si: "Perëndi, Ti ke krijuar gjëra që janë më të mëdha se gjithçka që unë mund të bëj," ose "Perëndi, Ti ke fuqinë për të shëruar dhe jo unë", ose "Perëndi, Ti je i vetmi i aftë për ta hequr mëkatin tim. Unë nuk e arrij dot vetë këtë."

A ke folur ndonjëherë me ndonjë mik dhe nuk ke dashur që biseda të përfundojë? Kështu ishte lutja për besimtarët e kishës së hershme. Ata flisnin me Perëndinë dhe e përlëvdonin, dhe nuk donin që ajo kohë të mbaronte. Ndonjëherë ata luteshin gjatë gjithë natës!

Drejtohu te maja e çadrës. Kisha duhet të përlëvdojë Perëndinë duke u lutur. Kur ka qenë hera e fundit që je lutur gjatë natës, apo që nuk doje që biseda jote me Perëndinë të përfundonte?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Jetoni në përbashkësi

Ngjite letrën "jetoni në përbashkësi" poshtë çadrës

Në kishën e hershme, besimtarët e njihnin njëri-tjetrin. Ata e shijonin kohën së bashku. Kur një i dashur vdiste, ata vajtonin së bashku. Ata shkëmbenin përvojat e përdishmërisë dhe të rritjes së fëmijëve, si dhe të jetesës së bashku. Në fakt, si trup i Krishtit, ata besonin kaq shumë se duhej të ishin pjesë e jetës së njëri-tjetrit, saqë i shisnin gjërat që kishin, që t'i ndanin me njëri-tjetrin.

Lexo Veprat e Apostujve 2:45-46

Përmbledhje: Ata përlëvdonin Perëndinë duke e bërë Atë më të rëndësishëm se gjithçka që kishin. *Drejtohu te maja e çadrës*. Anëtarët e kishës duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin në përditshmëri, me gjërat e zakonshme. Kjo bëhet duke ndihmuar dikë me korrjen e barit, duke çuar dikë te takimi që ka me doktorin, duke gatuar një vakt për dikë që po kalon një javë të vështirë apo duke ndihmuar një familje që po shpërngulet. Është shumë e rëndësishme të kujtojmë se, ne nuk i bëjmë këto gjëra me shpresën se personi do të bëjë diçka në këmbim, por e bëjmë për shkak se këtë dëshiron Perëndia. A ju vjen në mendje ndonjë mënyrë tjetër se si kisha sot jeton në përbashkësi për të përlëvduar Perëndinë?

Ndihmojini të tjerët bujarisht

Ngjit letrën "Ndihmoni të tjerët" poshtë çadrës.

Kisha e hershme jo vetëm që kalonte kohë në përbashkësi, por ndihmonte edhe ata që ishin jashtë kishës. Ata strehonin jetimët, ushqenin të uriturit dhe kujdeseshin për të sëmurët. Ishin bujarë dhe i drejtonin njerëzit te Jezusi.

Lexo Veprat e Apostujve 5:14-15

Përmbledhje: A të vijnë në mendje mënyra se si besimtarët që ti njeh janë bujarë për t'i ndihmuar të tjerët? Këtë mund ta bëjnë me kohën ose me paratë e tyre. Po ju, si jeni treguar bujarë me të tjerët?

Shtojini besimtarëve

Ngjite "Shtojini besimtarëve" poshtë çadrës

Lexo Mateu 28:19-20

Përmbledhje: Kur Jezusi e la tokën për t'u kthyer në qiell, Ai u dha dishepujve porositë e fundit. Ai u tha atyre të bënin dishepuj – të shkonin e t'u tregonin të tjerëve për Të, që ata të përlëvdonin Perëndinë. Perëndia nuk do që kisha të mbesë me të njëjtin numër besimtarësh. Ai do që çdo person të jetë pjesë e trupit të besimtarëve, që quhet kishë. Ne përlëvdojmë Perëndinë kur u tregojmë të tjerëve për Të dhe i mirëpresim si pjesë e kishës.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përfundimi

Le të shohim çadrën tonë. Gjëja kryesore është të përlëvdojmë Perëndinë. *Drejtohu te maja e çadrës.* Çdo gjë që kisha bën bie nën çadrën e përlëvdimit të Perëndisë. Nëse diçka nuk përlëvdon Perëndinë, atëherë kisha nuk duhet ta bëjë. Kisha e përlëvdon Perëndinë kur (drejtohu edhe te fletët):

- mblidhet rregullisht;
- adhuron;
- lutet;
- jeton në përbashkësi;
- i ndihmon të tjerët me bujari;
- dhe u shton besimtarëve.

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

Kisha nuk është një ndërtesë; janë të krishterët që mblidhen për të adhuruar Perëndinë. Ata mund të mblidhen në një ndërtesë, së cilës i referohemi si kisha, mirëpo Bibla nuk nënkupton një ndërtesë kur përdor fjalën "kishë". Besimtarët bëjnë shumë gjëra si adhurimi, lutje, ndihma me bujari, jetesa në përbashkësi, takimi në mënyrë të rregullt me njëri-tjetrin, ndajnë vakte, marrin Darkën e Zotit, dhe shpallin Jezusin me ata që nuk e kanë rrëfyer Atë si Shpëtimtarin e tyre. Ata nuk i bëjnë këto gjëra për të marrë vëmendje, por për të përlëvduar Perëndinë. Si besimtarë në Jezusin, jemi pjesë e kishës dhe me gëzim mund të bashkëpunojmë për t'i dhënë lavdi Atij.

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Çfarë nënkupton Bibla kur flet për kishën? (Kisha përbëhet nga të krishterët që mblidhen për të adhuruar Perëndinë)
2. Çfarë do të thotë "përlëvdim"? (Të lavdërosh dhe të adhurosh Perëndinë me mendimet, fjalët dhe veprimet)
3. Çfarë nënkupton Bibla kur thotë "trupi i Krishtit"? (Kisha)
4. Përmend dy mënyra se si e përlëvdojmë Perëndinë. (mblidhemi rregullisht, adhurojmë, lutemi, jetojmë në përbashkësi, ndihmojmë të tjerët, u shtojmë besimtarëve, etj.)
5. Çfarë bën kisha kur mblidhet? (Përlëvdon Perëndinë; kërkoju nxënësve të ndajnë shembuj specifikë)
6. Çfarë bën kisha kur shpërndahet në komunitet? (Përlëvdon Perëndinë; kërkoju nxënësve shembuj specifikë)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Lojërat e fundit të përsëritjes

Këshilla:

- *Zhvillo të njëjtën lojë disa javë rresht, që nxënësit të mësohen me rregullat, kështu nuk duhet të përqendrohesh shumë te udhëzimet.*
- *Printoji dhe ngjiti diku udhëzimet, që nxënësit t'i shohin.*

Garë quiz (mjetet: dy zilka apo diçka tjetër që shkakton zhurmë)

1. Ndaji nxënësit në dy skuadra.
2. Zgjidh dy nxënës (një nga secila skuadër) që të vijë përpara.
3. Bëj një pyetje nga përsëritja.
4. Nxënësi i parë që i bie ziles dhe përgjigjet saktë, fiton një pikë.
5. Skuadra me më shumë pikë në fund, fiton.

Variante argëtuese:

- **Hedhje e topit:** përgjigje e saktë = godit drejt koshit për të fituar një pikë shtesë
- **Hedhja e zarit:** përgjigje e saktë = hidh zarin (zaret) për të përcaktuar pikët e fituara
- **Tic Tac Toe:** përgjigje e saktë = vendos X ose O në tabelë
- **Rrotullo rrotën:** përgjigje e saktë = rrotullo për të fituar pikë, shpërblime ose etiketa shpërblyese
- **Zarfi i mistershëm:** përgjigje e saktë – zgjidh një zarf që ka pikë ose çmime
- **Këpucët:** përgjigje e saktë = tërhiqni në tokë këpucët e skuadrës; këpuca që arrin e para, fiton
- **Goditje "e vërtetë ose e gabuar"** (mjetet: dy vrasëse mizash): shkruaj "e vërtetë" dhe "e gabuar" në tabelë; nxënësi i parë që godet përgjigjen e saktë, fiton një pikë (ose shkruaj "A", "B" dhe "C" për pyetje me alternativa)

Mbytu ose noto

1. Ndaji nxënësit në dy skuadra.
2. Kërkoju të ngrihen të gjithë në këmbë.
3. Pyet njërin nga nxënësit që janë në këmbë.
4. Nëse përgjigjet saktë, ata mund të:
   a. "mbysin" dikë nga skuadra kundërshtare, pra, personi tjetër duhet të ulet dhe të presë që dikush ta "shpëtojë" – OSE –
   b. mund të "shpëtojnë" dikë nga skuadra e tyre që është "mbytur" nga dikush tjetër.
5. Skuadra e parë që i "mbyt" të gjithë anëtarët e skuadrës kundërshtare, fiton!

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Shëno shumë pikë

1. Vendosu paraprakisht pyetjeve të përsëritjes vlerë në pikë, duke i dhënë më shumë pikë pyetjeve më të vështira (e vështirë = 20 pikë, mesatare = 15 pikë, e thjeshtë = 10).
2. Ndaji nxënësit në dy ose më shumë skuadra.
3. Skuadrat duhet ta zgjedhin pyetjen e tyre në bazë të vlerës së pikëve.
4. Kur japin përgjigje të saktë, fitojnë pikë për skuadrën.
5. Skuadra e parë që mbledh 100 pikë fiton!

Vendosja në piramidë e gotave plastike (2 sete me gota plastike)

1. Ndaji nxënësit në skuadra.
2. Sa herë që nxënësit përgjigjen saktë, fitojnë një gotë, të cilën duhet ta vendosin te piramida e skuadrës. Piramida do të ndërtohet me çdo gotë që fitohet.
3. Skuadra e parë që i fiton të gjitha gotat dhe përfundon piramidën, fiton.

Gotë mirësie (mjetet: shkopinj druri të vendosur në një gotë me ngjyra; vendos paraprakisht vlerë në pikë te shkopinjtë; vendos pikë pozitive dhe negative, pastaj vendosi shkopinjtë me kokë poshtë që të mos dallohen pikët)

1. Ndaji nxënësit në dy ose më shumë skuadra.
2. Bëji njërit prej tyre një pyetje përsëritjeje.
3. Kur një nxënës të përgjigjet saktë, mund të zgjedhë njërin nga shkopinjtë dhe të fitojnë pikët e shënuara në të.
4. Skuadra me më shumë pikë në fund, fiton!

Gjejeni se kush...

1. Kërkoji njërit prej nxënësve të ulet përballë klasës dhe pas vetes të ketë një tabelë ose një copë letre.
2. Shkruaj emrin e personit për të cilin kanë mësuar javën e kaluar në tabelën që ndodhet pas nxënësit të ulur në karrige.
3. Kërkoju nxënësve të ngrenë dorën dhe ai që është ulur në karrige do të zgjedhë tre persona që do t'i japin ndihma.
4. Nëse e gjen personazhin, fiton një Etiketë shpërblyese.
5. Personi që jep të dhënën më ndihmuese, fiton vendin te "karrigia e të ftuarit" për raundin e ardhshëm.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Topi i plazhit (mjetet: top plazhi; shkruaj paraprakisht te topi një sërë pyetjesh që mund të aplikohen për çdo mësim, për shembull: Kush ishte personazhi kryesor në këtë mësim? Çfarë mësuam nga KZ-ja? Cili është vargu i ditës nga "Mendo si duhet"? Ku gjendet mësimi ynë në Bibël?)

1. Mos e ndaj klasën në skuadra.
2. Luaj muzikë ose kërkoji njërit nga drejtuesit të recitojë 2 nga 12 vargjet kyç ndërkohë që nxënësit e kalojnë topin te njëri-tjetri. Nxënësit duhet të qëndrojnë ulur.
3. Kur të ndalojë muzika ose të kenë përfunduar vargjet, kushdo që ka topin në dorë duhet t'i përgjigjet pyetjes në të cilën ka gishtin e madh.
4. Jepi një Etiketë shpërblyese nëse përgjigjet saktë.

Rreth botës

1. Mos e ndaj klasën në skuadra; kërkoju të gjithëve të ulen në rreth, në tokë ose me karrige.
2. Zgjidh dy nxënës që të qëndrojnë në mes të rrethit.
3. Bëj një pyetje përsëritjeje.
4. Dy nxënësit e parë që ngrihen dhe përgjigjen saktë, fitojnë raundin.
5. Fituesi qëndron në këmbë.
6. Nxënësi që e humbi vendin, ulet atje ku ishte ulur fituesi.
7. Tani fituesi garon kundër nxënësit tjetër që është ulur pranë tij (në kah orar).
8. Vazhdoje këtë proces deri sa të përfundojë rrethi.
9. Qëllimi është që nxënësit të qarkullojnë nëpër të gjithë rrethin derisa të kthehen në vendin fillestar.
10. Nëse një nxënës arrin të kthehet në karrigen fillestare, fiton lojën.
11. Nëse mbaron koha para se dikush të kthehet në vendin fillestar, atëherë fiton ai që ka ecur më shumë përpara.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

LIBRI PA FJALË

T'U PREZANTOJMË FËMIJËVE UNGJILLIN

Libri pa fjalë është mënyra kryesore se si e ndajmë Ungjillin me fëmijët në kurrikulën e Zbuluesit. Do të vini re se do t'i i referohemi çdo javë ndërsa prezantohet mesazhi i Ungjillit. Secila ngjyrë ka një kuptim të thjeshtë dhe një varg kyç që do t'i ndihmojë fëmijët të marrin kuptimin e vërtetë të dashurisë së Perëndisë dhe të mënyrës se si mund të kemi një marrëdhënie personale me Të, tani e në përjetësi.

Libri pa fjalë është një mjet që paraqet një mesazh të qartë të Ungjillit. Për fëmijët më të rritur, mund t'ju duket si një mjet shumë i përsëritur, por pasi rishikuam rezultatet e testit, mësuam se fëmijët më të rritur dinë fjalën kyç, ngjyrën dhe vargun, por shpesh nuk dinë ta përdorin si mjet për të ndarë apo mbrojtur besimin e tyre. Mbajeni në mendje ndërsa modeloni mesazhin e Ungjillit për fëmijët çdo javë.

Përpiquni që me raste ta përdorni prezantimin e Ungjillit pa iu referuar ngjyrave. Pasi të keni përfunduar, pyetini fëmijët se çfarë iu kujton. Ose, filloni ta ndani Ungjillin duke shprehur gëzimin që keni për shkak se jeni pastruar (shpëtuar) nga mëkati në jetën tuaj. Është e rëndësishme të përfshihet gëzimi i të qenët pjesë e familjes së Perëndisë. Kur bëhesh i krishterë, Perëndia është Ati yt Qiellor dhe ti u bashkohesh të gjithë të krishterëve si pjesë e familjes së kishës së Tij.

Përdorimi i Librit pa fjalë

Ngjyra e artë – Faqja e artë na kujton dashurinë e Perëndisë për ne dhe se si ne, si të krishterë, mund të kemi sigurinë se një ditë do të shkojmë në qiell. Gjoni 14:2 thotë: "Në shtëpinë e Atit tim ka shumë banesa; përndryshe do t'ju thosha: Po shkoj t'ju përgatis një vend". Qielli është i vërtetë… dhe është një vend i përsosur e real. Do të jetë i mbushur me gëzim, lumturi, rrugë të arta, me praninë e vetë Perëndisë dhe do të jetë një familje e përsosur. Por diçka nuk është në qiell… dhe ajo është mëkati.

Ngjyra e errët – Faqja e errët përfaqëson mëkatin. Mëkati është gjithçka që mendojmë, themi ose bëjmë që është kundër Perëndisë. Shembuj të mëkatit janë kopjimi, vjedhja dhe thashethemet. Këto gjëra nuk do të jenë në qiell dhe janë gjëra që nuk e kënaqin Perëndinë. Romakëve 3:23 thotë: "Sepse të gjithë kanë mëkatuar dhe nuk e arrijnë lavdinë e Perëndisë". Ndëshkimi i mëkatit është vdekja e përjetshme, që do të thotë se nuk mund të shkojmë në qiell, por ka shpresë…

Ngjyra e kuqe – Faqja e kuqe na kujton Jezusin. Jezusi është Biri i vetëm i përsosur i Perëndisë, që erdhi në tokë të jetonte një jetë të përsosur. Për shkak të jetës së Tij të përsosur, vetëm Ai mund të merrte ndëshkimin për mëkatin tonë. Hebrenjve 9:22b thotë: "...dhe pa derdhur gjak, nuk ka ndjesë". Jezusi derdhi gjakun e Tij dhe për këtë shkak, Ai është e vetmja rrugë për në qiell. Jo përmes veprave të mira (Efesianëve 2:8-9), por vetëm përmes dhuratës së Jezusit. Pranimi i kësaj dhurate falas nga Jezusi është zgjedhje personale. Por prit, duhet të të tregoj diçka... Jezusi nuk qëndroi i vdekur, Ai u ngrit sërish dhe pati fitore mbi mëkatin!

Ngjyra e bardhë – Faqja e bardhë na kujton se, nëse besojmë këto të vërteta, marrim falje për mëkatin tonë. Veprat 16:31 thotë: "Beso në Zotin Jezu Krisht dhe do të shpëtohesh ti dhe shtëpia jote". Beso dhe do të shpëtosh nga ndëshkimi i mëkatit tënd. Mëkati yt mund të falet dhe ti mund të pastrohesh. Por kjo është një zgjedhje që çdo individ duhet ta bëjë vetë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Ngjyra e gjelbër – Faqja e gjelbër na kujton se, pasi i kërkon Jezusit të falë mëkatin tënd, Ai dëshiron që ti të afrohesh më tepër me Të. Është një *marrëdhënie*, jo një fe. Ai bëhet udhëheqësi i jetës sate. Për shkak se Ai është udhëheqësi yt, do të duash të rritesh… si bari në muajt e ngrohtë të verës (i gjelbër). 2 e Pjetrit 3:18a thotë: "Por rrituni në hirin dhe në njohjen e Zotit dhe të Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht". Ne afrohemi me Të kur lexojmë Biblën, kur lutemi dhe kur i bindemi Fjalës së Tij.

Duket fantastike, apo jo? Pavarësisht sa vjeç je, kjo është një zgjedhje që duhet ta bësh vetë! Mund të zgjedhësh ta pranosh sot këtë të vërtetë të mrekullueshme. Nëse dëshiron të zgjedhësh t'i kërkosh Jezusit të jetë Shpëtimtari dhe Zoti yt, duhet të lutesh ose të flasësh me Perëndinë për këtë. Perëndia është real dhe mund të të dëgjojë kur lutesh.

Nëse do të doje ta merrje këtë vendim, mund të lutesh tani për këtë:

1. Pranoje që je mëkatar… tregoji për mëkatin që të mundon dhe se ti e di që ai mëkat nuk i pëlqen Perëndisë. (**ngjyra e errët**)
2. Tregoji se beson që Jezusi vdiq dhe mori ndëshkimin për mëkatin tënd. (**ngjyra e kuqe**)
3. Kërkoji personalisht Jezusit të falë mëkatin tënd dhe të bëhet udhëheqësi i jetës sate. (**ngjyra e bardhë**)
4. Falënderoje që të ka falur dhe që u bë udhëheqësi i ri i jetës sate.

Nëse vërtet i ke kërkuar Perëndisë të të shpëtojë dhe të bëhet udhëheqësi i jetës saee, duhet të dish që mëkati të është falur dhe ti je fëmijë i Perëndisë.

Këshilla shtesë

Për të ndihmuar në udhëzimin e fëmijëve drejt shpëtimit, programi i Zbuluesit siguron kartën *T'i udhëzosh fëmijët drejt shpëtimit*.

Për të ndihmuar me prezantimin e Ungjillit dhe për të filluar me dishepullimin e fëmijëve, programi i Zbuluesit ofron fletushkat *E beson apo jo?* dhe *Po tani, çfarë ndodh?* si dhe libër shënuesin *Unë besoj.*



Fletushka *E beson apo jo?* shpjegon Ungjillin duke përdorur Shkrimin, përkufizime të përshtatshme për fëmijët dhe kornizën e Librit pa fjalë. Është një mjet i shkëlqyer për t'i shpjeguar Ungjillin një fëmije të interesuar, dhe për t'ia dhënë me vete fëmijës që dëshiron të mendojë për ta pranuar Jezusin si Zotin dhe Shpëtimtarin e tij.

Nëse një nxënës zgjedh t'i besojë Jezusit si Zot dhe Shpëtimtar, fletushka *Po tani, çfarë ndodh?*, është një prezantim i mirë i çfarë do të thotë të jetosh jetën e krishterë. Mbulon shkurtimisht tema si: identiteti i tyre në Krishtin, disiplina frymërore, adhurimi dhe lutja, dhe të bërët pjesë e familjes së Perëndisë.

Pasi fëmija merr vendimin t'i besojë Krishtit si Shpëtimtar, libër shënuesi *Unë besoj* mund të plotësohet si kujtesë e këtij vendimi të rëndësishëm. Shënuesin e mban nxënësi dhe pjesa fundore e tij plotësohet dhe i dorëzohet drejtuesit, në mënyrë që të gëzohemi bashkë me nxënësin.

Mirënjohje dhe Falënderime

Falënderime të sinqerta për Shawn Thornton, pastor i kishës Calvary Community Church në Westlake Village, Kaliforni, për përdorimin e konceptit “Mendo si duhet”, “Vepro si duhet” dhe “Ndihu si duhet”. Kjo ide, bashkë me “Kupto si duhet”, është bërë struktura e çdo mësimi të qendërzuar në Bibël në këtë kurikul. E vlerësojmë shumë që ka lejuar këtë ide të jetë pjesë e kësaj kurikule, që të tjerë të mund të pajisen për t’u mësuar fëmijëve të “Kuptojnë si duhet”, të “Mendojnë si duhet”, të “Veprojnë si duhet” dhe të “Ndihen si duhet”.

Jemi mirënjohës për bashkëpunimin e vyer që kemi me “Awana International” dhe që na kanë dhënë lejen t’i referohemi Awana-s brenda kurikulës dhe materialeve trajnuese të “Discovery Land”. Kemi parë se Perëndia e ka përdorur marrëdhënien mes kurikulës të së dielës dhe programit të mesjavës nga Awana që të ketë një ndikim të fortë te nxënësit tanë nëpër botë.

Awana është një markë e regjistruar e “Awana Clubs International”. Përdorur me leje. Appleton Alliance Association, Inc vepron në pavarësi nga “Awana Clubs International” dhe është përgjegjëse vetëm për përmbajtjet e kësaj kurikule.

Të gjitha citimet biblike, nëse nuk thuhet ndryshe, janë marrë nga Bibla, ABS 2009, përdorur me leje nga *Albanian Bible Society (A.B.S.).*

LEGO® është një markë tregtare e grupit të legove. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.